ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues · Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 30 GUSHT 2025 | NUMËR 350 | VITI VIII I BOTIMIT | ÇMIMI 50 LEKË | WWW.EXLIBRIS.AL | EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL | BOTIM I ONUFRI SHPK

VLORA KONUSHEVCI:

Në letërsi, sikurse në jetë, nuk fiton ai që thyen zemrën më bukur, por ai që arrin t'i japë një formë të re zemrës së thyer

Bisedoi Andreas Dushi

Shumë urime kolegut Abdullah Zeneli PËR 35-VJETORIN E THEMELIMIT TË SHTËPISË BOTUESE "BUZUKU"

Një botë nga vetvetja, në takim përvojash dhe përfytyrimesh

Mendime dhe kujtime nga Sokol Zekaj

Gjithsesi koha bën punën e vet: një gjë që nuk e ndriçon, e errëson, por edhe një gjë që nuk e errëson, e ndriçon. Ata më të mirët koha i shenjtëron, dhe u bën vend në kujtesë të gjatë. Por në planin njerëzor, të vjen një kohë kur ti kujton disa miq a disa poetë a shkrimtarë, dhe thua se, jeta ia vlejti qoftë edhe veç për njohjen me ta. Unë ia kam besuar poezinë time emocionit estetik, këngës me kumbim të bukur të dikujt, që rrugëtimin e vet të gjatë të poetit, nëpër sfidat e jetës, e bën duke kaluar mes një bukurie dhe një honi, duke krijuar një botë të vetën, nga vetvetja, në takim dhe kryqëzim përvojash dhe përfytyrimesh.

SHËNIME PËR LIBRAT

Fotaq Andrea "Pena të arta franceze për shqiptarët (1332-2007)"

Një libër emocionues

Nga Eshref Ymeri (fq. 6)

LETËR PËR PETRO ÇERKEZIN

Nga Enver Kushi (fq. 8)

Mbi vëllimin me tregime "Plotës që më lënë" të Esmeralda Shpatës

NGJYRAT E ERRËTA TË THELLËSISË

Nga Prof. Dr. Klara Kodra (fq. 9)

Bekim Blaku, "Qetësi e prishur", "Buzuku"

DHIMBJE E SHNDËRRUAR NË KLITHJE POETIKE

Nga Biser Mehmeti (fq. 11)

Me poetin Niko Kacalidha dhe "Heraldikët e borës"

Nga Armela Hysi (fq. 10)

Shënime për poezinë e Martin Camajt "Vrasja e poetit"

Vrasja e poetit, plagë e rëndë në ndërgjegjen e kombit

Nga Yzedin Hima (fq. 7)

Shkrimtarja japoneze, Rie Qudan: Pse përdora ChatGPT për të shkruar romanin tim fitues të çmimit "John Self"

Intervistë për The Guardian 18 gusht 2025 (fq. 22)

BIBLIOTEKË

Durim Taçi (fq. 12)
Spirale të shtrira

Minella Aleksi (fq. 13)
Promovimi

Mentor Kikia (fq. 14)
Vrasje në rrugicën e Xhulit

Alfons Zeneli (fq. 15)
Germa mbi dimër

Philip Larkin (fq. 16)
Dritare të Larta
Përktheu Kujtim Morina

Isaac Babel (fq. 18)
Patoku im i parë
Përktheu: Artemisa Kuznetsov

Andre Maurois (fq. 18)
Portiku Korintian
Përktheu: Feride Papleka

Shqiptar Oseku (fq. 19)
Zjarri

Arben Meksi (fq. 17)
Karikatura e së shtunës

Për romanin "Shpikja e Morelit" të Adolfo Bioy Casares , "Pika pa sipërfaqe"

Dekonstruksione fragmentare për kryepersonazhin rrëfimtar

Nga Enver S. Morina (fq. 22)

VLORA KONUSHEVCI:

Në letërsi, sikurse në jetë, nuk fiton ai që thyen zemrën më bukur, por ai që arrin t'i japë një formë të re zemrës së thyer.

Bisedoi Andreas Dushi

Vizatim nga Anastas Kostandini - Taso

A.D.: Vlorë, qysh në titull më ka befasuar zgjedhja për ta parë martesën si një lloj ngarkese. Ani pse veç një konvension ndoshta, prapëseprap, akoma sot, ajo mbart një rëndësi aq të madhe, saqë qysh se lindë fëmija, merr si urim "paç një fat të mirë". Është pikërisht kjo natyrë profetike arsyeja pse ajo s'është gjë tjetër përveçse një ngarkesë?

V. K.: Mbase, po. Por s'është e vetmja arsye. Martesa, për gratë në shumë prej tregimeve të mia e ka dimensionin e një pune me orar të plotë, të padukshme, një barrë që shtrihet përtej lidhjes intime. Burrat e kanë privilegjin ta përjetojnë martesën si një nga rolet në jetë, ndërsa për shumë prej grave ajo e ka rolin kryesor, ndaj ky dallim është bërë material letrar për mua. Më ka interesuar si metaforë për peshat që shoqëria ua ngarkon grave dhe mënyrën se si i bartin ato. Ajo 'natyrë profetike' që e përmendët ju është një lloj fati i paragjykuar, të urojnë 'paç një fat të mirë' shpesh si një paralajmërim se do të duhet ta mbash peshën e atij fati gjatë gjithë jetës. Prandaj në libër, martesa paraqitet edhe nga një perspektivë intime, por edhe si metaforë për marrëdhëniet tona me çdo lloj zotimi që marrim mbi vete. Dhe si çdo zotim i madh, edhe ajo është e mbushur me dashuri po aq sa me frikë, përgjegjësi e peshë.

A.D.: Ky libër me tregime nuk mëton asesi ta fshehi kanonin femëror ku bën pjesë. Shumëkush nuk i beson, por unë mendoj se s'ka si të jetë ndryshe: letërsia ndahet në disa kanone dhe ai femërori, veçanërisht në prozë, ofron prurje rrallë ç'është e vërteta, por përherë e më interesante, sidomos kur flasim për letërsinë e gjuhës sonë. Si e shihni këtë çështje?

V. K.: Nëse e shohim historinë e letërsisë shqipe me kujdes, shohim se krijueset gra ose janë vendosur në margjina ose janë abstrahuar. Musine Kokalari, prozatore shqiptare, u burgos dhe u internua për dekada, ndërsa librat e saj u hoqën nga qarkullimi. Selfixhe Ciu, poete dhe prozatore e viteve '30, u dënua politikisht dhe u la jashtë çdo antologjie. Në Kosovë, shumë autore të viteve '70-'80 si Edi Shukriu, arkeologe, poete, një nga zërat themeltarë të letërsisë së shkruar nga gratë në Kosovë, Hida Halimi, prozatore, e shumë të tjera nuk figurojnë fare në programet shkollore, megjithëse krijimtaria e tyre shënon hapa të rëndësishëm. Të gjitha këto janë shembuj të trajtimit të grave krijuese nga kanoni tradicional, i ndërtuar mbi logjikën e përjashtimit, jo vetëm nga censura e drejtpërdrejtë, por edhe nga ideja se letërsia 'e madhe' duhet të ndjekë modelin e burrit heroik, të lidhur me historinë, luftën dhe mitin kombëtar. Ndërkohë, përvojat e grave, jeta shtëpiake, marrëdhëniet intime, shtatzënia, aborti, prostitucioni, madje edhe humbja dhe sëmundja janë kundruar nga prizmi i çështjeve private, të zhveshura tërësisht nga universalja apo heroikja. Dhe pa këtë pjesë, kanoni është i cunguar, sepse tregon vetëm gjysmën e botës. Në librin tim, nuk kam dashur të shkruaj 'si grua', por e di që përvoja ime, gjuha ime, kujtesa ime janë formësuar në një trup dhe mendje femërore, ndaj kjo për letërsinë është pasuri, por në asnjë mënyrë kufizim.

A.D.: Nëse libri do të botohej pa emrin tuaj, sa besoni se, një lexues i kujdesshëm dhe që ju njeh mirë, do ta kuptonte se në fakt, ju jeni autorja?

V.K.: Kam dëshirë të mendoj që po. Secili autor e ka gjuhën e komunikimit letrar dhe në këtë kontekst edhe mund të shquhet, dallohet apo dëshifrohet nga lexuesi pasionantë. Unë shkruaj me një zë që nuk kam as dëshirë e as mundësi ta fsheh. Ka kohë që në krijimtarinë time, gruaja është preokupim, subjekt dhe motiv.

A.D.: Më befason për mirë fakti që, një pjesë e letërsisë shqipe të kohëve të fundit në Kosovë, e sheh luftën jo më nga pikëpamja e triumfatorit epik, ose luftëtarit sypatermbur, por prej syrit të njeriut të zakonshëm, të frikësuar dhe të pasigurt as për veten as për të afërmit. Kjo formë trajtimi e asaj periudhe, besoni se i bën më mirë shërimit të traumës që ajo ka lënë? Dhe, nëse po, ajo forma tjetër, epikja pra, besoni të jetë një lloj *cooping mechanism* për të mos e parë luftën ashtu sikurse ishte: një përvojë e tmerrshme, por krejt ndryshe, si një histori që mbrujti e nxorri guximtarë?

V.K.: Po, besoj se kjo qasje, e syrit të njeriut të zakonshëm, i afrohet më shumë së vërtetës emocionale të luftës. Ne jemi rritur me tregimet heroike për luftërat tona gjithandej, të cilat për fat të mirë a të keq, kushedi, nuk ishin pushtuese, të shumtën mbrojtëse, por ama gjithnjë heroike, sikurse në gjithë Ballkanin. Mendoj se ç'heroizimi i shoqërisë sonë është njëfarë domosdoshmërie në funksion të zhveshjes, ngase duhet ta pranojmë që edhe lufta prodhon heronj të rrejshëm. Pastaj lufta nuk është vetëm betejë me flamur dhe fitore. Ajo është frika që ta mbërthen barkun, pasiguria që të shoqëron nga mëngjesi në mbrëmje, dhe pamundësia për ta ditur nëse do të mbijetosh apo jo. Duke e rrëfyer nga ky kënd, letërsia i jep hapësirë edhe asaj pjese të përvojës që historitë epike zakonisht e lënë jashtë: jetët e thyera, heshtjet, pritjet e pafund, zhgënjimin. Ndoshta, për shumë njerëz, ishte më e lehtë të shihje luftën si një kronikë heroizmi sesa si një përvojë traumatike që të çrrënjos nga vetja. Heroizmi e kthen dhimbjen në krenari dhe ta ofron një narrativë të qëndrueshme, të përballueshme. Por rreziku është që, duke e bërë këtë, humbim kontaktin me dimensionin njerëzor të tragjedisë. Sa i përket shërimit mendoj se rrëfimi intim nuk e shëron plagën menjëherë, por e bën të dukshme, e njeh dhe e pranon dhe ndoshta është pikënisje e mbarë kjo. Mendoj se na duhen të dyja edhe epikja, për ta nderuar guximin, edhe tregimet intime, për ta kuptuar plotësisht çmimin që e kemi paguar.

A.D.: Dhe, meqë jemi këtu, a është letërsia një lloj terapie apo përvoje shëruese? E, nëse po, në cilin çast, teksa shkruhet apo kur po lexohet?

V.K.: Nuk e di nëse letërsia shëron, por e di se e ndryshon mënyrën se si e mbajmë dhe e përballojmë dhimbjen. Shkrimi dhe leximi i japin rend diçkaje që, ndryshe, do të mbetej kaotike dhe e turbullt. Shkrimi është akt i brendshëm përballjeje ndërkaq leximi akt i jashtëm njohjeje. Të dyja krijojnë ura drejt njohjes së vetes së pari. Prandaj mendoj se letërsia nuk ta heq barrën, por ta

VLORA KONUSHEVCI



Martesat, valixhet dhe ngarkesat e tjera

OnufriTregime

ndan. Dhe kur barra ndahet, bëhet më e lehtë.

A.D.: Çka më ka pëlqyer shumë në libër është raporti mes vajzës dhe kurvës, ku çdo vajzë a grua, sa herë del, në çfarëdolloj forme, fare pak jashtë perceptimit të kujtdo burri për "vajzën e mirë", "gruan e mirë" etj., ajo quhet prej tij "kurvë". Dhe kjo fjalë, për çudi, ngjet shumë më shpejt sesa çdo epitet tjetër. Besoni se kultura jonë, për një kohë të gjatë, mbase akoma sot, vajzën mund ta shohi vetëm si kurvë dhe jo-kurvë?

V.K.: Shoqëritë si kjo e jona që ndodhen në një udhëkryq ndërmjet tradicionales, ku patriarku dirigjon dhe asaj modernes që e njeh lirinë e individit si vlerë aposteriore, jetojnë në një përplasje të ashpër ndërmjet këtyre dy sintagmave. Pra, kjo ndarje e vjetër "vajzë e mirë" ose "kurvë" është një sitë e ashpër dhe një nga format më të vjetra të kontrollit mbi trupin dhe lirinë e gruas. Nuk ka të bëjë fare me të vërtetën, por me kufijtë, të cilët përpiqet t`i vendos shoqëria. Në çastin që i prek këta kufij, fjala të bie mbi supe me peshën e shekujve të paragjykimit. Kjo është arsyeja pse figurat e gruas në rrëfimet tona janë ose të shenjta, ose fatale, pra i kemi dy ekstreme të skajshme, pa mes dhe pa nuanca. Paradoksi është se ky gjykim nuk na vjen vetëm nga jashtë, ai tashmë ka hyrë në ndërdijen tonë, ngase e pranojmë si gjuhë të natyrshme, duke e përligjur këtë diskurs. Edhe libri e paraqet këtë realitet ngase ky lloj gjykimi është kaq i ngulitur, sa shpesh bëhet pjesë e heshtur e mënyrës se si vetë gratë e cilësojnë njëra-tjetrën. Dhe ky, për mendimin tim, është dimensioni më i shëmtuar.

A.D.: Duket sikur libri të çon nga besimi në familje, te besimi tek të huajt, besimi te burri, besimi te shteti, besimi në Zot e në të mbrame, besimi te vetja. Është ky shtegtim, në fund të fundit, e vetmja mënyrë për ta njohur vetveten? Apo njëra prej tyre? Besoni se njohja e vetvetes duhet të kalojmë, domosdoshmërisht, në disa faza që duhet, me patjetër, të të përballin me të tjerët ose me vetë "tjetrën" si përvojë tëhuajsimi?

V.K.: Besimi, në kuptimin më të gjerë, është gjithmonë një udhëtim i ndërlikuar. Në libër ai nis nga shtëpia, nga marrëdhëniet më të afërta, e shtrihet deri tek shteti, Zoti, vetja... Çdo ndalesë është provë që të përball me tjetrin, një njeri, një institucion, një ide, ose një version tjetër të vetes. Ndoshta nuk ka një mënyrë të vetme për ta njohur veten, por asnjë njohje nuk është e plotë pa kaluar përmes përballjes me "tjetrin", një udhëtim që shpesh përcillet me frikë dhe ankth. Kierkegaardi thoshte se njeriu e kupton lirinë e vet vetëm kur e sheh ankthin në sy. Për personazhet e mia, kjo ndodh shpesh në takime të vogla, të përditshme. Në tregimin *Posteri*, për shembull, është infermierja, një paciente tjetër, madje edhe dielli i ndaluar që s'mund të hyjë në dhomë. Të gjithë këta janë "të tjerë" dhe është pikërisht ky kalim përmes tjetrit, përmes frikës, ironisë, humorit dhe lodhjes, që e çon protagonisten më afër një njohjeje të re për veten. Mund të jetë e dhimbshme, mund të të zhgënjejë, por e ka edhe një ironi

të bukur: ndonjëherë, për t'u kthyer tek vetja, duhet të humbasësh rrugën përmes të tjerëve.

A.D.: "Këtu, edhe kotësia i ka rregullat e veta, por unë nuk i përkas kësaj rregulle", shkruan në tregimin "Fruta të plastikës". A mund të flasim për një lloj "Poetike të kotësisë" që, në fakt, është njëkohësisht poetikë e vetë kiçit? A është ajo aq mbytëse sa të të detyrojë të bëhesh pjesë e saja, apo edhe mund të luftohet? Nëse po, si?

V.K.: Poetika e kiçit është bërë një mjedis që gëlltit gjithçka, një realitet ku fasada peshon më shumë se substanca, ku e bukura e rreme shndërrohet në normë. Në "Fruta të plastikës", nuk doja vetëm ta ironizoja dhe tallja kiçin, por të tregoja se sa lehtë ai bëhet frymëzim i mënyrës si jetojmë, flasim e zgjedhim. Kiçi është më i rrezikshëm kur duket i padëmshëm, sepse atëherë nuk e kupton se po ta ndryshon shijen, kujtesën, gjuhën. Protagonistja ime refuzon të bëhet pjesë e tij dhe ky është një akt rezistence, dhe megjithëse nuk duket gjithmonë heroike, ndonjëhere mjafton të mos marrim pjesë në lojë. Por luftimi i kiçit shkon përtej estetikës, është më shumë zgjedhje për të mos e lënë fasadën ta zëvendësojë të vërtetën, për të mos lejuar që realiteti të rregullohet deri në atë pikë sa të bëhet i rremë. Dhe kjo kërkon jo vetëm shije, por guxim, guxim për ta pranuar edhe të shëmtuarën, edhe të papërsosurën.

A.D.: Vlorë, "Martesat, valixhet dhe ngarkesat e tjera" është një libër tronditës. Nëse dikush të thotë se s'e ka heq dot nga dora dhe e ka lexu brenda një dite, besomë, ka diçka që nuk shkon me të. Libri nuk mund të kapërdihet kollaj, historitë e tij zënë vend thellë brenda lexuesit, në një prej shtresave më vështirë të depërtueshme të shpirtit. Si do t'i përshkruaje përjetimet që të kanë shoqëru gjatë konceptimit, shkrimit dhe redaktimit të tij?

V.K.: Procesi i këtij libri nuk ka qenë as i shpejtë, as i lehtë, ngase mbi të gjitha ka qenë i ngarkuar emocionalisht. Në secilën histori kam hyrë me vetëdije, si dikush që zgjedh të ecë në territore të panjohura dhe të shtegëtojë në histori njerëzore të trishta, duke e ditur se aty mund të humbas ose të gjej diçka që s'e kam njohur më parë. Mund të them se ishte pothuajse një proces filigranik, gjatë të cilit në dorë kisha një fije të hollë, dhe çdo tregim ishte një nyje e kësaj fije. Disa i lidha me dorë të butë, disa me dorë që dridhej, disa i këputa e i nisa nga e para, me bindjen se çdo nyje duhej ta kishte arsyen e vet të ekzistencës. Redaktimi, apo më mirë të them vetëredaktimi ishte sfida e fundit, ngase unë ia lejoj vetes draftet e para të papërsosura madje krejt skeletore të cilat pastaj i përpunoj. Toni Morrison, shkrimtare amerikane e ka thënë shumë bukur: "Arti i vërtet jeton në ripërpunim". Proces i pamëshirshëm, por, ama i domosdoshëm.

A.D.: Për ta mbyllur, një pyetje e pashmangshme për mua: Sa e vështirë ka qenë t'u qasesh këtyre temave pa rënë, për asnjë herë të vetme, në patetizëm?

V.K.: Ky është një prej vëzhgimeve më të mprehta dhe më të sakta që kam dëgjuar për librin tim deri tash. Unë edhe jashtë letërsisë kam një lloj alergjie natyrore ndaj toneve vajtuese dhe ndaj fjalëve që e marrin përdore lexuesin dhe e fusin me zor në mëshirë. Për mua, edhe skena më e errët mund të mbajë një grimë ironie, një kthesë të vogël që e ndryshon këndvështrimin dhe të nxjerr nga hendeku emocional pa e fshehur thellësinë e tij. Kjo nuk e zbeh dhimbjen, por e vendos në një lartësi ku mund ta shohësh drejt në sy. Mbase kjo vjen nga mënyra si jam rritur, ku edhe momentet më të rënda duhej t'i kaloje me një grimë humor, sarkazëm, a ndonjë batutë që e shpëtonte situatën nga fundosja. Në shkrim, kjo bëhet zgjedhje e vetëdijshme, edhe në kapitujt më të errët, personazhet e mia nuk bien në patetikë, përkundrazi, ia lejojnë vetes luksin e një buzëqeshjeje që shkon përkundër gjithçkaje. Sepse në letërsi, sikurse në jetë, nuk fiton ai që thyen zemrën më bukur, por ai që arrin t'i japë një formë të re zemrës së thyer.

SOKOL ZEKAJ

Një botë nga vetvetja, në takim përvojash dhe përfytyrimesh

Mendime dhe kujtime

Pse po i shkruaj këto radhë? Po i shkruaj sepse po dua t'i hedh në shkrim. Nganjëherë, arsyeja e gjërave nuk është e qartë. Ndoshta duke shkruar, fjalë mbas fjale, kuptimi sqarohet. Në fakt, ne kemi një botë tonën, që është bota letrare, që ka një klimë të vetën, të gjallë. Ne kështu e ndjejmë. Tash jam në një orë të vonë të natës. Diku dëgjohet një muzikë. Për muzikë, gjithmonë ka arsye. Është gusht. Po ik edhe kjo verë. Kështu, koha rrjedh. Vitet kalojnë. Unë - dhe jo vetëm unë - kam hyrë në fushën e letërsisë me një numër disavantazhesh në shpinë, dhe më janë dashur shumë sakrifica për t'i kthyer ato në avantazhe. Kujtoj këtu shkrimtarin Lazër Stani, si të një ane, me të cilin jam takuar veç një herë në Shkodër, por e ndiej si të afërt.

Ne poetët e kalojmë jetën tonë mes librave, dhe përmes librave. Kemi libra për lexim në bibliotekën tonë. Kemi edhe librat tanë të shkruar prej nesh, me të cilët tash rrallë merremi. Ata nuk janë të përkëdhelurit tanë. Më shumë merremi me librat e të tjerëve. Unë kam edhe shumë libra autorësh shqiptarë. Disa i kam njohur, dhe sot nuk janë. Disa jetojnë dhe vazhdojnë të botojnë. Të gjithë janë një pasuri për mua, sepse në radhë të parë jemi njerëz. Si njerëz, rrugët tona në jetë kanë probleme të ndryshme, komplekse që edhe na ndajnë. Por ne prapë ndjehemi bashkë. Lexojmë njëri-tjetrin, dhe shkruajmë edhe poezi të reja, apo gjëra tjera të afërta me to.

Gjëra tjera të afërta me to, janë qoftë edhe mendimet tona të pashkruara. Në këtë rrugëtim, ne shkojmë drejt fundit pa u kthyer prapa, si era. Por edhe realiteti vepron mbi ne. Ne njohëm ngjarje dhe periudha të ndryshme historike. Madje ne mund të themi se njohëm edhe Shqipërinë e viteve '30, sepse deri në gjysmën e parë të viteve '50, në një kuptim, po ajo Shqipëri ishte, e prapambetur. Mandej njohëm Shqipërinë e diktaturës, e më pas dihet, deri sot. Realiteti është i fuqishëm. Ai nuk është miqësor me poetët. Gjithsesi, ne aty jetojmë.

Kujtoj një takim me Moikom Zeqon diku mes *Tajvanit* dhe urës. Kishte në dorë dy libra në frëngjisht. Njërin ia pashë me shumë kurreshtje sepse pashë në kopertinë emrin e Max Jacob, një poet me origjinë hebreje, me një shije të hollë poetike, por me një fat tragjik, që nuk dihet se si, dhe ku përfundoi, në kohën e pushtimit nazist në Francë. Por nuk ishte një libër me poezi. Ishte një libër i thjeshtë për poetin Unë e kisha këtë format libri për një poet tjetër. Një botim i bukur por jo i shtrenjtë, prej rreth njëqindepesëdhjetë faqesh, a diçka më shumë. Një libër i hartuar me kujdes, me foto, skica, kujtime, shënime për jetën dhe veprat, shënime bibliografike, gjithë gjëra që zgjojnë kërshëri për lexuesin.

Tek ne nuk bëhen këto botime. Por them se do qe mirë të bëheshin botime të tilla, në seri, për poetë e shkrimtarë që nuk jetojnë, qoftë edhe me destinacion thjesht promovime dhe panaire libri. Për cilët? Nuk po rendis emra. Ne e dimë se bota jonë letrare nuk është aq e fuqishme sa janë të tjerat: muzika, media, sporti, politika. Këto janë më të egra dhe më të mbështetura në shoqëri. Mbase mbështetja nga shteti në një seri të tillë botimi do qe vetë mbështetje për kulturën kombëtare, në drejtimin e duhur, më shumë se disa gjëra tjera që mbase bëjnë lajm. Më duket se botimet në një seri, kanë njëfarë besueshmërie te lexuesi, nëse i kanë shpëtuar zhgënjimit më parë.

Unë i dhashë Moikomit librin tim *Toka të pabanuara* që sapo e kisha botuar atëherë nga ShB *Pika pa sipërfaqe*. Ai më pyeti për gruan. I thashë se më ka vdekur. Heshti. Unë nuk e dija se ai kishte një sëmundje të rëndë, aq i shëndetshëm sa ish ai, ndërsa unë kaq i dobët sa isha. Ne ishim të një moshe. Më kujtohet diku se, kur do të shkonte Lasgushi në Prishtinë, me rastin e botimit të veprës së tij atje, Kadareja thotë se do duhej ta shoqëronte ndonjë njeri i shëndetshëm si Moikom Zeqo. Mirëpo koha sjell këto të papritura. Nuk u pamë më. Në bibliotekën time kam mjaft libra të tij, mjaft prej të cilëve me dedikim. Prurja e tij në letërsi dhe dije ka qenë e bujshme, e madhe dhe pothuaj e parrokshme.

Te ai ishte, edhe poeti edhe shkrimtari edhe dijetari. Por edhe përkthyesi. Libri *Poezi futuriste* i Majakovskit, i përkthyer prej tij, i botuar nga ShB *Zenit Editions*, është një nga befasitë më të bukura poetike që na kanë ardhur në këto vite në shqip. Moikomi nuk ngurronte të bënte edhe përcaktime. Thoshte, bie fjala: Poeti më i madh francez është Arthur Rimbaud. Kjo mua më pëlqente, pasi më bëhet se Rimbaud qe ai që i dha frymën e parë, e bëri realitet të gjallë modernizmin. Nga ana e tij Moikomi, sa ishte i fuqishëm dhe i vrullshëm, ishte i vëmendshëm dhe i respektueshëm. Ishte shpirtmirë dhe shihte të bardhën e gjërave. Mbaj mend në një takim tonin, më ka thënë një metaforë nga një poezi imja që i kishte mbetë në kujtesë. Vepra e tij është një pasuri kombëtare.

Unë kam një poezi timen dedikuar Moikomit.

GJEMITË E POETËVE
Poetit *Moikom Zeqo*

Lumi është i gjerë mes brigjeve të gjelbra
ose jo i gjerë veçse i thellë e me shtjella

O gjemitar, a e ndien një zë a një gjëmë
që del diku nga lumi, mbi ujërat e lara me hënë?

Edhe gjemitë e poetëve kanë historitë e veta
me vezullitje netësh, të ashpra sa vdekja

Para disa kohësh një mik imi ndërsa po pinim një kafe, më tha se e e ngacmonte ideja e botimit të një antologjie poetike me pezinë e krijuar në kohën e diktaturës, dhe se e zotëronte pothuaj të gjithë materialin e duhur, gati për zgjedhje. Zgjedhja sigurisht do kohën e vet. M'u duk një ide me vlerë, aq më shumë që i përket një kohe, jo kalimtare por të gjatë, që e gjitha është një histori e kësaj culture, e këtij vendi, e këtij populli. Ajo do t'ishte si një dritë që vinte nga errësira. Bie fjala, po kujtoj një poezi të kësaj kohe nga poeti Dodë Kaçaj (1947-1998) atë me titull *Sonte*. Doda ishte një poet i lindur.

SONTE

Sonte fjeta shumë ëmbël
Kur u zgjova
gjeta dorën në zemër...
Kisha parë ty në ëndërr.

Por Dodë Kaçaj ka shkruar poezi edhe në post-diktaturë. Këto janë poezi të gjendjes së trazuar, ndër zhgënjimet e hidhta të jetës, por janë të vërteta.

Ndërsa është edhe një poet, i mbajtur plotësisht në heshtje, Llazar Siliqi. Unë mendoj se një libër prej nja njëqind faqe, afërsisht po them, me poezi të tij, mund të botohej, dhe të ishte një vlerë, madje të spikatur, jo për thellësinë, por për spontaneitetin dhe paqen disi naïve dhe pothuaj fëminore që përcjellin te lexuesi. Apo Andrea Varfi etj.

Unë në vitin 1993 pata botuar librin tim të dytë, që ishte në fakt i pari në kushtet e lirisë. Për të gjithë ne të moshës sonë, kjo kohë shënonte një rifillim, ose një start të ri, në fakt starti i së vërtetës. Ne këtu e filluam rrugën letrare si krijues të lirë. Librin e pata titulluar *E pamundura*. Te ky libër është botuar një poemë me tone disi dramatike me titull *Me se merresh?* që përmban në thelb natyrën e kohës. Por në pasthënien e librit, atëherë, kam shënuar edhe këto fjalë: *Akrobati krijon figurat e çuditshme, dhe ne e ndjekim me ankth, me habi dhe admirim. Në këtë proces, ai realizon një seri konkordancash mes vetes, objekteve në arenë dhe tokës, e cila e tërheq drejt vetes. Poeti përmes fluturimesh poetike, realizon një zinxhir ekuilibrash në lëvizje ndërmjet elementëve që përbëjnë universin e tij (arenën e tij) . Ekuilibri është harmonia. Por ashtu si ujëvara e lumit, nuk e shpërfytyron rrjedhën e tij, edhe disharmonia është harmoni në rrjedhën e poezisë mjeshtërore. Lëvizjet e tij vizatohen në ajër befasuese dhe të përkryera. Edhe poeti bën diçka të ngjashme, ndonëse leximi i poezisë nuk shoqërohet me klithmat e ankthit, pasi ne si lexues nuk e përfytyrojmë dot se ai, poeti, mund ta pësojë nga akti i krijimit të vet artistik, njësoj si akrobati në arenë. Mirëpo kjo është e vërtetë. Poeti si akrobati, e jep veten në poezi në mënyrë të plotë dhe përfundimtare. Prandaj bota e tij poetike që është arena e tij, si të thuash, ruan për të befasi të pakëndshme dhe ndoshta dramatike, dhe poaq, (prapë si në arenë) edhe magjinë e realizimit të ëndërruar.*

Këto i kam shkruar ndoshta në maj ose qershor të vitit 1993. Më duket se edhe sot, nuk jam fort larg tyre, ndonëse nuk do t'I kisha shkruar krejt kështu.

Në të vërtet iluzionet kishin rënë, dhe gjërat më shfaqeshin si shumë të vështira. Ishte një kohë mungesash, peripecishë dhe refleksionesh. Varfëria qe thelluar dhe qe bërë më dramatike se ç'qe. Jeta shihej si përmes një xhami të thyer. Nuk është se ishim aq të qartë për gjithçka që ndodhte, dhe që do të ndodhte. Por megjithëse në atë situatë, dhe nga një autor i ardhur prej një skaji të largët të vendit, libri im nuk kaloi në Tiranë pa u vënë re, në heshtje, si uji nën bar. Ndoshta atëherë, ndonëse kohë e trazuar, ndjeshmëria ndaj librit, gjithsesi ishte më e gjallë, edhe se sot që jemi në kushte si të thuash normale.

Qysh nga ajo kohë e sot, jeta ime ka qenë ajo e një qytetari të thjeshtë të këtij vendi, madje -me problematikat e veta të theksuara, ashtu siç jeta na i rezervon. Kjo ka krijuar pasoja të dukshme dhe të padukshme. Por kjo mënyrë e të jetuarit, më ka përcaktuar në një masë të konsiderueshme tiparet e të krijuarit të poezisë, duke pasë një lidhje të drejtpërdrejt me botën reale, pa perde dhe pa pengesa.

Ose ka qenë natyra e poezisë ajo që ka krijuar këtë lloj jete. Kush di me e gjetë. Sigurisht që jeta nuk mjafton për letërsinë. Por më kanë pëlqyer dhe më pëlqejnë ata poetë që e kanë këtë lidhje. Por kjo, në procesin e të jetuarit nuk është e lehtë, sidomos kur ke një familje pas vetes, dhe sakrificat tua, nuk janë thjesht tuat. Prandaj e kam parë me respect çdo poet a shkrimtar që ka pasë vullnetin për të shkruar. Do thosha se vetë letërsia në vetvete, është e dëshiruar për hapësira të reja.

Salvatore Quasimodo thotë në një ligjëratë të tijën se çdo popull ka Danten e vet, apo Shekspirin e vet. Më duket se e nderon kjo thënie poetin e madh italian, jo veç pse është shumë fisnike, por edhe se ka diçka të vërtetë. Çdo popull gatuan vetveten. Ne këtë tashmë e dimë mirë nga përvoja jonë historike. Ndërsa për poetin, problem është se me çfarë lënde e gatuan ai poezinë e vet? Çfarë bote krijon? Cili është zëri që vjen prej saj? Në fund, sa njerëzore është? Pse? Sepse, po citoj këtu Gustav Floberin, nga një korrespondencë e përkthyer nga Enver Fico, dhe të botuara në një numër të revistës *Nëntori*. Në një letër të tij drejtuar një zonje me emrin Rozhe dë Zhënetë, Floberi shkruan: "... *Nëntëdhjetetreshi i xha Hygoit (Viktor Hygo) më duket se qëndron mbi gjithë romanet e tij të fundit; më pëlqen shumë sidomos gjysma e vëllimit të parë, marshimi në pyll..... si dhe të gjitha peizazhet; po çfarë babaxhanësh prej buksheqeri që janë personazhet e tij! Të gjithë flasin si aktorë. Aftësia për të krijuar (sajuar) krijesa njerëzore, i mungon këtij gjeniu. Sikur ta kishte këtë dhunti, Hygoi do t'ia kishte kaluar Shekspirit...*"

Në vitin 1994 kam shkruar dy poema lirike, por plot simbolika, *Fojleta në oborr* dhe *Requiem për borën e pranverës*, me

vargje nga më të dashurat për mua. Më pas, në vitin 1996 shkrova *Trembëdhjetë variacione për një ndjeshmëri*, për të cilën Moikom Zeqo më pat thënë se "*më kujton poezinë e Stevens-it*". Mundet, i thashë, por poezia ime, është imja. Po, po, më tha, nuk ka dyshim për këtë. Ideja për poezinë, me gjithë lëndën, më pat ardhë në pranverën e vitit '96. Kështu e dija se çfarë do të bëja, por nuk ulesha për ta hedhur në shkrim. Nuk kisha frikë se harroj diçka, mbasi ishin gjëra të pjekura. Në fund të vjeshtës u ula, e hodha shpejt dhe me lehtësi në letër, sepse e kisha gati. Kjo është një poemë që e marr, dhe më rrotullohet vetiu në duar si një sferë vezulluese.

Por ndërsa hodha këtë poezi në letër, unë kuptova se një lëndë tjetër komplekse po përpunohej brenda meje, dhe që nuk mund të përfshihej te kjo poezi. Prandaj më lindi nevoja imediate e botimit të këtyre gjërave çfarë kisha, për t'u shkarkuar prej tyre, dhe për me dalë i lirë. Në librin e fundit të botuar *Koha e qytetit*, kam një poemë me titull *Dhurata*, në të cilën nënvizohet ideja se si poezia lind nga fjala. Prandaj e botova librin *Nga ankthi te...* për të cilin poeti Xhevahir Spahiu më pat thënë me dashamirësi se "*poezia u kthye në vendin e origjinës*". Por kjo ishte një fjalë e gjetur nga një shpirt fisnik. Vetëm pak muaj më pas, botova te gazeta *Drita* poemën *Ballkoni*.

Për *Të pamundurën* kam shkruar edhe në librin *Mollët*, botuar në Shkodër nga *ShB Camaj-Pipa* në vitin 2009, por tashmë në një situatë tjetër, duke e parë atë, "*të pamundurën*", jo si një gjë të paarritshme. Deri atëherë kisha botuar shumë vëllime poetike, shumë poema, mes tyre poemën *Zonjë zemër, ta ndiej hapin në kohë* (Ujëvara) ndoshta diçka ku bëhen bashkë thellësia me spontaneitetin, po them unë. Kjo është ajo që më ka udhëhequr në punën me poezinë. Po them se kjo ishte koha kur unë u çvendosa me banim në Tiranë.

Këtu në Tiranë, produkti im poetik, më shumë se u dyfishua.

Kur kam qenë sëmurë në spital, kam pasë momente kur, në gjendjen e vetëdijes po supozoj, normale, sipas një kuptimi, më shfaqeshin gjëra të paqena. Kjo gjendje pat vazhduar të më shfaqej herë mbas here për disa kohë, ndoshta jo krejt një vit. Kam lexuar dikur, nëse nuk gaboj nga poeti francez Claude Roy, që kujton një zonjë kur i tha njëherë: *Claude, ti më duket, ke nostalgji për kohën kur ke qenë sëmurë me kancer*!... Ne kështu, ndër lexime, gjejmë analogjitë e gjërave, qofshin edhe të largëta e të hidhta. Kam dëgjuar njerëz, që pasi kanë kaluar një situatë të vështirë, thonë: kam parë vdekjen me sy! Ndoshta mbas kësaj njeriu, fillon një jetë tjetër. Nuk e di se ç'efekt ka pasë kjo gjendje komplekse dhe e ngatërruar në procesin e të shkruarit të poezive të mia, por kjo ka qenë koha kur kam përgatitë për botim vëllimin që më botoi më pas *Onufri*. Jam i kënaqur me këtë libër, me zërin njerëzor, me kumbimin e një kënge të bukur që buron prej lëndës së tij, nga bota e krijuar prej fjalësh, në një trajtim shpirtnor të gjërave.

Ne nuk e mendojmë se sa shpejt shkon koha, se koha jonë e sotme, shpejt do bëhet e shkuar. Në kohën e diktaturës kam botuar poezi, por nuk kam qenë anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve. Duke mos pasë favore, nuk kam pasë as ndonjë presion të veçantë. Por klimën e vështirë e kam ndjerë tek të tjerët. Në vjeshtën e vitit 1985 u bë një konferencë letrarësh që më duket se u quajt "*e talenteve të reja*" por ku në fakt morën pjesë poetë dhe shkrimtarë të njohur. Aty një kritik letrar, në diskutimin e tij tha diçka për një libër të Kadaresë, se çfarë nuk e kujtoj.

Por kujtoj që Kadareja u ngrit menjëherë për ta kundërshtuar. Mirëpo trajtimi i tij po zgjaste madje me shumë ton, dhe kapot e presidiumit, mes tyre nr 2 i nomenklaturës së lartë, nëse nuk gaboj me numra, po i kërkonin që ta mbyllte fjalën "*sepse nuk kishte rëndësi, ishte një mendim i tij*", e gjëra si këto. Atëherë Kadareja tha këto fjalë që mua nuk e di pse më janë fiksuar saktësisht: *Jo, se ky po më akuzon mua sikur unë kam revizionuar vijën e partisë*". E vërteta është se çdo informacion a ide që dilte në public, regjistrohej menjëherë dhe qarkullonte nga një ingranazh i diktaturës, te tjetri, për ta futur në skaner, dhe për të konkluduar diku, kjo edhe për emra pak të njohur , ose aspak të njohur.

Kjo ishte pesha e diktaturës mbi letërsinë. Kjo ishte klima kur bëhej letërsi, dhe herë-herë letërsi e mirë. Më vonë kërkova në shtypin e Lidhjes për ta sqaruar për veten time këtë episod. Por nuk e gjeta. Ishte fshirë nga materialet pasqyruese të asaj konference. Ka shumë mundësi, nuk u pasqyrua me qëllimin e mirë për shkrimtarin. Atëherë vetë diktatori kishte vdekur. Por kjo ishte klima në të cilën bëhej letërsia në atë kohë. Çdo të thotë kjo? Kjo do të thotë se koha shkon, për gjithmonë dhe për të gjithë, të gjallë dhe vdekur, dhe se koha që vjen duhet ta shohë me dashamirësi të shkuarën, për të arritur te një kulturë e respektuar.

Por te kjo konferencë më duket ka qenë rasti kur një ditë, u ngjitëm në një anije dhe shkuam në një ambjent ku thanë se poetët do të recitojnë poezitë e tyre. Unë u afrova por pashë se salla ishte plot, dëgjoheshin duartrokitje, entuziazëm, dhe unë bëra një hap prapa. Sokol Zekaj, si je? dëgjova një zë. Pashë. Ishte një djalë mbështetur te dy duart e bëra bashkë prapa, në shtalkun e derës. Mirë, thashë, si je. Nuk po më njeh? më tha. Jo. Jam Agim Spahiu, më tha. Ishim takuar, por shumë vite ma parë. Kishim njohje të mirë.

Pak vite ma vonë, po merresha, në punën time, me problemet e ujit për ujitje në verë diku, kur më afrohet një njeri, që e kujtoj si njeri jo të panjohur, por as të afërt. Sokol, më thotë, a ke dëgjuar që në Kukës kanë varë një poet? Poet...? Varë...? thashë. Po, më tha. Ishte një gjë që nuk po ma kapte mendja. Po kush është? e pyeta. Nuk e di, më tha. Mos është Agim Spahiu? i thashë. Jo, më tha. Agim Spahiu nuk është. Më vonë pata dëgjuar për Havzi Nelën. Por kaq i fortë ka qenë lajmi që më pat dhënë ai njeri, sa më duket se pat hapur një vorbull brenda vetes dhe ma ka gëlltitë krejt kujtesën. Shumë herë ia kam kërkuar vetes se kush ka qenë ai njeri që ma ka thënë lajmin, por nuk e kam gjetur deri sot e kësaj dite. Mandej, vetëm pak vite ma vonë u hap lajmi tjetër i hidhur për vetë Agim Spahiun. Ç'trishtim!

Poezia ma ka përshkuar jetën si një fill. Sigurisht e di, si shumë të tjerëve. Në shekullin e njëzetë, duke filluar ndoshta me Apollinaire-in, (Alcoole,1912) duke mos u orientuar kah domosdoshmëria e shpjegimeve të zgjatura, por ndërsa afrohej dhe njësohej me shpirtin njerëzor, ajo vetë, poezia, u mor si temë për poezinë. Paul Valery tek "*Charmes*", 1922, ka një poemë për poezinë. Këtë libër në variant italisht, ma ka dhuruar Prof. Jup Kastrati në mesin e viteve '90. Në atë kohë Profesori i shquar, kishte botuar në Amerikë një libër të madh për Faik Konicën. Librin e kam parë, dhe ishte shumë i dëshiruar nga unë, sidomos atëherë, kur figura e Konicës ishte ende e veshur me shumë mistere, por nuk e kam, ndërsa nuk e kam hasë as në libraritë tona. Është puna e jetës sime, më pat thënë. Gjithashtu më pat thënë se është botuar në pak kopje.

Njëherë e takova në rrugë në Shkodër. Po shkoj te vajza, më tha. Më mori në telefon. Kam bërë peshk për drekë. Po s'përtove, eja. Ishin fjalët e vajzës. E shoqërova duke biseduar deri afër shtëpisë. Më ftoi edhe mua. Është ime bijë, më tha, Nuk shkova. Por Profesorit i kam shkuar edhe në shtëpinë e tij. Edhe ai ka ardhur në shtëpinë time. Librin e Valery-së ma ka shoqëruar me dedikimin "*me dashuri vëllazërore. 28. X. 1996*". Vetë ai e kishte blerë librin kur ishte ende tetëmbëdhjetë vjeç, në Shkodër. Paul Valery është një nga ata poetë që personifikon poezinë si ideal, si vizion. Kam shumë nderim për kujtimin e Profesor Jup Kastratit, për shijen e hollë që përcillte te tjetri. Ashtu si edhe një tjetër studjues i njohur, Mikel Prendushi, autor i librit *Kolë Idromeno* (1860-1939), prej të cilit kam gjithashtu kujtime të çmuara.

Sidomos në gjysmën e dytë të shek të XX, tema e poezisë do hasej rëndom ndër poetë. Ndër ne, më duket se i pari që e merr këtë temë është Risto Siliqi (1882-1936) një emër jo shumë i lakuar në letrat tona. Në këtë kohë ka shkruar edhe Asdreni vargje shumë të bukura, të matura, të frymëzuara dhe herë-herë edhe moderne për nga gjuha poetike. Por unë dua të ndalem te kjo, poezia e Siliqit me titull *Poezia,* e shkruar po them afërsisht në një kohë me Valery-në. Dua ta vë këtë poezi këtu për lexuesit e këtyre shënimeve.

POEZIA

Poezia asht vegl'e ndjenjave zemrore,
Diftim i deprtimit qi kafshon tinzisht,
Me rima t'tërhjekta vallzon dhe mbi vorre
E u nep jetë atyne qi vdiqën njerzisht
Në thelli të natës, kur qetsohen udhët,
Shpirti t'ditës vdekun i përkrahet n'vajë.
Dhe shungllon me frazat, her' vrapson her'
rrudhet
E n'muzikë të erës bahet shoqe e saj
Ah! Ç'e knaq poetin! Gjith'lumnitë i giten,
I shërohen dhimbtë e varrëve, por mbas
Qi e len të vetun, tjerat i përsriten,-
Se kujtimet e reja njallen ças më ças

Para disa ditësh e përmendi këtë temë edhe poeti Rudolf Marku te ExLibris. Edhe unë kam shkruar shumë poezi mbi këtë temë, ndoshta tepër, por i shoh, dhe them, le të qëndrojnë në vetvete, në dorë të kohës.

Nuk është se edhe sot, nuk shkruaj asgjë. Shkruaj herë-herë gjëra të vogla. Dhe është e sigurt, se edhe një libër me poezi të reja, do t'u shtohet poezive të mia, pasi është një gjë që ka marrë formën e vet. Tash thjesht nuk e di sa do zhvillohet më tej si masë. Por më duket se bërthama poetike, prapë më gjeneron gjëra të reja. Është një proces zhvillimi, ndërsa jeta është komplekse. Por nuk kam nxitim për ta botuar këtë libër, pasi kam një projekt tjetër të rëndësishëm në mendje, për ta plotësuar, siç thuhet nganjëherë, më parë se të ik. I rëndësishëm, them, për mua. Të shohim. Kam thënë me vete: ç'iu desh Ungaretit që ndërmori atë udhëtim fatal në atë moshë, për një çmim nga një universitet, në mes të dimrit, kur ai i kishte marrë të gjitha çmimet, ishte i vlerësuar gjithandej?!

Por sot, të gjitha poezitë e mia, të mbledhura bashkë, bëjnë diçka pak a shumë voluminoze. Duke qenë e tillë, duke qenë produkt i një pune të gjatë në kohë, i një jete, i ndjerë ngrohtë mes shumë poetësh të tjerë të talentuar, po të më pyeste dikush se çfarë është ajo që unë kam bërë, nuk do mundesha me thanë ma shumë se, "*nuk e di, por prap'seprapë diçka ndiej: janë disa metafora, disa poezi, disa poema...*" Thonë se poezia është mënyra më e shpejtë dhe më e përqëndruar e të parit të botës.

Gjithsesi koha bën punën e vet: një gjë që nuk e ndriçon, e errëson, por edhe një gjë që nuk e errëson, e ndriçon. Ata më të mirët koha i shenjtëron, dhe u bën vend në kujtesë të gjatë. Por në planin njerëzor, të vjen një kohë kur ti kujton disa miq a disa poetë a shkrimtarë, dhe thua se, jeta ia vlejti qoftë edhe veç për njohjen me ta. Unë ia kam besuar poezinë time emocionit estetik, këngës me kumbim të bukur të dikujt, që rrugëtimin e vet të gjatë të poetit, nëpër sfidat e jetës, e bën duke kaluar mes një bukurie dhe një honi, duke krijuar një botë të vetën, nga vetvetja, në takim dhe kryqëzim përvojash dhe përfytyrimesh.



Fotaq Andrea *"Pena të arta franceze për shqiptarët (1332-2007)"*

Një libër emocionues

Nga Eshref Ymeri

Para nëntë vjetësh, pikërisht më 18 shtator 2016, pata botuar në internet Esenë me titull *"Një zë intelektuali vjen nga Strasburgu"*, të cilën ia kushtoja intelektualit të shquar Fotaq Andrea. Për ta shkruar atë Ese, më pati nxitur botimi i librit të tij, me titull *"Pena të arta franceze për shqiptarët (1332-2007)"*, të cilin Fotaqi ma pati dhuruar asokohe. Një libër ky, me një vëllim prej 762 faqesh. Në atë Ese, ndër të tjera, theksoja:

"Ishte fundmarsi i vitit 1979, kur fillova punë si përkthyes i gjuhës ruse në Redaksinë e përkthimeve në gjuhë të huaja të letërsisë politike në Shtëpinë botuese "8 Nëntori". Fotaqi, si përkthyes i frëngjishtes, kishte filluar punë aty që në vitin 1975... Në vitet 1971-1974, Fotaqi pati studiuar në Universitetin e Kaenit dhe në Universitetin e Sorbonës së Re, në Paris, ku qe diplomuar si specialist i frëngjishtes".

Në sektorin e frëngjishtes, krahas përkthyesve të talentuar, si Emond Tupja, Viktor Kalemi, Rajmonda Vuçini, Margarita Puteci e të tjerë, në krah të kryemjeshtrit të përkthimit Jusuf Vrioni, Fotaqi, me punën e tij të përkushtuar, la gjurmë të pashlyeshme në historikun e asaj Redaksie.

Në atë Redaksi, e cila përbëhej nga 42 përkthyes dhe redaktorë dhe nga pesë daktilografiste, përktheheshin kryesisht "veprat" e Enver Hoxhës në 8 gjuhë të huaja. Përkthimi i të gjitha atyre "veprave", në krahasim me përkthimin e "veprave" të zgjedhura, duhej bërë shpejt, sipas porosisë që vinte nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, sepse marksistë-leninistëve të mbarë botës "u digjej shpirti" për ato "vepra" dhe "mezi prisnin" ardhjen e tyre. Në ato kushte, kolektivi i Redaksisë detyrohej të punonte deri natën vonë. Ka pasur raste, kur përkthehej libri "Shënime për Kinën", që puna në Redaksi ka vazhduar 36 orë resht. Për të shmangur stërmundimin e përkthyesve, të redaktorëve dhe të daktilografisteve, që të ruhej shëndeti i tyre, qe përgatitur një grafik për ata që duhej të vazhdonin punën dhe për ata që duhej të shkonin të çlodheshin, që pastaj të ktheheshin në punë, për të ikur të tjerët për pushim. Përkthyesit dhe redaktorët rraskapiteshin me orar aq të stërgjatur dhe në fund të pesëmbëdhjetëditëshit (siç paguheshin rrogat asokohe) nuk merrnin asnjë shtesë mbi rrogën. Ajo ishte një grabitje e pastër e punës intelektuale, të cilën, përveç mohimit të mbishpërblimit material, shteti e shoqëroi edhe me mohimin e pronës intelektuale, duke mos lejuar shënimin e emrave të përkthyesve dhe të redaktorëve në ballinat e librave të përkthyer, pikërisht ashtu siç kishte vepruar me mohimin e pronës intelektuale të përkthyesve të veprave të klasikëve të ideologjisë komuniste. Rrjedha e ngjarjeve vërtetoi më së miri se gjithë ajo punë kolosale e asaj Redaksie për përkthimin dhe botimin e "veprave" të Enver Hoxhës në tetë gjuhë të huaja, sipas fjalëve që qarkullonin asokohe, i pati kushtuar Buxhetit të Shtetit më shumë se 160 milionë dollarë, pati shkuar për dhjamë qeni. Ja dy fakte tepër domethënëse për veprat e pëkthyera:

"Sa e sa herë qe bërë problem që ambasadat nuk po punonin si duhet për shpërndarjen dhe propagandimin e tyre, ngaqë nuk ua merrte njeri. Edhe kur ua dhuronin të ftuarve, të nesërmen i kishin gjetur në koshin e plehrave" (Citohet sipas. Andon Dede. *"Pa iluzione dhe paragjykime"*. Shtëpia Botuese *"Globus R"*. Tiranë 2010, f. 250).

"Dërgoheshin nëpër ambasada që ato t'i shpërndanin në popull apo në aktivitete të ndryshme. Shumica e tyre mbeteshin stoqe dhe mbushnin depot e ambasadave kudo në botë. Është një punë kolosale, por puna ka shkuar kot" (Citohet sipas: Albert Zholi. *"Edmond Tupja: Përkthimi i veprave të Enver Hoxhës na dërrmonte"*. Intervistë e botuar në faqen e internetit të gazetës "Telegraf". 11 shkurt 2014).

Me kalimin e viteve, dolën edhe më shumë në pah aftësitë e Fotaqit, jo vetëm si një përkthyes me emër, por edhe si një hulumtues tejet i suksesshëm në fushën e punës kërkimore-shkencore, ku ai u dallua veçanërisht si një konicolog i shkëlqyer në kulturën tonë mbarëkombëtare.

Para pak kohësh, Fotaqi më dërgoi njw dhuratë nga Strasburgu, një libër artistik, me titull *"Guri i shpirtit. Kronikë Shqiptare"*. Libri zë një vëllim prej 348 faqesh. E ka hedhur në qarkullim Shtëpia botuese *"Zenit Editions"*, 2023.

Ky libër është origjinal në llojin e vet. Ai përbëhet nga rrëfenja tejet tërheqëse, kronika të përzgjedhura këto, epistola - krijime në formën e mesazheve të poetizuara. Të gjitha këto gërshetohen edhe me elemente të publicistikës. Kësisoj, në këtë libër autori ka ndërthurur mjeshtërisht artin e prozës artistike me vrundullin fshikullues të artit publicistik.

Dy janë temat kryesore që Fotaqi shtjellon artistikisht në këtë libër - mjedisi i ndotur apo keqtrajtimi i natyrës dhe varfëria.

Tek kaloja nga njëra faqe te tjetra, përjetoja emocione të fuqishme, dhembje shpirtërore dhe kaplohesha nga një ndjenjë e fuqishme revolte kundër shkaktarëve të një gjendjeje të tillë në vendin tonë. Mjeshtëria e rrëfimtarisë së Fotaqit më kujtonte disa pena të talentuara të letërsisë botërore, si *Ernest Tomson Seton (Ernest Thompson Seton 1860-1946)*, shkrimtar dhe piktor i shquar kanadez. Është njëri nga shkrimtarët e njohur që ka pasë ngritur zërin për mbrojtjen e natyrës nga papastërtitë dhe mirëtrajtimin e kafshëve, *Xhoi Adamson (Joy Adamson - 1910-1980)*, shrimtare austro-angleze. Ajo pati bërë shumë udhëtime dhe ia pati kushtuar veten mbrojtjes së natyrës afrikane, *Konrad Lorenc (Konrad Lorenz - 1903-1989)*, zoolog austriak, njëri nga themeluesit e etologjisë - shkencës së sjelljes së kafshëve, *Xherad Darell (Gerald Durrell - 1925-1995)*, natyralist dhe shkrimtar anglez, studiues dhe mbrojtës i natyrës së egër, *Margaret Edvud (Margaret Atwood - 1939)*, shkrimtare kanadeze, e cila, në veprat e veta, ka përshkruar babëzinë e pasanikëve, shfrytëzimin dhe ndotjen pa përgjegjësi të natyrës, çka mbart me vete pasoja katastrofike. Ato vepra shërbejnë si paralajmërim dhe thirrje për rishikimin e vlerave, si edhe për rikuptimësimin marrëdhënieve të njeriut me natyrën.

Në këtë libër, Fotaqi e ka vënë gishtin në ngjarje të tilla tronditëse për vendin tonë, si gjëmat që shkaktoi rënia e firmave piramidale, me pasojë luftën vëllavrasëse të vitit 1997 për shkak të varfërimit të mijëra familjeve shqiptare, të shoqëruar me shpërthimin e emigracionit klandestin dhe me vdekjen e qindra varfanjakëve në kanalin e Otrantos. Pikërisht rënia e atyre firmave nxiti polarizimin e shoqërisë në të varfër dhe në të pasur. Me skenat e varfërisë që përshkruan me një leksik të pasur me nota shpërthyese, Fotaqi të kujton jo vetëm Migjenin tonë zemërvrarë. Ai të bën të kthehesh shekuj prapa, gjer edhe te *Fransua Rableja (François Rabelais 1494-1553)*, i cili, me veprën e vet monumentale *"Gargantua dhe Pantagruel" (Gargantua et Pantagruel - 1532-1564)*, demaskon mëkatet e përjetshme njerëzore, të metat dhe problemet e kohës së vet. Nga pena e Rablesë e pati pësuar edhe skolastika mesjetare, që ishte e shkëputur nga ai realitet, të cilin e kishin aq qejf heronjtë kryesorë në të gjitha shfaqjet e tij. Prandaj të gjitha pjesët e kësaj vepre qenë dënuar, si heretike, nga ana e fakultetit të teologjisë të Universitetit të Sorbonës.

Në prozën e Fotaqit ndihet forca e pushtetit mbi njerëzit e thjeshtë, të cilët oligarkia shtetërore i ka shndërruar në bujrobër të vet, duke ua mbajtur të shtrënguar lakun e varfërisë. Varfanjakë që enden trotuareve, lypsarë, që të kujtojnë ritualin migjenian *"Zoti të Dhashtë"*, vajza njomëzake që vërtiten rrugës së varrezave për t'u shitur vizitorëve të tyre lule artificiale, të sjellin ndër mend skena varfërie nga vepra shkrimtarësh të shquar në mbarë botën. Skena të tilla hasen te *Xhek Londoni (Jack London - 1876-1916)*, i cili i shtynte ditët nëpër strehë varfanjakësh dhe shkruante tregime për të mos vdekur nga uria. Nga faqet e veprave të tij të hershme ushton klithma e njeriut me barkun bosh, i cili e dinte mirë se sa e pamëshirshme ishte varfëria e vërtetë. Në vitin 1902 ai shkoi në kryeqytetin e Britanisë së Madhe për ta njohur dhe studiuar nga afër jetën e varfanjakëve të qytetit gjatë 84 ditëve. Vëzhgimet e veta i përmblodhi në librin me titull *"The People of the Abyss" (Njerëzit e rrogozit)*, të botuar në vitin 1903.

Skenat e varfërisë janë pasqyruar në romanin e *Çarls Dikensit (Charles Dickens - 1812-1870) "The Adventures of Oliver Twist" (Aventurat e Oliver Tuistit"*, të botuar në vitin 1837. Në këtë roman autori demaskon mëkatet sociale të Anglisë viktoriane, si egërsia e sistemit, shfrytëzimi i fëmijëve, shpërfillja e pasanikëve ndaj vuajtjeve të varfanjakëve. Të tilla skena hasen te *Fjodor Dostojevski (1821-1881)*. Tema e varfërisë përbën aspektin kyç të krijimtarisë së tij. Në romanet dhe tregimet e veta, *Dostojevski* përshkruan jo vetëm varfërinë e njerëzve të rrogozit, por edhe gjendjen e tyre shpirtërore.

Fotaqi zotëron një pasuri të madhe leksikore, e cila, siç dihet, në një vepër artistike luan një rol të jashtëzakonshëm për forcën shprehëse dhe figuracionin e saj. Një pasuri e tillë i ka krijuar mundësinë për të shfrytëzuar fjalë dhe shprehje sa më të larmishme, për t'i përcjellë lexuesit ide të shumëfishta. Pra, leksiku i autorit dallohet:

Së-pari, për larminë e fjalve. Gjuha shqipe është e pasur me fjalë të tilla, të cilat mund të shprehin të njëjtin kuptim, por me ngjyrime të ndryshme stilistikore, çka i ka dhënë mundësinë për të krijuar figura të goditura emocionale.

Së dyti, për morinë e sinonimeve. Një pasuri e tillë leksikore ka bërë të mundur që autori të përzgjedhë fjalët më të përshtatshme për përcjelljen sa më emocionalisht të mendimeve dhe të ndjenjave të veta.

Së-treti, për pasurinë frazeologjike. Gjuha shqipe është mjaft e pasur me shprehje të tilla, të cilat janë unikale në të gjitha stilet e ligjërimit artistik.

Së-katërti, për mjetet figurative. Pasuria leksikore e autorit përfshin në vetvete mjete të tilla figurative, si krahasimi, metafora, personifikimi etj., me të cilat ai ka krijuar figura mjaft të qëlluara, që i mbeten lexuesit të regjistruara në kujtesë.

Në këtë libër, autori ka krijuar mjaft fjalë dhe kompozita të reja, të cilat nuk hasen në asnjë Fjalor të gjuhës shqipe. Do të ishte me mjaft interes që ato të vilen nga ana e Institutit të gjuhësisë, sepse dihet shumë mirë që letërsia artistike është burim i pashtershëm për pasurimin e përhershëm të pasurisë leksikore të gjuhës.

Kaliforni, 23 gusht 2025

Shënime për poezinë e Martin Camajt
"Vrasja e poetit"

VRASJA E POETIT, PLAGË E RËNDË NË NDËRGJEGJEN E KOMBIT

Nga Yzedin Hima

Martin Camaj, ndonëse u formua në shkolla poetike europiane të shekullit XX, ku lulëzuan surealizmi, hermetizmi etj, nuk harroi edhe poezinë me domethënie. E tillë është edhe poezia me titull "Vrasja e Poetit". Natyrisht, edhe te ky tekst ndihet maksima e vjetër se armiku i estetikes është domethënia. Gjithashtu aty ndeshet lakonizmi dhe përdorimi i vargjeve eliptikë, dukuri e nyjëtimit të tekstit hermetik.

Nuk ndesha asnjë shënim dritëhedhës se cila qe shtysa e nyjëtimit të këtij teksti poetik, ndonëse është mjaft i qartë konteksti në të cilin është shkruar. Martin Camaj në një moshë të re, ende pa u njohur si poet, humbi atdheun. Për një shkrimtar kjo humbje është dyfish më e rëndë se sa për njeriun e zakonshëm. Me largimin e dhunshëm nga atdheu, Camaj humbi lexuesin e gjuhës së tij amtare, u përjashtua nga mozaiku i letërsisë shqipe për një kohë të gjatë, ndonëse vepra e tij është tejet e rëndësishme dhe sot zë një vend të nderuar në letrat shqipe. Në Romë Camaj, krahas studimeve të doktoraturës, bashkëpunoi me bashkëqytetarin e tij nga Shkodra, prozatorin e shquar Ernest Koliqim edhe ky i ndaluar në vendin e tij. Gjithashtu nga atdheu vinin lajme gjithmonë edhe më të këqija për letërsinë dhe për shkrimtarët që nuk përqafuan metodën aestetike të socrealizmit. Besoj në këtë kontekst ka lindur edhe poezia "Vrasja e poetit".

Autori sjell një pohim të njohur në dy vargjet e parë, se poeti gjatë krijimtarisë së tij është krejt i lirë, ndonëse mund të jetojë në diktaturë. Vetëm shpirtrat e plogësht mund të mposhten nga diktatura. Në dy vargjet e parë Martin Camaj shkruan:

Liria e fshehun mbas vargjeve
Të poezisë

Në një vend, ku liria mungonte kudo në jetën e njerëzve, pikërisht në vargjet e poezisë ajo ka gjetur strehë. Autori thekson *Liria e fshehun mbas vargjeve*, duke qartësuar se vargjet janë nyjëtuar në një vend, ku liria mungon ose mund të gjendet e fshehur në vargje, ku poeti për të shprehur shpirtin e tij të lirë përdor metaforat apo simbolet. Lexuesi, krahas kënaqësisë estetike, në vargje të tilla zbulonte atë që në jetën e tij mungonte, lirinë. Liria është armikja e cilado diktature, ndaj diktaturat janë tejet të vëmëndshme dhe tejet të ndjeshme ndaj cdo mendimi, veprimi të lirë. Në vargjet në vijim autori sjell një peizazh brutal, ku metamorfoza ideologjike i ka kthyer njerëzit në "*Shpend mishngranës / Me fytyrë njerëzore"*/ . Po cila është arsyeja që vargjet ruhen nga roje?

Poezia, arti në përgjithësi, përherë kanë qënë armiqtë e mëdhenj të diktaturave. Liria ka magjinë e humanizimit të shoqërisë dhe mjedisit, disponim të tillë ka në përgjithësi edhe letërsia, ndërsa mungesa e lirisë i shndërron njerëzit që i shërbejnë diktaturës nga njerëz në bisha a *Shpend mishngranës*:

Para tyne rrishin galuc roje
Shpend mishngranës
Me fytyrë njerëzore

Poeti pranvë dy dukuri, njëra si produkt i poetit që janë vargjet, ku fshihet liria dhe dukuria tjetër si produkt i diktaturës janë rojet, të cilët janë shndërruar në korba. Në të dy dukuritë kemi fshehje të substancave: liria që fshihet mbas vargjeve dhe barbaria, shpesëria, kanibalizmi që fshihet pas fytyrave njerëzore. Teksti poetik sjell imazhin e një tufe korbash, shpend mishngrënës që kanë pësuar metamorfozë në substancë, duke ruajtur fytyrat prej njeriu. Është tipar i regjimeve përkujdesja për ruajtjen e formës. Krahas krimit, diktaturat i veshin veprimet e tyre me një hipokrizi mbresëlënse. Në dukje, qendrimi në pozicionin *galuc*, është qendrim i korbtë, të gatshëm për të shqepuar prenë e tyre. Autori është i vetdijshëm për traumat që shkakton diktatura në shoqëritë ku instalohet. Kriminalizimi i segmenteve të ndryshëm të shoqërisë është dukuri e rëndomtë në diktaturë. Dikur këta shpendë mishngrënës kanë qënë njerëz të zakonshëm.

Në tekstin tejet lakonik të strofës së parë, falë mjeshtërisë artistike, Martin Camaj nuk përmend fjalën diktaturë, por sjell efektet e veprimit të saj: liria që fshihet në vargjet e poetit nga dhuna e pranishme. Poeti krijon një strehë poetike me metafora dhe simbole, ku liria ndihet e lirë, rojat si korba presin t'ia nisin zanatit të vjetër. Aty, sikurse në tragjeditë klasiciste, nuk shfaqen imazhe të vrasjes, madje fjala vrasje mungon në tekstin poetic, përvec titullit. Autori nuk rrëfen, vetëm evokon. Pikërisht ngrirja e imazhit me vargjet e poezisë dhe përballë tyre *Shpendët mishngrënës* duket se ndërtohet e tillë për të përcjellë mesazhin se kjo gjendje nuk përfundon me vrasjen e poetit dhe "vrasjen" e poezisë së tij, por poetët vriten aty në çdo kohë, sikurse dhe ka ndodhur në Shqipëri.

Ndërsa në strofën e dytë dhe të fundit sillet imazhi i poetit në një mjedis të qelqtë, të mbyllur, duke u rropatur drejt dritës;

E ti ishe për ta nji bletë
Tue u rropatë ka drita në qelq,
andej kufijve të botës
njerëzore.

Martin Camaj përdor vetën e dytë në këtë strofë , duke iu drejtuar vetes më tepër se dikujt tjetër:

E ti ishe për ta nji bletë
Tue u rropatë ka drita në qelq

Poeti shihet nga rojat si bletë, një insekt i zinxhirit ushqimor të shpendëve mishngrënës. Bleta ka vetinë e fluturimit të lirë në hapësira pa kufizim, nga lulja në lule duke mbledhur nektarin për të bërë mjaltin, si ushqim sipëran për njeriun. Bleta dhe poeti kanë të përbashkët fluturimin, fizik për bletën dhe fluturimin e fantazisë për poetin. Bleta, shpesh bie në vështirësi duke u përplasur në qelq për të gjetur rrugën e humbur, ndërsa poeti përpëlitet në qelqin e izolimit për të arritur dritën, lirinë. Autori permend fjalën qelq për të tregur mashtrimin për iluzionin e hëpësirës që të jep qelqi, si dukuri e propagandës së dikturave për lirinë e poetit, krijuesit. Në vargun *Tue u rropatë ka drita në qelq* pohimi i Martin Camajt vjen si përvojë personale dhe botërore. Kur s'ka dritë ç'i do sytë, thotë dikush. Po nga vjen drita në qelq?! Autori sjell dy vargje: *andej kufijve të botës/ njerëzore.*

Dihet se ku gjendet bota njerëzore. Martin Camaj pati eksperiencën nga të dy botët. Këndej, ku për shkak të dhunës, mungesës së lirisë, ndodhën shndërrime të dhimbshme të njerëzve në shpendë mishngrënës dhe bletë të izoluara dhe andej në perëndimin humanist, ku njeriu ndihej njeri dhe ku poeti krijoi veprën e tij që i jep dimesionin europian letërsisë shqipe të gjysmës së dytë të shëkullit XX:

Po cila ka qënë shtysa që lindi kjo poezi?

Natyrisht, arti ka karekter përgjithësues. Kur poeti Martin Camaj flet për vrasjen e poetit, ai flet për poetin e vrarë në Shqipëri apo kudo në botë. Duke lexuar tekstin poetiK, na vjen në mend historia e dhimbshme e disa poetëve tanë, të vrarë nga diktatura. Një ndër ta është poeti dissident Trifon Xhagjika, sfidues kryneç i diktaturës, i pushkatuar nga diktatura komuniste në Shqipëri. Një shtet që vret poetët, është shtet faqezi. Në poezinë e Martin Camajt përdoret numri njëjës, vrasja e poetit. Duke lexuar poezinë, ndër mend na shfaqen disa poetë të vrarë nga diktatura: Vinçens Prenushi, Baba Ali Tomori, Trifon Xhagjika, Vilson Blloshmi, Genc Leka, Havzi Nela. Në fakt, poeti Martin Camaj në poezinë e tij nuk flet direkt për vrasje, por për një vrasje metaforike, izolim në një botë të mbyllur më qelq, ku poeti bletë përpëlitet të prekë dritën që vjen andej *kufijve të botës njerëzore.*

Teksti poetik i Camajt flet për një vrasje shpirtërore, jo thjesht vrasje fizike të poetit. Edhe statusi i tij si poet i refuzuar nga vendi i tij është vrasje. Për poetin, mosreceptimi, ndalesa e librave të tij, bllokimi i rrugëve për te lexuesi, është më shumë se vrasje. Ndër mend na vijnë poetët e dënuar dhe ndaluar si Gjegj Fishta, Ernest Koliqi, Martin Camaj, Arshi Pipa, Zef Zorba, Frederik Rreshpja, Visar Zhiti, Zydi Morava, artisti shumëdimesional Maks Velo, etj.

Në strofën e parë rojat qendrijnë para vargjeve. Ruajnë lirinë apo vargjet?

Martina Camaj flet pak dhe thotë shumë, por nuk shpjegon aspak Liria është fshehur te vargjet apo është bërë një me ta? Liria e fshehur është liri, apo e humb kuptimin nëse qendron e fshehur. Siç shihet edhe liria lipset të jetë e lirë, ndryshe ajo nuk funksionon në të mirë të njeriut.

Në tekstet poetikë të Camajt korbi është fjalë çelës. Janë mjaft poezi ku flitet për korbat apo korbin. Në një tekst korbi zbret nga shkrepat apo karpat dhe ulet te ullinjtë, aty ku pëllumbat po vallëzojnë. Korbi nuk e prish festën e pëllumbave me krokamën e tij, por qendron në heshtje deri në fund të koncertit. Ndonëse me pendët pis të zeza, korbi u ndje pëllumb në shpirt. Ndërsa në këtë tekst Camaj e krijon figurën e korbave, pa i emërtuar ata, ose i shënon me një eufemizëm, si *shpend mishngrënës.* Në këtë tekst njerëzit janë shndërruar në korba, në variantin më të egër të tyre.

Ka një ndarje në tekst midis poezisë dhe unit poetik.

Në strofën e parë vargjet qendrojnë përballë rojave galuc dhe brenda misterit të simboleve poetikë fshihet liria. Te strofa e dytë shfaqet poeti që përpëlitet si bleta në xham për t'i shpëtuar territ dhe për të kapur dritën që endet *andej kufijve të botës / njerëzore.* Nga grupi emëror *botës njerëzore* lind te mendja e lexuesit antonimia *botë njerëzore* dhe *botë shtazore*, ndonëse nuk thuhet në tekst, por nënkuptohet. A janë shenjat përktëse në tekst për krijimin e kësaj antonimie? Pa dyshim: shpend mishngrënës, bletë, liri e fshehur.

Imazhi që përcjell teksti është dhuna: poeti ndahet nga teksti i tij dhe burgoset në terr e moslexim duke u orvatur drejt dritës së largët. Vargjet me rojat galuc, pra edhe poeti i burgosur dhe vargjet e tij të burgosura së bashku me lirinë që fshihet brenda tyre. Imazhi ndërtohet me penelata të shpejta, por të forta përmes grupeve emërore: liri e fshehun, roje galuc, shpend mishngrënës, drita në qelq, botës njerëzore.

Poezia "Vrasja e poetit" është drithëruese. Autori me mjeshtëri ka bërë portretin e diktaturës duke fokusuar anën më të errët të saj, ndalimin, burgosjen dhe vrasjen e poetëve. Poetët e vrarë janë plagë të pashërueshme në ndërgjegjen e kombit.

Martin Camaj
Vrasja e Poetit

Liria e fshehun mbas vargjeve
Të poezisë
Nuk ishte vetëm:
Para tyne rrishin galue roje
Shpend mishngranës
Me fytyrë njerëzore.

E ti ishe për ta nji bletë
Tue u rropatë ka drita në qelq,
andej kufijve të botës
njerëzore.

LETËR PËR PETRO ÇERKEZIN

Nga Enver Kushi



Fort i nderçmi Petro Çerkezi!

E kam menduar gjatë, shumë gjatë që të shkruaj një letër, ndoshta që nga fundmaji i vitit 2022, kur mora vesh lajmin, që Shtëpia Botuese "24 Gramata" në Athinë, botoi antologjinë poetike dygjuhëshe shqip dhe greqisht "Magjia e infinitit" të Moikom Zeqos, përkthyer prej Petro Çerkezit, që pati jehonë pozitive në Greqi. Ti do të thuash pse letër e se mund të bëje një shkrim, nga ata që boton shpesh te "Ekslibris" i Bujar Hudhrit. Këtë mund ta thonë edhe të tjerë, kur të lexojnë këtë letër, se jetojmë në kohëra moderne, në atë të inteligjencës artificiale, se tingëllon anakronike shkrimi i letrave etj. etj.

Fort i nderçëm Petro Çerkezi!

Tingëllon disi i largët, si i ardhur nga shek. XIX e më pas, ky fillim letre, që e gjejmë në letërkëmbimet mes rilindësve tanë, pas Pavarësisë dhe Mbretërisë. Të tilla letra ka edhe në vitet e Luftës Antifashiste, si dhe të periudhës komuniste, por me një përmbajtje tjetër.

Do shtoja këtu, se kemi edhe një formulim tjetër: "Fort i nderçëm mëmëdhetar", ku këto dy fjalë, kur janë bashkë, marrin një peshë tjetër emocionale.

Ti i ke rrënjët nga Pogoni, lindur në fshatin Poliçan, të kësaj krahine, ku flitet gjuha greke dhe jeton një popullsi greke, siç jeton edhe në Dropull e Finiq. Dhe po të ulin kokën malet hijerëndë të Pogonit, matanë është një Pogon tjetër, pjesë e Republikës së Greqisë e ku vazhdojnë malet mitikë e mistikë të rajonit të Epirit, për të zbritur në fushnajat e kodrinat e paana, që lagen nga ujërat e detit Jon. Epiri është nga ato hapësira jo vetëm gjeografike, por edhe shpirtërore, ku kultura greke dhe ajo shqiptare kanë pikëtakimet e tyre, duke dhënë e marrë mes tyre. Atje edhe qiejt, edhe erërat, edhe aromat që vinë nga thellësitë e lumenjve Kalama e Aheron nga pyjet e pafundme, edhe rrahjet e dallgëve të Jonit në brigje, edhe gëzimet, edhe dasmat, edhe vdekjet, edhe këngët, edhe vallet levende, janë ndryshe. Shumë më ndryshe. Epiri, i dashur Petro, i bashkon popujt dhe kulturat e tyre. Nuk është e rastit, që vallja e famshme "Pogonishte", kërcyer në Pogonin tënd, që ka shumë levenderi, elegancë, është bërë pjesë edhe e trashëgimisë së shqiptarëve. Nuk është e rastit gjithashtu, që vallja e Osman Takës ose ato që në Epir dhe Greqi quhen "Çamiko", janë pjesë edhe e trashëgimisë kulturore të Greqisë fqinje. Kam shkruar për kodet e mirëkuptimit mes popujve dhe rolin e kulturës, si dhe shkrimtarëve e artistëve në ndërtimin e urave të miqësisë. Andej dhe këtej këtyre urave, ose më saktë të kësaj ure, qielli dhe deti kanë dhënë e marrin që nga fillesa, dritën e njëri-tjetrit. Ato vise, pra të Epirit, kanë shumë nga drita homerike, ku lëvizin si në shtëpinë e tyre hijet e veprave të Homerit, ku zbret Odisea dhe në tempullin e Nekromantisë, flet me nënën e vdekur, Akilin, Hektorin etj. për të shkuar më pas si mik në oborrin e mbretëreshës thesprote, Deadomesë së bukur.

Grekët kanë patur një poet të madh dhe idealist, Rigas Fereos, që besoi shumë në miqësinë e popujve të Ballkanit. Shqiptarët, gati një shekull më pas, kanë Naim Frashërin, engjëllin mbrojtës të tyre, që jo rastësisht shkroi në gjuhën greke "Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve". Diku, shkrimtari ynë i madh, Ismail Kadare, me të drejtë shkruan për afri mes strukturave shpirtërore të popujve tanë, pra grekëve dhe shqiptarëve, afri që madhërohet më qartë se kudo në prodhimin poetik.

Ti i dashur Petro, je një zë i fuqishëm, ku në poezinë e prozës ose në tërë krijimtarinë tënde, ndihet kultura e madhe greke, por edhe ajo shqiptare. Ju, krijuesit e minoritetit grek në Shqipëri, keni një fat të madh: vepra juaj është ushqyer dhe përkundur në shtratin e një prej kulturave, që i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë botës një rrezatim a dritë tjetër, siç është ajo greke, si dhe në shtratin e kulturës shqiptare, me trashëgiminë e saj brilante dhe disa nga emrat e shquar të poezisë dhe prozës shqiptare.

E zgjata, i dashur Petro, por më ndodh shpesh, që fjalët e më pas fjalitë më zhytin në botën e tyre, në ca thellësira e hone të çuditshme dhe kur më kthejnë në brigje drite, them me vete sa shumë më kanë vënë përpara ato, duke më pushtuar tërësisht.

Po e vazhdoj letrën, tashmë i çliruar nga vorbullat e fjalëve, me një ngushëllim, për ndarjen nga kjo jetë, të vëllait tënd, Odise Çerkezi. Ishte Thanas Dino, që ma dha lajmin e trishtë, paraditen e të shtunës, më 23 gusht. Mbylla telefonin dhe ndjeva dhimbje. Shumë dhimbje. Këtë ta shpreha edhe ty, nëpërmjet telefonit të Thanas Dinos, të nesërmen, pra më 24 gusht, rreth orës dhjetë. Ndjeva në zërin tënd diçka përtej dhimbjes, atë të vëllait për vëllain, që nuk ishte më në këtë jetë. Unë të thashë se Odisea kishte vlera të mëdha njerëzore, si dhe intelektuale. Ai ka qenë dhe do të mbetet një nga studiuesit, shkrimtarët dhe mësimdhënësit e mirënjohur të Gjirokastrës e më gjerë. Pastaj shtova se i jam mirënjohës Odisesë për shkrimin e botuar në "Exlibris" për novelat e mia "Zonja nga Parga" dhe "Jonada", ku ka nënvizuar veçmas anën njerëzore të tyre. Mbaj mend takimin e parë me të në Tiranë dhe kafenë që pimë te libraria "Dritëro". Nuk do harroj kurrë bisedën e shtruar me të, vështrimin e butë dhe të zgjuar të syve, të folmen e ngadaltë si të kadifejtë të zërit të tij, ku ndihej akcenti gjirokastrit. Ky ishte Odisea, vëllai yt i dashur Petro.

Mbylla telefonin dhe dola në ballkon, ku krahët e rrapave janë zgjatur, sa mund t'i prekësh ato. Dhe m'u kujtua një varg popullor, që e citon Kadareja në librin "Autobiografia e popullit në vargje": Qan me dyzet palë lot. Pastaj mora librin në fjalë dhe e hapa në faqen 41: "Është tregimi i një prej proceseve më të moçme e më të zakonshme të njeriut. Megjithatë, sa shumë bukuri ka në këtë të thënë. Sytë e njeriut janë dy, pra "një palë", rrjedhimisht edhe lotët quhen ashtu, sikur të ishin vathë, sikur të ishin bizhu, një palë lot, dyzet palë lot. Ç'dritë dhe ç'rrëzëllim argjendi ka kjo e qarë dhe ç'trishtim të pafund. S'janë pesë, dhjetë, dymbëdhjetë palë lot, por dyzet".

Vetëm një gjirokastrit i madh, i pakufijtë në madhështinë e tij, siç është Kadareja ynë i paharruar, mund ta zbërthej vargun popullor "Qan me dyzet palë lot" me kaq mençuri e thellësi mendimi.

Në shtëpinë tënde në Gjirokastër ishte çelur ksodhi për Odisenë. Porta e madhe ishte e hapur dhe atje kishin ardhur zonjat nga Pogoni, nënat gjirokastrite, apo edhe më larg akoma, nga viset e Epirit për të "qarë me dyzet palë lot" Odisenë.

Fort i nderçmi Petro Çerkezi!

Kisha menduar "të shkruaja dy gisht kartë", siç thuhet në një varg brilant të një poezie popullore nga Epiri ynë. E kam të vështirë të zbërthej këtë varg dhe njësinë matëse, që poeti anonim përdor për letrën: dy gisht kartë. Letra ime doli jo dy gisht, por dyqint gisht kartë, sepse më mungon mençuria dhe sensi magjik i masës, që ka populli. Më mbetet të shkruaj një letër të dytë, ndoshta mbi dyqint gisht kartë, për "Letër Petro Çerkezit për poezinë", shkruar nga i ndjeri Moikom Zeqo, në vitin 2020, vetëm pak javë para se të vdiste. Ajo nuk është letër, por një traktat për poezinë, nëse jam i saktë me këtë, mbushur me ide, kode për poezinë, të shkuarën, të sotmen dhe të ardhmen e saj. Ai e parandjente se po ikte nga kjo jetë, kur në fund të kësaj letra shkruan: "Është e kuptueshme Petrua im, se të shkruash poezi është të familjarizohesh me vdekjen dhe se meditimi poetik është një stilizim i vetëvrasjes". Dhe në fund kam një porosi për ty: kur të shkosh në varreza, para se të nisesh për Qipro, të lutem në emrin tim, vendos te varri i Odisesë një tufë me degë manxurane, që me siguri i ke në vazo në shtëpinë tënde, si në çdo shtëpi gjirokastrite.

Tiranë, mesnatë e 25 gushtit 2025.

Mbi vëllimin me tregime "Plotës që më lënë" të Esmeralda Shpatës

NGJYRAT E ERRËTA TË THELLËSISË

Nga Prof. Dr. Klara Kodra

"Plotës që më lënë" – një titull intrigues.

Është titulli i një vëllimi me tregime me autore Esmeralda Shpatën, një prozatore të talentuar bashkëkohore. I kemi quajtur "tregime", po në të vërtetë keto krijime - të një lloji të shkurtër që jo rrallë arrijnë shkurtësinë maksimale - i përkasin një zhanri të vështirë për t'u përkufizuar.

Skica? Proza poetike? Parabolë? Tregime të shkurtëra? Ato në thelb dallohen për një koncentrim të madh të fjalës dhe të mendimit, një ekonomi të habitshme fjalësh. Autorja zotëron mjeshtërinë e konçizitetit. Krijimet e saj janë tablo të vogla plot forcë shprehëse. Brenda një hapësire të shkurtër - herë - herë tej mase të shkurtër - ndeshim thellësi mendimesh, bulëzim ndjenjash, pasuri simbolesh, herë një ironi në caqet e sarkazmës që përshkon tej për tej shkrimin.

Realiteti që gjejmë në këto krijime është një realitet kaotik. A është realiteti i viteve të vështira të tranzicionit pasdiktatorial në Shqipëri, të një lirie që jo rrallë degjeneron në anarki, të një bote kundërvlerash ku vlerat humbasin?

Pa dyshim ky realitet është i pranishëm në shndërrimin që i bëri arti. Njëkohësisht tok me realitetin *shqiptar* këtu ndeshim një realitet më të gjerë, realitetin e një armiqësie midis njeriut dhe mjedisit, realitetin e një bote kundërvlerash, një bote absurde, një bote që humbet besimin te njeriu në shkallë planeti, një realitet europian dhe botëror.

Ç'vend ka në këtë realitet njeriu?

A mund të bëhet ende fjalë për progres?

Autorja i sheh gjërat në optikën e hermetizmit dhe pas-hermetizmit. Krijimet e saj janë të endura me fijet e një bote që e gjejmë edhe në folklor, të "botës se përmbysur". Krijimet e Esmeralda Shpatës janë në dukje të vështira për t'u deshifruar ngaqë i drejtohen një lexuesi tepër elitar. Ato i karakterizon errësia, tipike për hermetizmin. Në këtë errësi dallojmë pika të ndritshme që mund të jenë pika referimi.

Si t'i interpretojë këto drita të vogla lexuesi?

Këtu lind pashmangësisht pyetja: cili lexues? Tregimet e Esmeraldës, pa dyshim nuk i drejtohen një publiku të gjerë. A i drejtohen ato lexuesit Model? Apo lexuesit - kritik?

Në këto tregime gjejmë temat ekzistenciale të dashurisë dhe të vdekjes. Gjejmë si një leitmotiv edhe temën e çmendurisë. Tok me të edhe pyetjen se si ta ruajmë arsyen në një botë të çmendur.

Po ka edhe pikëpyetje të tjera. Ç'vlerë ka jeta? Ç'kuptim ka vdekja? Sa vlen dashuria?

A është ende jetëkrijuese? A është ende burim lumturie a të paktën gëzimi?

Këto pyetje shtrohen, po nuk u jepet përgjigje. Nënkuptohet se autorja po kërkon edhe vetë një përgjigje. Nuk kënaqet me përgjigjet e gatshme të disa filozofive a feve a ideologjive. Po ku qëndron e vërteta? A ka një të vërtetë absolute pas të vërtetave të vogla relative?

Mos vallë përgjigjet që jep shkenca? Po edhe shkenca ka caqet e saj, enigmat që nuk i ka deshifruar.

Lexuesi përpiqet të gjejë këtë të vërtetë së bashku me autoren e cila ka një respekt të veçantë për të. Për këtë arsye ne - lexuesit dhe kritikët - hyjmë në një labirint të ngatërruar dhe duhet të gjejmë fillin e Arianës. A po mos është fjala për një pyll? Një pyll të errët ku gjethnaja fsheh drurët? A ndodhet aty pema legjendare e së mirës dhe së keqes?

Fruti i ndaluar ka një shije të hidhur.

Lexuesi i çan vetes rrugën në mes të një pylli simbolesh. Edhe kategoritë gramatikore si, bie fjala, plotësat janë ngritur në lartësinë e simbolit.

Një simbol i veçantë është *lopa e kuqe*. Një simbol i shenjtë në një botë të çshënjtëruar: ("Strukturë e kuqe").

Idhujt kanë zënë vendin e idealeve.

Kafshët kanë zënë vendin e njeriut.

Le të kujtojmë krijimin "Garë pa kokë". Bukuria e këmbëve ka zënë vendin e bukurisë shpirtërore, e bukurisë së trurit. Trupi i njeriut hyjnizohet vetëm nëse është shndërruar në send, në objekt epshi.

S'është fjala as për një rikthim te kulti pagan i Erosit dhe i bukurisë fizike ku kishte ende diçka të shëndetshme. Tani njeriu është shkëputur egërsisht nga natyra dhe nga lidhjet me të, nuk e sheh më si nënë. Bukuria artificiale ka zënë vendin e bukurisë natyrore.

Dashuria si ndjenjë e fuqishme dhe e bukur, kulti i ndjenjës dhe kulti i gruas janë zëvendësuar me hipokrizi, me një kult të shkëlqimit të jashtëm që mbulon neverinë e brendshme ("Martesa e lumtur").

Ironia që përshkon shumicën e shkrimeve të Esmeraldës s'është një ironi që shkatërron tabu dhe mite për të krijuar vlera të reja, është një ironi tepër çmitizuese që gjeneron pesimizëm, jo ironia romantike, po ironia e pamëshirshme e pashermetizmit.

Krahas ironisë, në këto krijime rrjedh një rrymë e brendshme patosi dramatik të fshehur.

Në disa krijime ndihet etje për një dashuri të pamundur a ndofta të përkohshme, të lidhur me shijimin hedonistik të çastit (gjersa miti i dashurisë së përjetshme është shembur prej kohe).

Krijime të tilla janë "Të kam, të gjeta", "Me titullin, martohemi", "Falje", "Shkartisje", "Pothuajse ty", "Ngulmueshëm", "Po ti eja prapë", "Pëshpërima të sikletshme", "A më do?!", "Në majë të gishtave".

Jo rrallë Erosi dhe Tanatosi janë pranë ("Në qetësi me Jurën").

Këto dy forca nuk shihen si antitetik, po si bashkëplotësuese.

Vdekja e fuqizon dashurinë dhe fati i gruas personazh mbyllet në një kornizë absurditeti dhe tragjizmi. Një lumturi e shkurtër pasohet nga një vuajtje e thelle e gjatë, po shmanget agonia e ngadalshme e dashurisë dhe lumturisë.

Te "E mbrujtur me fat" protagonistja dhe vdekja janë të bashkuara në një dialog sureal dhe paradoksal ("I thashë se nuk doja të vdisja ...Vdekja ime qante për mua").

Frika shfaqet në krijimet e Esmeraldës si kujtesë historike (e lidhur me detaje konkrete të realitetit të diktaturës) dhe si ankth ekzistencial ("Frikë").

Mbi këtë realitet kaotik nganjëherë ngrihet një Perëndi që luan rolin e rregulluesit ("Zoti është i majtë", "Në stacione", "Braktisje jo e fshehtë").

Perëndia (simbol a hipotezë filozofike?) përpiqet të ndreqë gabimet e njerëzve.

Te "Braktisje jo e fshehtë" përpiqet të ndreqë paditurinë e tyre duke i detyruar me urdhër të lexojnë. Po ilaçi del më i keq se sëmundja. Një ironi e dhimbshme me një botë që humb çdo ditë e më tepër dëshirën për dije.

Ka krijime si "Ema pa emër", "Plotës që më lanë" ku ndihet si një kube e errët rënduese mungesa e së ardhmes. Dëshira për të lindur fëmijë shndërrohet në pamundësi, e tashmja dhe e shkuara ngatërrohen për të penguar të ardhmen.

Ema është vajza që *mund* të lindte, po ka shumë arsye për të mos lindur.

Djali që i kërkon nënës së ardhme ta lindë ngatërrohet me gjyshin.

Individi në krijimet e Esmeraldës është më tepër se i dyzuar, *i copëzuar*. "Infiniti" virtual i copëzave të personalitetit të individëve të skicuar synon drejt *zeros,* domethënë shkrirjes, asgjësimit të këtij personaliteti. Ata janë kryesisht njerëzit – valë të modernizmit, njerëzit që kanë humbur "un-in" e tyre. Shkatërrimi i personalitetit të tyre ka shkaqe historike dhe ekzistenciale, është i lidhur ngushtësisht me humbjen e një "qendre" rrezatuese që zëvendësohet me "rreze" të panumërta të shpërndara nga të gjitha anët.

Krijimet e Esmeraldës shtjellohen në përmasat e absurditetit dhe të një realiteti onirik.

Në to ndihen ndikimet e Sartrit dhe të Kamysë dhe, ndofta më tepër ndikimet e autorëve italianë Kalvino dhe Landolfi.

(Le të kujtojmë disa krijime të këtij të fundit, tepër karakteristike "Babai i Kafkës"[1] dhe "Deti i Buburrecave". Në shkrimin e parë shfaqet një merimangë e përbindëshme me kokë njeri që identifikohet me të atin e Kafkës dhe i jep rast një dialogu surealist midis Kafkës - personazh dhe autorit. Protagonisti vuan ndjenjën e fajit, po më në fund arrin ta vrasë merimangën simbolike).

Natyrisht s'është fjala për imitime nga ana e autores, as për një eklektizëm ndikimesh, po për impulse krijuese për të lindur shkrime të reja në frymë hermetizmi a pas-hermetizmi, meqenëse hermetizmi dhe pas-hermetizmi patën jetën e tyre të veçantë në letërsinë shqiptare që i largon nga letërsitë tepër të rafinuara franceze dhe italiane. Tek ne këto rryma lindën vonë dhe iu desh të djegin furishëm etapat. Ato janë lidhur me individualitete të caktuara krijuese që i përkasin shekullit të njëzetenjëtë.

Gjatë përpjekjeve tona për të shpjeguar domethënien e simboleve në krijimet e shkurtëra të Esmeraldës, parabola a skica qofshin ato, të vjen ndërmend vërejtja mjaft e mprehtë e studiuesit W.H.Auden në shkrimin e tij "Franc Kafka. Unë për veten" (Ex libris, Tiranë, 12.12.2020: "Kuptimi i një parabole është i ndryshëm për çdo lexues, prandaj një kritik s'mund të bëjë asgjë për ta shpjeguar" për të tjerët".

Mund të diskutohet nëse kjo vrejtje mund të shpjgojraninë e dy a më tepër të vërtetave relative që zëvendësojnë të vërtetën absolute në krijimet e shkurtra të Esmeraldës apo karakterin polivalent të simboleve të saj apo të dyja këto dukuri që janë të pranishme dhe ndërthuren.

Kritiku mund t'i sugjerojë lexuesit njerin nga shumësia e kuptimeve të mundshme, atë që ka hapur mendësia dhe ndjeshmëria e tij dhe që, kuptohet, ka një dozë të ndieshme subjektiviteti që s'përjashton bërthamën *objektive*. Lexuesi i bashkëpunues aktiv me autoren apo me kritikun/kritiken mund ta pranojë këtë sugjerim ose jo, sidoqoftë mund ta shohë si mundësi.

Sugjerimi i lartpërmendur mund të ndihmojë në gjenerimin e interpretimeve të reja.

Gama e ngjyrave në prozën e Esmeraldës është e kursyer. Në radhë të parë mbizotërojnë dy ngjyrat antitetike, dy ngjyrat jo-ngjyra, e bardha dhe e zeza me kuptimet e veta simbolike që i venë vulën disa krijimeve, mandej pasojnë *e kuqja* dhe *jeshilja*.

Proza e shkurtër e kësaj autoreje me talent ka arritur të mishërojë aspiratën e surealistëve për shkrirje midis ëndërrës dhe realitetit dhe synon t'u përgjigjet atyre dy thirrjeve që Milan Kundera i kërkonte me mençuri për rilindjen e romanit në kohën tonë, *thirrjen e lojës* dhe *thirrjen e ëndërrës*. Po bëhet fjalë për t'i realizuar në caqet e prozës së shkurtër, pra, në një hapësirë të kufizuar që autorja synon të ngushtojë sa më shumë, pra, për një mjeshtri të veçantë të saj në artin e fjalës.

Duhet pasur parasysh se hermetizmi apo pas-hermetizmi i Esmeraldës nuk e përcakton në vetvete *literalitetin* e krijimeve të saj, nuk i japin vlerë më të lartë estetike nga ç'do t'i jepte, bie fjala, realizmi, ai lloj realizmi ende i pranishëm në letërsinë shqipe.

Krijimet e Esmeraldës zotërojnë në fakt literalitet, meqenëse ajo s'e ka përqafuar hermetizmin (apo pas-hermetizmin) për modë, po ka gjetur në këto rryma realizimin e individualitetit të vet krijues, mënyrën e vet të të shndërrimit e realitetit në art.

Folëm më lart për konçizitetin e habitshëm të Esmeraldës, konçizitet që bashkohet me larminë e mesazheve të saj dhe fantazinë e saj të begatshme.

Duhet të shtojmë se autorja dallohet edhe për një pasuri leksiku, për gërmimin në minierën e pasur të shqipes në dialektet dhe nëndialektet e saj.

Errësia në prozën e shkurtër të kësaj autoreje zakonisht është shprehje thellësie, po ka edhe raste që llava inkandeshente e fantazisë, vrulli i frymëzimit e çojnë shkrimtaren në një teprim të kësaj errësie që mund të dobësojë efektin emocional.

Vëllimi Esmeraldës mbetet *origjinal* në kuptimin e plotë të fjalës.

1 Këtë skicë mund ta gjejmë te: Tommaso Landolfi, F*aqet më të bukura*, "Elite", Tiranë, 2000. E dyta s'është përkthyer.

ME POETIN NIKO KACALIDHA DHE "HERALDIKËT E BORËS"

Nga Armela Hysi

"Preva pikën e lotit vertikalisht me thikën
e përgjakur të horizontit
e pashë brenda tij njëmijë varre të
shtrira,
dhe ndjeva në të njëmijë e një rënkime.

Preva pikën e vesës horizontalisht
dhe më brofën kodrash brenga
refugjatësh
Dhe m'u tkurrën në shpirt mijëra
humnera dhimbjesh

Dhe kërcyen së larti njëmijë horizionte
gjaku"
(poezia "Prerje gjeometrike")

Është e pamundur të përmendësh poetët më të ndjeshëm postmodernistë shqiptarë e të mos gjesh në radhitjen e emrave të rreshtit të parë atë të poetit të ndjesive të epërme, Niko Kacalidha!

Siç është e pamundur të marrësh në dorë një libër të tij e të mos kuptosh se ke të bësh me një shkollë të madhe idilike e shumëperceptuese. Të mos vësh re sesi rrjedhë dëlirshëm bukuri stoike poetike, në trajtën më të formëzuar të talentit dhe mëtimit gdhendës. Sikurse dhe po aq ndienjë amorfe prej esencës ideale të fjalës në modernizmin më romantik të saj.

Dhe kjo bukuri i mbetet brenda vetes kujtdo që e ndesh në leximet e tij. Bulon tek lexuesi që e shtjellon, tek kujtesa dhe estetika e tij për ta rikrijuar sërish si shembëllimet gjeometrikisht të pasqyruara në dy pasqyra paralele, përballë njëra-tjetrës e tek njëra-tjetra. - Analogjikisht në zvogëlim regretik kohor, por pa u zhdukur herët ky imazh që të fal, e gjitha krijuar prej lehtësisë sublime që të jepet ta shijosh.

Sepse lexuesi, studiuesi, kritiku a krijuesi, shëtit lirshëm dhe i mirëpritur ngrohtë, brenda poezisë së Niko Kacalidhës, aq më shumë tek vëllimi i tij i fundit **"Heraldikët e borës"** me shtrirje racionale në kohë-krijim, tematikë, evoluim letrar e për më tepër përvijim historik të segmentit kohor të shoqërisë e detyrimisht të autorit si pjesë e saj specifike, referuese dhe e dalluar.

Katsalidha krijon që herët në rininë e tij bazat e një letërsie që prin kohën e tij duke u dhënë pas fjalës pa rezerva, dhe vijon pa ndërprerje e me rikonstruktim të vazhdueshëm, tepër sensibël përgjatë stacioneve të flurudhës së jetës së tij, gjë që shfaqet vazhdimisht, e duke lënë gjurmë mbi krijimtarinë e tij. Kjo ndodh si një proces i natyrshëm, duke qenë se poezia e tij është një qenie e gjallë që frymon në të njëjtin organizëm me autorin, por dhe si tek çdo autor i vërtetë, po aq autonome në bindjet e veprimtarinë e saj kryeneçe, - shumëfishuese me faktorë numerik para a pas të ndaras dhjetore, sipas ngjarjeve që ajo përjeton - pa lejuar t'i diktohet shterpësisë a komformizmit kllap-gjymtues.

Po kështu edhe përgjatë ndryshimeve politike, të shoqërisë, e ideore të vetë autorit siç ndodh për rrjedhojë, kur: *jeta ndodh*, - edhe në ekografinë e poezisë do të vëmë re hapësira të reja që krijon botkuptimi, siç natyrisht, përherë krijohen stacione të reja.

Lexuesi, me secilin reciproritet të sipërpërmendur, krijon marrëdhënie mbresëlënëse me krijimtarinë e autorit, duke iu dukur tepër e hijshme, nga çfarë do lloj roli që ta shohë, pikërisht pasi për çdonjërin nga këto kahe a drejtime që hulumtojnë një vepër, Kacalidha arrin me mjeshtëri akute në secilën poezi, të krijojë një pikë të përbashkët estetike e kuptimore, që gjendet kryesisht, në përjetimin e diçkaje gati familjare tek bota e tij e tek timbëri i vargut të tij. Njëkohësisht arrin të të qeras me tekst të zgjedhur, elegant, tërë risi ngjyrimesh gjuhe e idesh në secilin prizëm.

Autori pra veçanërisht nxit pareshtur dritë-mendimin që ka absorbuar, për t'u përçuar dhe përvetësuar në vazhdim me aq lehtësi nga lexuesi. Siç dhe vihet re, se të mbetet njëkohësisht e pashlyeshme nga kujtesa inkadeshente, marrëdhënia që e vendos me lexuesin duke i kursyer mundin që të rëndohet nga balasta të kota ballancimi, në lundrimin me poezinë e tij, si mjet për emancipimin e gjuhës, strukturës dhe idesë në hapësirat më të larta të mendimit krijues shqiptar, dekada të tëra, deri më sot, pa humbur as çast, sensin e hollë poetik.

"Hap perden e agullimit dhe zgjoj ditët
e mia
mbuluar me një cipë hënësire, zgjoj
anëdetet
dhe kridhem në kërthizën e fateve të
mia." (nga poezia "Këngë ballkanase")

Edhe pse më ka rënë rasti i mirë të shkruaj për poezinë apo përkthimet plot pasuri e origjinalitet cilësor të personalitetit të njohur të letërsisë greke e shqiptare njëkohësisht, zotit të nderuar Niko Kacalidha, përherë kam mendimin se kur mbaron një libër të tij nuk mund të mos kesh kënaqësinë të shkruash sërish, të vësh në dukje sërish sa bukur kalon si lexues nën shoqërinë e vargjeve të tij, dhe ta rekomandosh sërish miqve të afërt, a lexuesve që të ndjekin. Nuk mund të mos u thuash atyre të mos e humbasin lidhjen me poezinë e tij të bukur estetike e elitare që dhuron në çdo faqe, ose të mos humbasin rastin ta njohin këtë poet nëse e lexojnë për herë të parë! Bëhet gjithmonë fjalë për një poezi me gjetje mjeshtërore dhe një thesar ndjesish, që të realizojnë më së mirë jo vetëm dëshirën për të lexuar diçka me vlerë, që ka kushdo që merr i lirshëm në duar një libër të ri për të lexuar, por edhe pasurimin me botkuptimin e veçantë që ndesh gjatë leximit të çdo poezie. Pa harruar dritësimin që përmendëm si brumë poetik në gjetjet e sipër përmendura që personalisht do t'i quaja simbolikisht edhe të vyera, edhe të ëmbëlsjella në përqasjen e së vërtetës së botës së tij poetike, meqë stili dhe ndërthurjet e pamjeve, ideve të shumëllojta janë përherë me një stilizim fisnikërorë dhe trajtim idilik. Prore të një gdhendjeje fine. Peizazhi, elementet e natyrës, sfondi, përshkrimi, bashkëpunon përherë me vetë boshtin e idesë qendrore, duke rikrijuar në mënyrë cirkuite të brishtë e tepër ndjesore njëri-tjetrin.

Në çdo poezi Niko Kacalidha i jep lexuesit varg pas vargu ndjenjat më të epërme që i kujtojnë diçka familjare për nga ngrohtësia, fëmijënore për nga ngjyrat, kalorsiake, për nga trajtimi bujar e i emancipuar me vlera gati të romantizmit shpirtëror që zbusin aq shumë me idealizimin që përçojnë dhe megjithatë rioshe në pikëpamje, për një hap më tutje në mendimin e tij filozofik e në edukimin e tij estetik, post moderniste dhe që diktojnë tempin e nervin e kohës.

"Krenaret e mia që kurrizo nuk u bëtë
kurrë,
paçka se me bucelat ngarkuar në mes të
fushës
ktheheshit bosh dhe ngjanit si mijëra
pikëpyetje
të mirat e mia, gratë, në atë gravurë të
vjetër." Nga poezia "Gravurë e vjetër
dropullite"

Vëllimi **"Heraldikët e borës"** që më ra në dorë kohët e fundit është një takim veçanërisht i denjë që personaliteti Niko Kacalidha kryen me lexuesin. Është një përmbledhje ngopëse prej mëse pesëqind faqesh, që përmban një pjesë të madhe poezish përgjatë krijimtarisë së poetit, që nga rinia e tij, ndërkohë që janë të përfshira edhe tërë kontigjenti me poezi të pabotuara të autorit, duke na dhënë mundësinë të hedhim dritë dhe të kemi rastin ideal të njihemi thellë me poliedrikën e tërësisë së krijimtarisë, nën hijen e këndvështrimit më të pjekur të tij sot, si në paraqitje, ashtu edhe në përzgjedhjen optimale.

"Grusht shtëpish ndanë bokërrime i thonë qiellit:

Këtu fillo!" Nga poezia "Grusht shtëpish ndanë bokërrime"1989

"... Me puthjet nën heshtjen e varur
abazhurit.
Me kërcitje variable të frigoriferit.
Peshqit në akuarium mendojnë se s'ka
për ta tufan.
Harruan detin e origjinës, madhështorin,
djepin
tundës e kripën Eolin me kacekët e
erërave.
Poseidonin me fushnjën e frikshme të
trazirave,
të rrahjeve detare dhe rebelimit.
Peshqit në akuarium mendojnë se s'ka pë
ta tufan.

Vetëm, sa herë, ndërrohet uji, me sy lëmoshë kërkojnë në xham." Nga poezia "Peshqit në akuarium"

Vargu i lirë i Kacalidhës ka përherë veçorinë të jetë i plotë aq poetik sa e fëshfërinë i mëndafshtë nga tjerrja mjeshtërore, por dhe aq prozator, veçanërisht, kuptohet tek ato ndalesa që kanë këtë strukturë, dhe mjaft i zhdërvjellë, tolerantë në kuptueshmëri dhe tepër i larmishëm. Gjuha shumë e pasur gjthashtu ka veçoritë të përfshijë një vazhdë të tërë ndiesish, sa konceptive aq edhe praktikisht të një produktiviteti që dikton vezullueshëm gëzimin poetik të shumëllojshmërisë së pamjeve që të vijnë ndër sy, me çdo lexim të secilës, e po aq lëngshëm çdo herë që mund të vijosh ta lexosh.

Ndërkaq që formati i poezive, edhe pse padyshim varjon, të mahnit me sa shumë thotë, shpesh në pak, relativisht, vargje. Është gjithashtu për t'u përmendur në këtë libër, sesi në secilën poezi gjenden togfjalësh mahnitës që nuk i pret, si surpriza të vogla idilike.

Kështu pra ky synim i përherëshëm i përkushtohet drejtësisht një gjetjeje të veçantë që ndonjëherë të lë me dëshirën të mos shkëputesh, nga poezia e tij edhe pasi ke mbyllur rreshtin e fundit. Të duash të vazhdosh të festosh osmozën e krijimtarisë së autorit çfarëdo ngjyrimi që të ketë poezia, pasi ky vëllim është një përvijim që i përfshin të gjitha ndienjat e fisme të njeriut. Që të

dashurosh, - (ku më mirë se me një poezi?); të luash me natyrën, me qeniet e saj, me kohën në tërë dimensionet e saj, të kujtosh dashurinë e të afërmve, të miqve, të figurave mitike a historike, të pasionit, të shpresës... të sa e sa komponentëve tematikë e letrar të ndërthurur së bashku.

Të triumfosh me art mbi jetën me bukurinë e përjetshme të marrëdhënieve njerëzore.

E së fundmi, në ngjyrimin e errët të dhimbjes të njohësh veten e të sitësh ditët e përkora, dhe çastet e lumturisë. Për t'i vlerësuar e të mos i lësh të të sorollasin tuneleve të labirinthit mendësor e obsesivitetit, që në krye të herës e perceptimit, gjer në posedimin e njerëzores thelbësore. Pa altruizëm viktimë-ndjellës ndaj vetes, por si një përzgjedhje koshiente e të kultivuarit dhe qëllimin jetik të përmbushësh dashurinë për mirësinë sipërore personale e kolektive që rrjedhë në plan të sigurtë.

Artibuti i bukurisë së poezisë tek Kacalidha është edhe fakti se temat që trajton janë gdhendur të të duken të thjeshta në detajim por të filozofuara në përvijim. Të pëlqen "aventura" që të buzëqesh për tek mbyllja e çdo veçimi, dhe i je mirënjohës vëmendjes së këtyre premtimeve për të ndjerë në çdo faqe lirinë poetike që të jep shkathtësia e dijes dhe kontesimi i saktë i mendimit të tij, në përçim, mbrujtur me art.

Kohë-hapësira luan një rol vendimtar në formulimin e idesë themeltare tek Kacalidha dhe nuk fshihet pas hermetizmash fiks e të stimuluar, apo role kinse të lojë-çartjes, por përkundrazi, kur autori i shton pak puhi vargut e bënë me përgjegjësi të plotë dhe të mirë-themeluar. Veçoria më e thekur dhe e thukët që do të gjeja unë tek krijimtaria e Kacalidhës, që gjen bulim të plotë edhe tek **"Heraldikët e borës"** është marrëdhënia e tij me vendlindjen. Autori është përherë, i tokëzuar me truallin e tij, me vendlindjen, kulturën, folklorin, mitologjinë, dashurinë e shumë trajtë të simbiozës me të gjitha thelbësitë themeltare e primare të kësaj lidhjeje në mënyrë shumë aktive dhe ripërtëritëse, qoftë për të shpënë shkarkimin e ngarkesës së tepërt patetike, qoftë si Ante të thithi nevojshëm energjinë që i duhet të përfundojë idenë me ballafaqim bindës e të mirëgdhendur figurativ.

"Po është një kalë që hante barin e mëngjesit
në pëllëmbën e trëndafiltë të fëminisë sime,
që puthja në ballin e dirsur në netët e hënës.
Po është një kal që po mban kalorës
të fluturimit e dhimbjes dhe me kryet e mia prekja yllin e mbrëmjes/.../.../
Një kalë që i fshija lodhjen me këmishën time
të qepur prej nënës në dritën e vetëtimës."
(Nga poezia "Kali")

Të lexojmë letërsi të mirë është bekim e pse jo edhe një farë detyrimi shpirtëror për veten e ata që kemi pranë, një lloj shenjtërimi dhe një lloj dashurie për njerëzimin, fëmijët që rrisim e edukojmë, kohën reciproke që na u dha me bujari të njohim, të ndjejmë, të krijojmë. Një lloj vlerësimi më i tejmë për dhuratat e Hyut për prafullimat e të mrekullueshmes që u ka dhuruar njerëzve ndaj jetës, ndaj bukurisë që ravijëzon mekanikisht, e asaj të brendshmes si frymë, që krijon e i jep kuptim të jashtmes. Që ngrihet unike për çdo person, për çdo çast të secilit preson, për çdo çast që vetëm kështu do mund t'i japësh fuqi infiniti. **"Heraldikët e borës"** dinë të zgjojnë mjaft vringëllima simbolike për të kuptuar vërtetësinë, tërësinë, vetveten, për të fisnikëruar e freskuar, dhe si çdo vepër që duke qenë art i mirëfillt, di shumë, përcjell shumë, vjen nga një dritësim tjetër e mëkon përjetësi.

Athinë 2025

Bekim Blaku, "Qetësi e prishur", poezi, BUZUKU, Prishtinë, 2025

DHIMBJE E SHNDËRRUAR NË KLITHJE POETIKE

nga Biser Mehmeti

Bekim Blaku është ndër ata poetë që poezinë e shkruan me një maturi të theksuar, po që është tepër i kujdesshëm në procesin e botimit. Prandaj edhe deri më sot ka arritur të botojë vetëm tri vëllime me poezi, në të cilat patjetër që është shpërfaqur ndjesia e tij e thellë prej poeti të talentuar.

Një drejtim i duhur si lajtmotiv

Vëllimi poetik "Qetësi e prishur" i poetit Bekim Blaku, botuar para pak kohësh nga shtëpia prestigjioze kosovare "Buzuku" në Prishtinë, shpërfaq në masë të theksuar ndjesitë e poetit gjatë rrugëtimit të tij jetësor duke u ballafaquar me sfida të ndryshme, sidomos në theks të veçantë gjatë kohës së qëndrimit të tij në dhe të huaj, ku aktualisht edhe jeton. Në një mënyrë apo në një tjetër vargjet e këtij vëllimi janë frymëzim i poetit gjatë qëndrimit të tij të gjatë në mërgim dhe si shumë krijues të tjerë edhe Blaku nuk ka mundur të mos i shpreh në vargje mallëngjimin dhe vajin e tij të brendshme, ndjenja këto të cilat sikur nuk e kanë lënë të qetë gjatë gjithë kohës, duke e ngacmuar gjithnjë nervin e tij krijues.

Gjatë një leximi të kujdesshëm që i kam bërë këtij vëllimi poetik, një gjë më ka bërë përshtypje: poeti në pjesën më të madhe të poezive shpalos me vargje mjaft të realizuara, me një kujdes dhe ndjesi shpesh emocionale, një pjesë të rëndësishme të autobiografisë së vet, sa të bëhet sikur nuk je duke lexuar autobiografinë e një krijuesi që ka bërë një rrugë mjaft të vështirë gjatë jetës së tij e të cilat i kanë mbetur të skalitura në kujtesën e tij. Prandaj edhe mund të thuhet se ky vëllim është një lloj letërnjoftimi i poetit Bakim Blaku, të cilin dëshiron ta ndajë me lexuesit e tij. Nuk është thënë kot se poezia dëshmon shpirtin e poetit. Sipas kësaj del që poeti është i preokupuar në radhë të parë me jetën e vet, prandaj edhe gjithë ato gjëra që i janë skalitur në një cep të mendjes i shpërfaq përmes vargjeve, duke përjetuar një lloj katarsisi, i cili i duhet poetit. Këtë ai edhe e synon me çdo kusht, ngase nuk ka ndonjë mënyrë tjetër për të qetësuar shpirtin e trazuar nga krajatat e jetës së përditshme. Këtë ndjesi apo mbase edhe moton e tij jo vetëm krijuese, por edhe jetësore, e shpreh duke përdorur një gjuhë të realizuar metaforike në poezinë me titull "Drejtim i duhur" përmes vargjeve:

Jam krenar
Me hapat e mi
Të vegjël
Në drejtim të duhur
(Qetësi e shprishur, f. 90)

Metafora e qetësisë dhe e shqetësimit

Mirëpo, çfarë simbolizon titulli i këtij vëllimit poetik "Qetësi e prishur"? Për çfarë qetësie është i shqetësuar poeti Blaku? Natyrisht që flet për një shqetësim që e ka brenda vetes, e cila nuk është shkaktuar nga qetësia, po përkundrazi nga shprishja e qetësisë. Është i njohur fakt se të gjithë njerëzit e kësaj bote e duan qetësinë, madje edhe në jetë orvaten të arrijnë qetësinë relative! Edhe poeti Bekim Blaku e do qetësinë, sidomos atë të shpirtit, sepse është e domosdoshme për një jetë të lumtur. Mirëpo parashtrohet pyetja: a është e mundur që vetë poeti dëshiron ta prishë qetësinë e njëtrajtshme, pasi është duke u ballafaquar një kohë të gjatë me valët e rrëmbyeshme të kësaj "qetësie", e cila ka filluar të bëhet e padurueshme, mbase edhe e neveritshme! Megjithatë, në vargjet e kësaj poezie të përzgjedhur për të titulluar vëllimin poetik, preokupimi i tij kryesor është ta ruajë qetësinë e shpirtit me çdo kusht, sepse ajo ka një rëndësi të madhe. Prishja e kësaj qetësie nga faktorë të jashtëm, për çudi, i sjell poetit kënaqësi të madhe. Në anën tjetër poeti me shpirtin e tij të ndjeshëm, nuk shqetësohet pse i është prishur qetësia, ngase nuk mund të mendojë të jetojë në qetësi për një kohë të gjatë. Sipas poetit Blaku qetësia për një kohë të gjatë është e mundimshme tepër deri në shqetësim, prandaj edhe është i gëzuar që qetësia është prishur, ngase e ka të qartë se një qetësi e gjatë na pret një ditë kur të mbyllemi në qivur. Poeti është i vetëdijshëm se qetësia ka dy anë të kundërta, të cilat shpeshherë duhen përjetuar pa dëshirën tonë si pasojë e rrethanave jetësore, të cilat nuk varen nga mënyra e jetës, po nga rrethana të tjera që jemi të detyruar t'u nënshtrohemi pa dëshirën tonë. Poeti gëzimin e tij e shpreh më së miri përmes vargjeve lakonike, po mjaft domethënëse të kësaj poezie:

Më mirë qetësi e thyer
Qoftë në gur a në mur
Sesa fund e krye
Qetësi pa fund
Si ajo e fundit
Qetësi në qivur
(Qetësi e prishur, f. 6)

Klithjet dhe vaji i mërgimtarit

Edhe poezitë e tjera të këtij vëllimi janë përjetime të autorit gjatë jetës së tij, sidomos pas largimit të tij nga Kosova e sidomos jeta e vështirë në mërgim. Në këtë aspekt dominojnë poezitë për mallin dhe dhimbjen jo vetëm për vendlindjen, por edhe për prindërit e çdo gjë tjetër që ka të bëjë me Kosovën.

Është vështirë, në mos edhe e pamundur, të gjesh një krijues serioz që një pjesë të madhe të jetës e ka kaluar larg atdheut, të mos shpërfaq në poezitë e tij sadopak dhimbjen dhe mallin për atdheut. Edhe Bekim Blaku në këtë vëllim poetik ka shpërfaqur me një gjuhë herë-herë të drejtpërdrejtë, herë-herë të figurshme dhimbjen e pandërprerë, e cila e ka djegur si zjarr brenda vetes. Një pjesë e madhe e këtij vëllimi poetik, "Qetësi e prishur", është e mbushur me këtë motiv, të cilin autori duket sikur gjatë kohës sa e shkruan e ndien dhimbjen si trazohet brenda vetes. Është një dhimbje që shpesh shndërrohet në klithje ndaj vetvetes, të cilën sikur e akuzon pse nuk gjendet në atdhe, po larg tij. Mirëpo duket sikur poeti qëndron vetëm me trup larg atdheut, sepse atë e ka brenda shpirtit të vet, të cilin nuk mund ta shmangë dot. Poeti nuk ka sesi të mos vajtojë me zemër të plagosur kur kupton gjendjen e vështirë në të cilën ndodhej dikur Kosova. Prandaj edhe tërheq një parabolë në mënyrë që të shpërfaqë gjendjen e tij shpirtërore në vendin ku është duke jetuar dhe me Kosovën, e cila është "mbërthyer në dimër siberian, kurse në Romë zogjtë cicërojnë" (*Qirinj e diell lirie*, f. 15). Edhe në poezinë tjetër me një gjuhë metaforike poeti shpreh mallin e tij të pashuar ndaj atdheut. Mjaftojnë të shohim vetëm dy vargjet e para të poezisë *Mëngjesi gri*:

Më forcën e shpirtit
Dua t'i ngreh diga mallit

Dhimbja e poetit është tepër e madhe, aq e madhe sa ai vajton me zemër të thyer atëherë kur është në pyetje vdekja e një mërgimtari, i cili në një vend të largët ka shkuar për të kërkuar shpëtim nga vdekja, po që është ballafaquar me vdekjen. Mendoj se është një ndër poezitë kur autori Blaku dëshmon talentin e tij krijues. Përmes vargjeve të shkurtra poeti arrin të përmbledh me mjaft sukses gjithë ato përjetimet e tija kur mërgimtari kthehet në urnë i shoqëruar nga i vëllai, kurse amaneti i tij ishte:

Paqja ime e fundit
Pranë varrit të nënës
(Siluetë kujtese e qetësi varri, f. 12)

Që të bindemi se sa zjarr të fuqishëm poezi ka brenda vetes, kur është në pyetje atdheu i tij (i ynë!), të cilin e ka braktisur për shkak të ngjarjeve tashmë të njohura. Mirëpo, për dallim nga shumë shqiptarë të arratisur nga Kosova, Blaku gjithnjë është kujdesur që përmes vargjeve të zgjedhura të shfaqë atdhedashurinë. Mund të themi lirisht se poezitë në shpirtin e tij të trazuar nuk ndien vetëm dhimbje e vaj për atdheun, po në anën tjetër ai ndien edhe krenari, sidomos kur e kupton se Kosova nuk është më ajo që ka qenë dikur e okupuar, po tashmë është një Kosovë e lirë dhe e zhvilluar si kurrë më parë. Prandaj edhe këto vargje tregojnë më së miri si shprehet për kohën e tashme, gjatë së cilës shohim se me ndryshimin e Kosovës ka ndryshuar edhe gjendja e tij shpirtërore:

Tash frymon lirshëm
I dashur Atdhe
Kosova ime
(Të shoh si gjithherë, f. 29)

Vlera e vëllimit poetik

Vëllimi poetik "Qetësi e prishur" i Bekim Blakut përmban gjithsej 97 poezi. Derisa shumica e poetëve përmbledhjet e tyre poetike i ndajnë në cikle sipas motive të shfaqura, Blaku nuk e ka bërë një gjë të tillë. Mendoj se shkaku pse autori nuk e ka ndarë vëllimin e tij poetik në cikle është sepse ka dashur të largohet nga forma tradicionale e të shkruarit të poezive. Në anën tjetër mund të jetë edhe shkaku që poezitë edhe pa i ndarë në cikle mund të ruajnë kontinuitetin sidomos tematik nga njëra poezi në tjetrën. Sa i përket vlerës estetike mund të themi se vëllimi poetik "Qetësi e prishur" dëshmon se autori ka arritur në masë të kënaqshme të na sjellë poezi mjaft të qëndrueshme jo vetëm në aspektin ideor, por edhe estetik. Një çështje që duhet theksuar është se poezitë kryesisht janë të shkruara me vargje të shkurtra, por që arrijnë të përmbushin mjaft mirë idetë e autorit. Një çështje tjetër që do theksuar është se vepra poetike është e shkruar me një gjuhë metaforike të perceptueshme. Në disa poezi poeti idetë e tija i shpreh përmes vargjeve me anë të një gjuhë që në shikim të parë duket e thjeshtë, por që në të vërtetë është e përbërë nga figura të ndryshme estetike ndër të cilat dominon metafora.

Botim i ri nga "Onufri"

DURIM TAÇI

Spirale të shtrira

Tregim

Lakorja e fundit e shtrirë nuk kishte qenë më rruga, por trupi i saj në ulëse. Sa hape sytë në spital, e kërkove, por askush nuk të dha përgjigje. T'u afrua një infermiere, të bëri një gjilpërë në damarë dhe në kllapinë para gjumit t'u shfaq përpara gjithë ajo që kishte ndodhur. Kthesa të pafundme që i kalonit bashkë në heshtje. Përpiqeshe të ruaje mendërisht sensin e drejtimit, se të ngatërrohej ikja me kthimin në të njëjtën rrugë. Makina që ju ndiqte tani nuk mund të kishte qenë edhe në nisje.

Pas një turbullimi fillove të kujtoje qartë. U kishte ardhur një ftesë në gazetën "Ora jonë" për të ndjekur Panairin e Parë të Librit në Prishtinën e pas Luftës së Kosovës, që do të zhvillohej nga data 17 deri në 22 nëntor të vitit 1999, nga e mërkura deri të hënën.

Enea lë leximin. "Po e di këtë gjë, more Art. Ma ke treguar kushedi sa herë", - thotë me vete. - "Nuk është letërsi kjo!" Por pastaj e kap një mallëngjim i befasishëm. I shfaqet imazhi i trupit të tij si ndonjë krap gjigant i vrarë me dinamit. *Është faji i Artit.* Ato rrëfimet e tij mbi dhunën që kishte pësuar kishin bërë efektin e tyre.

Enea vazhdon leximin.

Kishe disa motive që të shtynin të shkoje në Kosovë, edhe pse nuk po dije si t'i rendisje për nga rëndësia. Më konkreti ishte se sapo kishe blerë makinë dhe doje ta provoje në një rrugë të gjatë. Këtë gjë nuk e thoshe hapur. Makina pastaj do të të çonte pikërisht në Kosovë, vend në të cilin do të shkelje për herë të parë. Do t'u ktheje, me gjasë, edhe vizitën miqve të tu, që i kishe mbajtur në shtëpi si të shpërngulur gjatë Luftës së Kosovës. Do të ishe pastaj për disa ditë në një habitat që të pëlqente, në një panair libri.

Të kujtohet edhe një herë trupi i saj i shtrirë në ulësen e udhëtarit. Kjo ta ndryshon befas kahun e rrëfimit. Në fakt, ndjekja kishte ndodhur duke u kthyer nga Kosova, për të cilën Ekti nuk dinte gjë. Ti nuk i the asnjë fjalë gjatë rrugës.

Po ku ishte tani Ekti? Çfarë kishte ndodhur me të? Nuk arrije të kujtoje mirë. Provove të zgjoheshe, të lëvizje, por e ndieje se nuk kishe forca.

Po, motivi kryesor i udhëtimit tënd ishte, mbase, të kaloje me gruan disa ditë larg së përditshmes.

Sapo le kufirin matanë, ndjeve mungesën e peshës. Shikoje Ektin herë pas here dhe zhyteshe në mendime. Edhe ajo duhet të përjetonte diçka të ngjashme me ty. Si brez, e kishit humbur shpresën se do ta kalonit një ditë këtë kufi. Dhe kjo ishte mënyra më e paimagjinueshme. Shkonit në Kosovë si të shkonit në një krahinë çfarëdo të Shqipërisë.

Pas pak kilometrash, ju nxjerr dorën një udhëtar. E ndal makinën. Prisni të hapë gojën ai i pari. Ju flet shqip. Është arsimtar. Ju thotë se kthehet nga Zhuri në Prizren, pasi ka mbaruar mësimin. Ishte një normalitet që ju bëri të ndiheshit mirë. Në Prizren banojnë edhe miqtë tuaj, por ju do të vazhdonit drejt Prishtinës. Vizitën për tek ta do ta linit për në kthim. Panairi hapej pasdite. U përshëndetët me mësues Blerimin, me një ndjesi sikur e kishit njohur prej kohësh, pa menduar fare se vazhdimi i udhëtimit do të vihej në dyshim vetëm pas pak. Rruga, në një gjendje shumë më të mirë me çfarë ishit mësuar në Shqipëri, kishte tek-tuk gropa të thella mbetur nga bombardimet.

Nuk do ta ndryshosh kahun e rrëfimit. Do që të ndjekësh një kronologji të saktë. Të flasësh në fillim për atë që të ndodhi në Kosovë dhe më pas të vazhdosh me kthimin.

Si u ndatë me mësuesin, vazhduat rrugën të patrazuar deri në hyrje të Prishtinës. Një pakujdesi dhe pavëmendje jotja bëri që të binit në njërën nga gropat e rrugës shkaktuar prej bombardimeve. Por, kur e tregonit me njëri-tjetrin tani në kthim, pas pesë ditësh në atë qytet, gjithçka dukej bukur, edhe ai incident. Kishit çarë gomën, kishit shtrembëruar një semiaks, një defekt ky i fundit që mund t'u bënte të braktisnit makinën dhe të merrnit taksi për të mbërritur në ceremoninë e hapjes së Panairit. Mirëpo, brenda një ore ishte rregulluar gjithçka, ndërsa prisnit duke ngrënë në një lokal për herë të parë bukën e Kosovës që ju kujtonte disi atë "pestedyshen" e Tiranës së viteve '70-`80.

Ja që truri yt të shtyn të tregosh vetëm kthimin. Sigurisht, për shkak të makinës që po ju ndiqte. Kaloni edhe një herë kufirin drejt Shqipërisë. E dini çfarë ju pret. Orë të tëra rrugësh me kthesa nga Kukësi në Kalimash, në Lajthizë, në Qafë të Malit dhe më në fund, dalja në Fushë-Arrëz.

Tani kthjellohesh pak. Ju ka ndodhur diçka e rëndë. Ti ndodhesh pikërisht në Fushë-Arrëz, ku e kishit planifikuar të ndalonit e të hanit drekë, para se të merrnit rrugën për Tiranë. Sigurisht, nuk e kishit menduar se do të përfundonit në spitalin e qytetit. Po ajo? Ekti, gruaja jote. Të paktën ta kishin sjellë në një dhomë me ty.

Po, kujtimet për pesë ditët e kaluara në Prishtinë e Prizren do t'ju sillnin deri këtu në këtë spital. Por kjo do të ndodhte më vonë. Në fillim flisje ti, i kënaqur me riparimin e makinës, me ceremoninë e hapjes së Panairit, pastaj nisje të riprodhoje bisedat me miqtë e tu të Prizrenit. Kujtonit ditët e Tiranës bashkë. Si u përktheje lajmet e i mbaje me shpresë, derisa do të nisnin bombardimet. Është rasti më i çuditshëm në botë, mbase, se si një popull pret të nisin bombardimet e një vendi tjetër si mjet shpëtimi për fatin e tij. Nëse harrohet konteksti, gjithmonë kjo do të ketë nevojë për shpjegime.

Shfaqja në pasqyra e "Benz-it 240" ta ndërpreu fjalën. Kishit lënë me kohë Kukësin dhe pas një morie lakoresh në ngjitje, po mbërrinit në Kalimash. Aty e mori fjalën Ekti, duke menduar se e le dërdëllitjen tënde për të respektuar atë. T'i thoshte edhe ajo dy fjalë. I kishte bërë përshtypje se kudo, në restorantin e hotelit dhe në të gjitha lokalet e Prishtinës, sapo kishte hyrë, ia kishin marrë pallton dhe i ishin drejtuar me shumë respekt. Pastaj u kthehej bisedave në Prizren me miqtë. Ajo i kishte marrë nga rruga dhe i kishte sjellë një mbrëmje në shtëpinë tuaj në Tiranë. Ishin ditët e para të prillit 1999. Kishte parë një nënë me dy fëmijë të rritur. Po "fëmijë të rritur". Berati dhe Saranda ishin dy fëmijë të moshës 23 dhe 25 vjeç. Ishte një furgon me të shpërngulur nga Kosova, i caktuar për të shkuar në Durrës.

Ekti kthehej nga Laçi me një makinë tjetër, që ndaloi pas tyre. Nëna me dy fëmijët kishin zbritur nga furgoni, duke këmbëngulur të shkonin në Tiranë, se aty kishin të afërm të tyre të kahershëm. Por një polic që merrej me shpërndarjen e të shpërngulurve nuk lëshonte pe. Thoshte se kishte urdhër të prerë. Nuk lejohej asnjë person më shumë në Tiranë, se ishte e tejmbushur. I urdhëroi të hipnin edhe një herë lart, pasi nuk mund t'i linte të ecnin të pashoqëruar rrugëve.

Gruaja qe dorëzuar, më në fund, edhe pse, siç do të merrej vesh më vonë, mund ta kishte bindur policin se ku do të shkonte. Ajo kishte një djalë mbetur shumë kohë më parë në Tiranë, por ja që nuk mund të fliste, se nuk mund të zbulonte identitetin e saj. Ajo grua ishte edhe nëna e njërit prej liderëve të Kosovës, që ishte i ngërthyer në rivalitetet politike të kohës. Mendonte se rrezikonte fëmijët që kishte me vete duke thënë emrin e tij.

Ekti, që vinte nga Laçi, ku administronte një biznes të vogël, ndodhej në makinën mbetur në trafik pas furgonit. E kishte dëgjuar bisedën, kishte zbritur dhe i ishte drejtuar policit, duke i thënë se do t'i merrte ajo gruan me dy fëmijët në shtëpinë e saj në Tiranë.

- A nuk i ngjan Sabria Nënë Terezës? - të kishte thënë Ekti papritur për të tërhequr vëmendjen, se po të vinte re se nuk po e ndiqje. Vazhdoje të shikoje pasqyrën majtas, pastaj atë të qendrës, rrugën përpara. Vetë Ektit nuk po ia hidhje më sytë as në rrugë të drejtë. Nisje ngjitjen e malores me të dytin, kaloje pastaj tek i treti, duke shkelur gjithë gazin.

Kishe blerë një "Golf 4", makinë që përshtatej mirë me rrugët e atëhershme të Shqipërisë. Kishte start dhe arrinte të mbante një stabilitet të pranueshëm nëpër kthesa. Në ndryshim, një "Benz 240", makina që po ju ndiqte, edhe pse ishte më e qëndrueshme se juaja nëpër kthesa, nuk arrinte të merrte menjëherë shpejtësi në rrugë të drejtë. Aty ti bëheshe lepur. Në çdo kuptim. Edhe nga frika.

Veç shoferit, njësoj si ai, me maskë në fytyrë, në makinën që ju ndiqte ishte edhe një tjetër. Sapo "Benz-i" hynte me prepotencë në kthesë, ky bënte gati armën dhe kur makina dilte në rrugë të drejtë me një gulçim për shkak të vështirësisë për të startuar fort përpara, merrte nishan.

Ti përjetoje krismën, prisje që të ndodhte, në fillim si nëpër filma, sikur qëllohej në ndonjë pjesë të makinës. Shpoheshin gomat, për shembull, dhe ju që rrokulliseshit poshtë. Por më vonë përjetimi t'u bë më i ngjethshëm, mendoje ndonjë plumb që do të të kapte kokës dhe do të t'i shpërthente fare trutë.

Por asnjëherë nuk mendove se do t'i ndodhte gjë Ektit.

Gjëja që duhet të shmangie medoemos, veç faktit që të mos i thoshe gjë asaj për ndjekjen, ishte shkëmbimi në paralel me makinën ndjekëse. Nuk duhet të gjendeshit në një vijë, karshi me të. Kjo do të bëhej shumë më e vështirë pastaj në zbritje. Njeriu i maskuar që merrte shenjë nuk kishte pse të synonte gomat. Nga lart-poshtë, e kishte më të lehtë të qëllonte në mish.

Ekti vazhdonte të kujtonte bisedat e tyre sa hynë në Tiranë në prillin e atyre ditëve. Berati kishte më shumë frikë se Saranda. Nuk i hapte dritaret e shtëpisë suaj në katin e pestë të një ndërtese gjashtëkatëshe. Në një rast kishte parë të motrën ta bënte dhe i kishte bërtitur.

- Mbylle, bre, penxheren. A s'e shef milicin?

- Kuku! - i qe përgjigjur ajo. - Unë sa kam hy n'Shqipni, nuk kam frikë fare.

Ti nuk reagon. Ekti nxehet.

- Hë, fol ti, pra. Mburru se si u përktheje lajmet. Ah, harrova. Pa na trego edhe një herë sa u trishtove kur vdiq Stanley Kubrick. Në vend të lajmeve, gjeje veç filmat e tij, na e

shpife të gjithëve. Vure *Portokall me kurdisje*. Po si ka mundësi që i torturoje ata të rinj në atë farë feje? U vije atë film të dhunshëm përpara, pa e vrarë mendjen fare se çfarë po bëje. Aty jepeshin skena ku torturoheshin njerëz, kurse ti na flisje për ndërtimin e kuadrit, për thellësinë tredimensionale. Je egoist i pandreqshëm.

Heshti një çast.

- Më dëgjo mua. E mora vesh që ke blerë makinë të mirë. Shikomë në sy kur të flas. Më kthe përgjigje tani. Si ta mori mendja të mbaje televizorin në atë film? Me ty e kam. Saranda ishte më e qeta. Ah, ashtu t'u duk ty? Jo, ishte edhe më e tronditur se Berati. U çlirua vetëm kur hyri në Shqipëri.

Ti ktheve kokën dhe e pe, më në fund, në sy. Nuk po ia dilje më ta mbaje "Benz-in" larg. Prisje nga çasti në çast të ndodhte më e keqja. Nuk kishe më frikë, vetëm habiteshe me situatën ku ndodheshit. Nuk ishte e mundur të mbyllej kështu.

- Nuk ta kishte fare për borxh t'i kujtoje fatin e saj të kobshëm. Do të shihje filmin *Portokall me kurdisje* se s'bën.

- Ekti, pusho një minutë!

Po përpiqeshe t'i kumtoje në njëfarë mase rrezikun ku ndodheshit, por ja që nuk kishe gjetur fjalët e duhura.

- Kujt i thua "pusho" ti? Duhet të ta kisha marrë bojën fare para miqve, atje në Prizren. Kot ke shpëtuar.

- Kujdes!

Tyta e automatikut ishte shfaqur edhe një herë në dritare.

- Jo, do të flas. Ta marrësh vesh një herë e mirë si jeni ju burrat. A të kujtohet si e mora Sarandën veç te skena e përdhunimit të gruas së shkrimtarit?

Ti ishte përqendruar në pasqyrë.

- E morëm vesh se ke blerë makinë të mirë. Se je shoferi më i zot në këtë dynja. Po, mos më thuaj "kujdes". Hapi sytë vetë, se do të na përplasësh.

Nuk e pe "Benz-in" në pasqyrë për një çast, por kjo nuk do të thoshte se mund ta ulje shpejtësinë. Arrite të ktheje edhe një herë kokën nga ajo.

- Aty tek ajo skenë duhet ta kishe ndërprerë filmin. More vesh!

- Asnjë prej nesh nuk ishte fëmijë, dreqi ta hajë! - ia ktheve Ektit, duke harruar për një çast gjithçka.

- Idiot! Prapë nuk po kupton asgjë! Sarandën e kanë përdhunuar! - ta priti Ekti.

Ti hoqe këmbën nga gazi për një çast, frenove pak dhe u ktheve nga ajo.

- Pse nuk ma ke thënë?

- Nuk ta kam thënë, se kjo është çështje grash. Ju burrat nuk e kuptoni kurrë ç'është një përdhunim.

Nuk mbaje mend asgjë çfarë kishte ndodhur më tej. Ekti vazhdonte të fliste, ti prisje të dëgjoje atë krismën, duke vazhduar të shikoje në pasqyra. Tani që nuk e shihje makinën që ju ndiqte ndiheshe edhe më zbuluar.

Latë, më në fund, Qafën e Malit. Ti nuk dije se "Benz-i" pas jush ishte dorëzuar, por fakti që nuk e shikoje më në pasqyra vazhdonte të të nxiste të ecje edhe më shpejt, të krijoje distancë.

- Kjo është makinë, - fillove të bërtisje, duke bërë para gruas vërtet figurën e idiotit.

Ajo të shikonte me dyshim. Nuk mund ta besonte që ekzaltoheshe si fëmijë për një makinë, në vend që të reflektoje për bisedën që kishit bërë. Po nuk e hapi më gojën. Nuk foli më asgjë.

Pastaj ndodhi përplasja. Që dhjetë metra para se t'ia fusje pemës e shtrëngove aq fort timonin, sa e shtrembërove fare.

Kishe marrë një goditje në hundë. Gjaku kishte spërkatur gjithandej kruskotin. Disa pika kishin rënë mbi fustanin e kaltër të Ektit, shtrirë në ulësen e udhëtarit.

Kurrë nuk e kishe parë trupin e saj aq të gjatë.

Nuk mbaje mend gjë tjetër.

MINELLA ALEKSI

Promovimi

Tregim

Për mua ishte menduar dhe u realizua një ceremoni që në ditët e sotme quhen Promovim libri.

Nga praktika e zakonshme e promovimeve të mëparshme mendova një ndryshim. Duke qënë se të tjerët e promovojnë librin fillimisht në vend dhe pastaj kapërcejnë nëpër diasporë, unë do bëja të kundërtën.

Përpara se të nisesha kisha mundësi që të shihja edhe një kopje të librit pothuaj të mbaruar dhe përcaktuam edhe datën e promovimit, duke lënë kohë të mjaftueshme rezervë për transportin e librave e të sigurtë për datën e promovimit.

Kur më njoftuan për ceremoninë dy muaj më parë u përfshiva nga një ndjenjë e veçantë ngazëllimi që, herë pas here më sillte një lëmsh në lukth sa herë kujtoja momentin kur më dhanë çekun me shumën e destinuar për shpenzimet e botimit të librit.

Aq ishte puna dhe gjumi i natës mori të krisurën e parë e cila u pasua nga degëzime të tjera gjumëprishëse. Më rrihte si çekan pyetja –vërtetë është fjala për një vlerë apo thjeshtë një ritual ceremonie rutinë që, në kohën e sotme është bërë modë? Unë mund ta kisha shkruar librin në gjëndje dehjeje gjithëfarëlloje i entuziazmuar nga vetkënaqsia, por organizatorët e promovimit duhej të gjykonin dhe ta lexonin atë duke qënë esëll. Kisha marrë pjesë në disa promovime të njohurish dhe qetësohesha kur mendoja se ishte një rikthim mirënjohjeje. Po qe se e organizojnë si rikthim mirënjohjeje atëhere ... dhe këtu më thumbonte një shkrim që e kisha lexuar pak kohë më parë me titull "Shkrimtarët, fiziologjia e suksesit". Vetëm fakti se në këtë titull ishte fjala "Fiziologji" turbullohesha deri në prag vjellje.

Kjo fjalë më kujtonte një proçes i cili kishte një fillim - hyrje, marrje lënde të nevojshme për jetesë, përpunim e absorbim të një pjese të saj dhe përfundonte me nxjerrje erëkeqe nëpërmjet një porte që dikur ngjallte neveri, ndërsa sot është stil jete që ka qënë i pranishëm që në kohët antike.

Mendimi vazhdonte të turbullohej nga një pohim në radio që, e dëgjova para disa ditësh të thënë prej një shkrimtareje promovuese: "Shkrimtarët mediokër shkruajnë ndërsa shkrimtarët e mëdhenj përshkruajnë". Nuk harroi të theksonte gjithashtu se artistët mediokër admirohen reciprokisht. Ngatërrohesha mes këtyre thënieve dhe ajo që më bënte të mallkoja ditën kur nisa të shkruaj ishte një shprehje që më qëndronte gjithë kohën para syve, njësoj si parrulla leniniste në ekranin televiziv shtetëror rusë "Proletarë të të gjitha vëndeve..... Na Falni". Sikur libri im të injorohet si mediokër, bëj dot mbrapa unë e të them – Lexues të shijeve letrare të mira më falni! Mirë rusët me këtë shprehje u vetëgjykuan admirueshëm dhe u tallën deri në madhështi me idealin komunist por shprehja që më shtynte të mallkoja veten ishte vetëmunduese dhe, sa më shumë e kujtoja më shumë më vinte t'a thoja me zë të lartë e ta shkruaja me gërma kapitale. Megjithatë për ata që dinë të lexojnë po e shkruaj si zakonisht: "Suksesi i kaq shumë librave bazohet në marrëveshjen midis mediokritetit të ideve të autorëve dhe mediokritetit të ideve të publikut".

Në këto ngatërresa mendimesh më gjeti afrimi i ditës së promovimit të librit. Më thanë se deri edhe salla e vënë në dispozicion sëbashku me mezeçkat ishte mbyllur si hesap falë bujarisë së pronarit të saj. Shkurt, gjithçka ishte kurdisur dhe po lëvizte ditë pas nate si në një proçes ku dominonte Fiziologjia e Suksesit.

Në këto e sipër një ditë para promovimit me një kafe përpara, organizatori me shprehje kënaqsie që shfaqej rrjedhshëm së brendëshmi, me një gjysëm buzëqeshje e fjalë të shprehura ngadalë me një zë që merrte nuancë melodie, më thotë: mos harro se ti ke edhe një avantazh tjetër të madh në këtë promovim – librin e ke të sponsorizuar, nuk ke harxhuar asgjë nga xhepi yt. Ndërsa nga ata që do jenë të pranishëm në ceremoni shumica kanë nga 8-9-10 libra të botuar dhe të tëra me shpenzimet e tyre. Dhe këto fjalë i tha duke lëkundur kokën ngadalë sa majtas djathtas në atë mënyrë sikur të isha unë shkaktari i nxitjes ndaj tyre për shpenzimet e librave. Thellë brenda vetes ndjeva që m'u formua dhe më doli jashtë buzëve fjalia: mos jam duke bërë gabim me këtë ceremoni pasi,... unë të vetmin libër këtë kam.

Ditët e fundit para ceremonisë erdhën duke më shtuar edhe ankthin. Hallakatja e mendimeve luhatej në diapazonin si midis dy nofullave të një morse, mediokritetit dhe suksesit. Gjithëçka e mendoja të lidhur me kohën sipas shprehjes se veprat e artit kanë dy anë,njërën të drejtuar kohës së tanishme dhe tjetrën kohës së ardhme. Këtu te koha e ardhme më mundonte kohëzgjatja e interesit, përdorimit dhe dobisë të librit. Me këto turbullira shpirt brejtëse u gjënda ditën e promovimit. Kopjet e librit erdhën një ditë më parë dhe personi që i hapi më bëri të ditur mbërritjen. Kaq. Asnjë fjalë më shumë. Kjo më shtoi ankthin dhe merakun. Përse asnjë përgjigje gëzuese për të nesërmen. Gjumi i natës më iku fare. Më shumë dhimbje koke dhe telash sesa kënaqsi.

Kapaku i librit mbi tavolinë kishte një veprim impresionues. Vështroja të pranishmit dhe ata dukej që diçka i brengoste. Insistova për arsyen. Pas shpjegimit më përfshiu një ndjenjë përqëndrimi të qetë dhe vetëdijeje të shtuar. Sikur më dhanë një çelës me të cilin hapa një derë, ku pasi hyra kisha ndjesinë e të qënit plotësisht i pranishëm dhe i angazhuar në moment me aftësinë për të kuptuar dhe përpunuar lehtësisht informacioni. Menjëherë ndjeva që duhej të përmbaja mendimet që mezi prisnin të rridhnin lehtësisht dhe natyrshëm. Pikëllimi i tyre kishte lidhje me një gabim që ishte bërë gjatë proçesit të shtypjes së librit.

Sponsori i librit ishte farmacist, miku im që prej viteve të shkollës i cili, në kuadrin e fushatës së këshillave në shqip të përdorimit të ilaçeve kishte porositur disa të tilla në të njëjtën shtypshkronjë ku u përgatit libri. Të kuptohemi, gabimi njerëzor asnjëherë nuk mund të jetë zero. Kështu përgjatë proçesit të shtypjes së librit gabimi njerëzor bëri që në kompjuter të kalonte një porosi shpjeguese e farmacistit si pjesë integrale e librit. Tashmë në faqen e parafundit të librit, brenda saj ishte shënuar data e prodhimit dhe afati i skadimit. Njësoj si me ilaçet që kanë datë prodhimi dhe datën e skadimit, apo si një kuti konserve sardelesh. Si afat skadimi të librit shënohej data e promovimit të librit. Kjo ishte ajo ndjenjë pikëllimi që kishte ngërthyer të pranishmit.

Ndërsa unë, porsa e konstatova këtë gabim mendova se isha fatlum. Të gjitha torturat shpirtërore, mendimet kontradiktore të prag promovimit pësuan një pastrim, me çlirim të trurit duke më dhënë në dorë variantin rezervë të titullit ideal - Fiziologjia e suksesit me afat skadimi.

Pas fjalëve përshëndetëse të tre shkrimtarëve me një prodhimtari mbi dhjetë libra, të cilët krahasimet për stilin me disa emra shkrimtarësh klasikë i thanë me zë të lartë kurse ndonjë vërejtje e latuan që të mos shtonte më shumë pikëllimin e autorit, nuk durova dot më dhe plot hare fillova të flas. Ndjehesha në një çlirim energjish si ai që ka kaluar një provim të stërmundueshëm. Ajo që ata i pikëllonte mua më solli çastet më të bukura të asaj jete që kisha harxhuar deri më tani.

Deklarova me pathos: "Jam i lumtur për botimin e librit dhe ndaj lexuesit veçanërisht për një detyrim madhor të cilin mendoj se e kam përmbushur plotësisht. Kënaqësia e madhe që ndiej nga fjalët e të pranishmëve nuk më zbeh dëshirën e papërmbajtur që të them me plot gojën se – në rast se mbas datës së sotme kur është edhe dita e fundit e skadimit të librit pëshpëriten zëra apo shkruhen artikuj për nivelin mediokër të librit atëhere unë rezervoj të drejtën që të hedh përtokë të gjitha opinionet nënvlerësuese ndaj librit. Kam të drejtën e autorit, atë morale dhe ligjore që të deklaroj se nuk është faji i autorit që ju blini, rekomandoni, diskutoni, përgënjeshtroni fjalët e mira të thëna më parë për atë libër tek i cili keni nënshkruar parathënien, komentet lavdëruese në faqet e fundit pasi autori prodhues iu ka dalë borxhit. Ai ka shënuar si datën e prodhimit ashtu edhe datën e skadimit të librit dhe nëse ju kërkoni t'a konsumoni mbas afatit të skadimit, pra mbas promovimit, atëhere nuk shqetësohem, duart i kam larë përpara gjyqit moral të shoqërisë. Vuani atëhere shenjat e konsumit të një produkti të skaduar. Madje me tërë forcën që më jep Fiziologjia e suksesit të librit do u bëj thirrje të gjithë shkrimtarve, publicistëve, poetëve, eseistëve, analistëve, tregimtarëve, pamfletistëve etj, që të fillojnë të vendosin datën e prodhimit dhe atë të skadimit në produktet e tyre letrare, si kërkesa më elementare, si detyrim moral e ligjor që respekton konsumatorin e ndershëm dashamirës të produkteve letrare".

Kaq dhe pas këtyre fjalëve, pas këtij shtërzimi shpirtëror më mbuloi entuziazmi i të pranishmëve.

MENTOR KIKIA

Vrasje në rrugicën e Xhulit

Tregim

Në shtëpinë e Iliaz Doçit kishte plasur sherri. E kur, pikërisht tani që kishin përfunduar së rindërtuari shtëpinë. Iliazi është duke shkuar tek të tetëdhjetat, por është shumë energjik dhe njeri punëtor. Ai është një artist i vërtetë. I vjen doresh për çdo gjë. Ai kishte punuar në ndërmarjen artistike, si gdhendës druri. Por, po me kaq mjeshtëri punonte edhe gurin. Dhe, siç mund ta merrni me mend, shtëpia e rindërtuar ishte me dru e gurë të punuar pikërisht nga duart e tij. Në fund, pasi kishte lyer me llak edhe portën e jashtme, të cilës i kishte vënë një çati elegante, me ca tjegulla me majë të kthyer që ngjanin si stil japonez, ai vuri edhe një pllakë guri, ku ishte shkruar, me gdhëndje kuptohet, "Familja Iliaz Doçi". Shtëpia e familjes Doçi ndodhet në një rrugicë rreth 150 metra të gjatë, ku ishin vendosur familje të vjetra tiranase dhe dibranë të ardhur në vitet 1920. Disa shtëpi ishin prishur dhe në vend të tyre ishin ndërtuar pallate, disa ende mezi mbahen në këmbë, të rrethuara me mure qerpiçi të kuqerremtë, gjysmë të rrëzua. Familja Doçi i rezistoi ofertave për ta prishur shtëpinë, pasi aty kishte kujtimet e saj prej të paktën 3 brezash. Dilemave dhe tundimeve Ilizai i dha fund kur vendosi që me paratë e sjella nga djali, emigrant në Gjermani, kursimet tij dhe një kredi që mori në bankë, të rindërtonte shtëpinë, në atë gjëndje që është tani.

Xhuli, bashkëshortja e Iliazit kishte qenë fatorino autobuzi. Ajo ishte një grua e sertë dhe kur bërtiste ajo në autobus "shtyhuni nga fundi ju thashë", të gjithë paloseshin me njëri-tjetrin e nuk e bënin fjalën dysh. Po ashtu edhe në rrugicë. Kur fëmijët loznin me top dhe qëllonte që topi të binte në oborrin e familjes Doçi, ata ia mbathinin të gjithë, sepse e dinin që Xhuli do të ulërinte sa të oshëtintë rrugica në të dyja anët. Madje edhe të afërmit, nuk thonin "do të shkojmë për një kafe nga Ilizi, pasi ka patur një sebep", por, "do të shkojmë nga Xhuli".

E kështu, dalëngadalë, shtëpia filloi të quhet "shtëpia e Xhulit" ndërsa rrugica, "Rrugica e Xhulit".

Atë mëngjes Xhuli kishte dalë herët për të blerë lëpjetë, rukola dhe barishte të tjera të njoma që shesin fshatarët, në një treg të vogël në krye të rrugicës. Ndërsa ishte kthyer dhe po hapte derën e rëndë prej druri, ajo pa pllakën e gurit, ku shkruhej "Familja Iliaz Doçi". Ajo zgurdulloi sytë, hapi derën me furi, përshkoi oborrin me hapa të shpejtë, hodhi qesen me barishte në kushinë dhe nxitoi për në dhomën ku flinte Ilizai. Por krevati i tij ishte bosh.

-Iliaz, Iliaz, - filloi të bërtiste nëpër shtëpi Xhuli.

-Nënë, çfarë ka moj, çfarë ka ndodhur?, - Astriti doli nxitimthi nga dhoma e tij, duke fërkuar sytë e përgjumur.

-E di ti, e ke parë ti çfarë ka bërë yt atë apo jo?

-Çfarë ka bërë moj? Fol ku është babai, çfarë i ka ndodhur?

-Nuk i ka ndodhur gjë jo, por eja të ta tregoj. Ajo kapi prej dore te birin 45 vjeçar dhe e tërhoqi si dikur, kur e çonte me zor në kopësht. Hapi të dy kanatet e derës së drunjtë dhe drejtoi gishtin nga pllaka e gurtë.

-Ja- tha ajo në mënyrë solemne – lexoje këtë çfarë shkruan. "Familja Iliaz Doçi"- lexoi ajo tërë ironi.

-Po aman moj nënë, për këtë je alarmuar ti. Po familja emrin e kryefamiljarit mban moj, çfarë të shkrepi tani?

-Po pra po, por kryefamiljari kam qenë unë me kohë në këtë shtëpi. Kush i paguante dritat, ujin, kush shkonte të merrte drutë tek fusha e druve, kush ju regjishtronte ty dhe tët motër në kopësht e në shkollë, kush i krasiste portokallat dhe rrushin? Hë, kush i bënte këto? Yt atë dinte vetëm të gdhentte llulla dhe kukulla prej druri. I pelqete ta quanin artist dhe artistët nuk bënin punë të tjera në shtëpi, ato i bëja vetëm unë…Tani na doli Familja e Iliazit kjo. Jo more…

-Mirë nënë mirë, eja brenda tani. Nuk ia vlen të ziheni në këtë moshë. Do flas me babanë dhe të vërë edhe emin tënd, ose ta heqë edhe të vetin e ta lërë vetëm "Familja Doçi". "Eh more baba – tha Astriti me vete, duke vënë buzën në gaz - tani u kujtove ti? E si mund të rrëzosh një pushtet të konsoliduar prej 50 vjetësh? Nuk është kaq i lehtë revolucioni baba, e aq më shumë në këtë moshë".

Astriti e kishte harruar fare sherrin për pllakën tek derë e shtëpisë. Të nesërmen në mëngjes, ai ishte ulur në tendën pesëkëndore me parmakë druri të dhendur, që ndodhet në cep të kopështit, nën hijen e limonave dhe portokallave. Gjumi i kishte dalë herët dhe kjo ishte shenja e parë se po vinte pleqëria. Ishte pranverë dhe në këtë stinë nuk ka gjë më të mrekullueshme në këtë oborr sesa aroma e luleve të portokallit dhe limonit. Ishte kjo që i mungonte më shumë atje në Gjermani.

-Astrit, eja këtu, shpejt, eja- e shoqja përpiqej ta thërriste me zë të ulët, ndërkohë që i doli një ulërimë.

-Çfarë ka moj, u zunë përsëri ata?

-Hajde të thashë,- ashtu si e jëma, edhe ajo e kapi prej dore dhe e tërhoqi me forcë brenda në dhomën e tyre. Gruaja ishte si e çakërdisur. Me flokët e si kaçube dhe lotët që i rridhnin në faqe.

-Fol moj, se më çmende, çfarë ka? – ngriti edhe ai zërin.

-Ja, tha gruaja dhe i "plasi" në dorë telefonin e vajzës. Lexoji!

-Çfarë të lexoj? – pyeti Astriti.

-Mesazhet pra mesazhet. Ja çfarë shkruan vajza jonë 12 vjeçe me shoqen e saj.

Wednesday, April 12. 14.23

-He moj shtrigë ça bën? Si vajti sot? Tha gjë zysha për mua?

-Mirë mirë, si përherë. I thashë që ishe ndjerë keq dhe u detyrove të ktheheshe në shtëpi.

-E hëngri?

-Ashtu u duk.

-Lëre zyshën, po ti çfarë bërë, më thuaj.

-Mirë, mirë vajti. E putha më në fund hahahaha

-Vërtet me shtrigë e m…., më thuaj shpejt si ishte?

-Po, por ka një problem… ika flasim në darkë, se nuk mundem tani. Po më therret mami.

Wednesday, April 12. 22.27

-Si ishte puna, se më bëre merak, s'më sqarove?

-Hiç me hiç, por na ka hyrrë një shurrë në mes. Eshtë njëra që e sjell mamaja me makinë të shtrenjtë, Ilva tek e 6-ta B. Ajo bën si ashtu i bukur dhe i pëlqen të shkatërrojë lidhjet e të tjerëve. Ky po, si çun i bukur që është, i pëlqen tia varin.

-Në fakt diçka ma kanë zënë veshët edhe mua, por s'ta kam thënë.

-Po unë do ia çaj gojën asaj. Ka pak djem në shkollë që krruhet me këtë timin ajo? Ke për të parë po nuk ia dhash ato qimet e verdha në dorë, një e nga një. Buçja!

-E, se nuk të thash, plasi sherri sot në shkollë. Ata të klasës së 8-të. Ua, u bë drejtoresha dhe. I porositi të gjithë, të paktën të mos tregojnë.

-Kush, pse, ça ndodhi?

-Po ja, mubahet kurvash, si kjo që thua ti. Ishte nëra që e luante me të dy, dhe ata pallat e nisën sherrin në korridor, pastaj në oborr, doli e gjithë shkolla jashtë. Njëri u bë gjak i gjithi..

Astriti e la telefonin dhe ishte bërë limon në fytyrë. Kryqëzoi gishtat dhe i vuri krahët hark mbi kokë. U ngrit në këmbë dhe nisi të ecë nëpër dhomë. Shkoi, kapi sërish telefonin, por nuk e hapi më, e hodhi në krevatin e bërë lëmsh. E shoqja rrinte në këmbë si e ngrirë, duke kafshuar gishtin tregues të dorës së djathtë dhe ndiqte me sy ecejaket e të shoqit, në pritje të ndonjë reagimi prej tij.

-Ku është? – pyeti dyke skërmitur dhëmbët, ku është se do ta vras.

-Po fle- tha e shoqja me gjysmë zëri.

-Ia tregoj unë asaj dashuriçkat që tani. Pale, po ka filluar të lërë edhe mësimin,- Astriti bëri të dalë nga dhoma, por e shoqja i zuri rrugwn duke i vënë kurrizin derës.

-Prit të lutem, prit njëherë. Prit të vendosim si të flasim, si ta pyesim, se…

-Se çfarë? Se na mërzitet Elja ë? Qan dhe i prishet rimeli i syve që ka filluar ti lyejë që 10 vjeçe? Kështu ë? Po s'ka faj ajo se ti e ke çmendur.

Në këtë moment bie tërë tërsëllimë dera. Gruaja lëvizi, duke lejuar derën të hapej. Babai u fut brenda duke u dridhur nga nervat.

-E theu pllakën jotëmë bir, e theu. E theu, por nuk e pranon fajin. Ja ku po ta them. Unë do ta vë përsëri pllakën dhe do ta vë aty ku ishte. Do të vendos edhe kamera sigurie dhe po e pashë që e thyen përsëri, do ta vras me duart e mia.

Babai doli duke përplasur derën, ndërsa Astriti u shemb në krevat, mbuloi fytyrën me pëllëmbët e duarve dhe lëshoi vetëm një klithmë: O zot!

-Domethënë vajza në klasë të pestë dhe ja për çfarë bisedon me shoqet,- shfryu ai me fytyrën ende të mbuluar me pëllmbët e duarve.

-Në të gjashtën- e korigjoi e shoqja.

-E mirë, në të gjashtën, çfarë ndryshon?- Po me mësimet si shkon- pyeti ai, befas, me një qetësi që as vetë nuk e kuptoi nga i erdhi.

-Ashtu, si të gjithë?

-Si, si të gjithë? Çfarë do të thotë "si të gjithë"?

-Epo shko e pyet në shkollë mor burrë, ja ku është shkolla, 200 metra larg është- ngriti zërin gruaja.

-Po unë kam qenë larg moj grua, kam punuar. Me çfarë u bë kjo shtëpi? Me çfarë visheni e mbatheni ti e jotbijë dhe që s'ju mungon asgjë?

-Epo, fëmiljët nuk kanë nevojë vetëm për ushqim dhe veshje- ia ktheu ajo.

-E di, por mund ta bëje ti edukatoren, ndërsa unë nuk isha këtu. Apo ti kishe nevojë për edukator për vete, se harrova unë.

-Po e çon bisedën në tjetër vend tani, të doli në shteg dhe do ta përmendësh sërish – tha gruaja e nervozuar.

Ata heshtën përsëri. "Nuk na shpie askund kjo bisedë. Eshtë bërë dhjetra here"- mendoi Astriti. Burrë e grua vendosën të shtrëngojnë dhëmbët dhe të kafshojnë gjuhën. Nuk ishin të qetë të bisedonin tani me vajzën. E lanë të flasin pasi të kthehej nga shkolla. Astriti doli dhe porositi të shoqen që të përpiqej të sillej sa më normalisht dhe të mos i binte në sy vajzës për çfarë kishin lexuar në telefonin e saj.

Ai u ul në Kafe Europa. Edhe pse ora ishte 12.30, kafeneja ishte plot dhe kishte shumë zhurmë, por mendoi se gjeti një qoshe ku ishte më qetë. Ai do të takohej me dy shokë të vjetër të rinisë, dhe kishte nevojë të bisedonte. Kishte ardhur 2-3 herë nga Gjermania dhe nuk i kishte takuiar dot. Edhe ai kishte nevojë të ndërronte bisedë e të humbiste mendjen nga gjithë ajo që kishte ndodhur në mëngjes.

-Po ku je mor Astrit se u bëmë për mall u bëmë- tha njëri prej tyre ndërsa u përqafuan. Ata zunë vend dhe ende pa u rehatuar në poltron, njëri prej tyre filloi të shfryjë.

-Po çfarë bëhet kështu mora man. E tmerrshme, kriminelë që në këtë moshë?

-Çfarë ka ndodhur – pyeti Astriti.

-Ja shikoje – i tha ai, dhe i tregoi ekrnain e televizorit të varur në mur.

Breaking News: Masakër në shkollë, një nxënës i vrarë dy të plagosur.

Astriti brofi në këmbë dhe u afrua pranë ekranit. Të gjithë kishin heshtur dhe po dëgjonin spikeren.

-Në cilën shkollë ka ndodhur?- pyeti Astriti.

-Ja këtu afër, tek shkolla që është në krye të rrugicës së "Xhulit", iu përgjigj një burrë që kishte mbetur me filxhanin e kafesë në dorë.

Astriti u lëkund dhe këmbët filluan ti dridhen. U kthue tek tavolina ku ishin shokët e tij. "Më falni, por më duhet të shkoj – tha - kam vajzën tek kjo shkolla. Nuk di çmund të ketë ndodhur". Ai doli nxitimthi duke vrapuar mes përmes makinave. Por hyrja për në shkollë ishte bllokuar nga policia. Roja i shkollës tha se të gjithë fëmijët janë nxjerrë jashtë dhe janë larguar. Ai mori telefonin dhe, me duart që i dridheshin,

mezi gjeti numrin e të bijës. I ra, por nuk e hapi. I ra përsëri, përsëri,përsëri…derisa nga ana tjetër degjoi zërin e të bijës.

- Po babi.

-Mirë je Elja? Ku je?

-Mirë jam ba, mirë. Ka ndodhur një vrasje në shkollë dhe neve na nxorrën nga ana tjetër e rrugicës, tani jam tek tuneli dhe do të shkoj në shtëpi.

Tek dera e shkollës ishin rreshtuar kamerat e televizoneve dhe gazetarët që raportonin Live. Ai telefonoi të shoqen që të dilte në rrugicë dhe të priste vajzën, ndërsa vetë u afrua edhe më shumë tek turma e njerëzve që përpiqeshin të shikonin apo mësonin më shumë për atë që kishte ngjarë.

Të gjithë pyesnin, të gjithë përgjigjeshin dhe informacioni kalonte gojë më gojë: Çfarë ka ndodhur? Ka vdekur njeri? Kush ka vdekur? Sa të vdekur janë, dëgjova dy? Kush e qëlloi? Shoku i vet? Uaaaa, plumbin, këta duan plumbin! Kaq të vegjël e me thikë në shkollë? Jo mo jo, duhet të ngjallet prapë ai që iku, ne kishim frikë ti kthenim fjalën mësuesit, këta shkojnë me thikë në shkollë. Po pse janë zënë? Çfarë? Punë femrash e? 14 vjeç dhe me dashnore këta? Kanë prindër këta, a kanë familje? E ku pyesin për familje këta mor zotëri. Fajin e ka shkolla, është bërë shkolla si han. Epo drurin e duan ato kurvickat e vogla që fusin djemtë në sherr….turma vazhdonte të merrte e jepte informacion dhe, padyshim, të analizonte dhe komentonte ngjarjen.

Mediat vazhdonin të raportonin: "Ngjarja ishte vazhdim i një sherri që kishte nisur një ditë më parë brenda shkollës dhe sot, vijoi në këtë rrugicë këtu, ku autori i krimit dhe një tjetër shok klase, u zunë pritë dy adoelshentëve që i kishin goditur dje me grushta. Viktima ka marrë disa goditje me thikë në bark dhe një fatale në zemër" – raportonte një gazetar aty pranë.

Pas një ore, në rrjetet sociale u shpërnda një video, ku autori i krimit shfaqej me thikë në dorë në një makinë, ndërsa tregonte kënaqësinë që kishte marrë hakun. Shkolla doli me një deklaratë, duke shprehur keqardhjen për krimin dhe, duke shtuar se ngjarja nuk kishte ndodhur brenda territorit të saj. Një grup aktivitësh shpërndanë një njoftim, për të protestuar ditën e nesërme, nga shkolla ku mësonin fëmijët deri tek Ministria e Arsimit.

Astriti po ecte ngadalë. Gjunjët i ishin prerë, si në ato ëndrrat me makth, kur do të vraposh për ti ikur të keqes, por nuk mundesh, trupi s'të përgjigjet. Kërkon të bërtasësh, por sërish zëri nuk të del dhe pret vetëm të zgjohesh, të fshish djersët e të gëzohesh që ishte thjeshtë një ëndërr e frikshme.

Ashtu, duke u zvarritur e me kokën ulur, ai u afrua tek porta e tij. I bindur se kjo nuk ishte një ëndërr e keqe, por një e vërtetë e hidhur me të cilën do të duhet të ndeshesh. Babai, me trapan po shponte vrimat në mur për të vendor pllakën e re ku shkruhej "Familja Iliaz Doçi". "Le ta thyejë përsëri, po ia mbajti, le ta thyejë" - mërmëriste plaku, ndërsa shponte vrimat në murin e gurtë.

-Bir, çfarë ishte kjo që ndodhi në shkollë sot?- pyeti ai sapo pa të birin që u afrua tek porta.

-Erdhi vajza baba?

-Po po erdhi, ishte bërë dyllë e vërdhë shpirti gjyshit. Kujdesu për vajzën bir. Mos e lër të bjerë në shoqëri te keqe. E shikon çfarë kohësh kanë ardhur.

Astriti u fut në oborr dhe ndjeu sërish aromën e luleve të limonit. Nisi të çapitej ngadalë drejt hyrjes së shtëpisë. Në verandë, në një karrige kashte me shilte me pupla, ishte ulur Elja, e cila kishte telefonin e saj në dorë. Në atw moment, di dëshironte që ajo rrugicë prej 30 metrash, e shtruar me pllaka guri e me trëndafila anash, të ishte shumë e gjatë.

ALFONS ZENELI

Gërma mbi dimër

Poezi

NE TË DY NË PLAZH

Ikëm.
Plazhi tani tregon kujtimet tona.
Si heshtëm,
si u pamë,
si na mbinë luleprekje
mbi lëkurë.
Ikëm.
Perëndimi
na fishkëllen si himn.
Vallëzim i vetëm i pafund
shënohesh
mbi rërë rrëmujë.

O Zot, çfarë kaosi i bekuar.

ËSHTË NJË MALL

Eshtë një mal i kaltër diku lart mbi mall
ku hije njeriu s'është ngjitur e gjallë
dhe një gur i hirtë që mban, ah, mbi shpinë
vet' mua Sizifin plot brengë e trishtim.

Gjithë jetën e lume në ngjitje pafat,
në ngjitjen- rrëzim që kurrë s'u ndal
e kurrë s'arriti as vdekur as gjallë
në malin e kaltër atje lart mbi mall.

Kuptim i mallkuar që s'kishte kuptim,
kryqi i damkosur mbi mëkatin tim
si vdiq i harruar, vallë si u ringjall?
Është një mal i kaltër atje lart mbi mall.

HEROJTË

Herojtë janë të vetmuar.
Janë si yjet, të largët.
I duam
por kurrë nuk bëjmë dot diçka
që ju ngjan atyre,
diçka siç e bënin ata.
Ata heshtin
piedestaleve,
bronxin mbushur trishtim
me historitë si rrudha
ngrirë nëpër kapota.

Herojtë fishkëllejnë vetmi.

Ata nuk duan
që t'i kujtojmë
vetëm me shkak.
Ndaj brenda tyre bën ftohtë,
era kuis fatin e tyre
dhe këngët tona s'i ngrohin.
Më mirë t`i linim gurët gurë
siç ishin në mal
pa sy, pa kokë e pa duar.

Herojtë,
herojtë janë të vetmuar.

KRIJIM

Dikur mbretëronte bukur errësira:
s'kish yje, s'kish vdekje dhe prandaj
paqja ishte e vetmja gjurmë jete
që klithte vetmas veç himnin e saj.

Atëherë nuk kish mure me hije të kuqe
as murg plot me lutje lidhura në fyt.
Brenda trupit tim ende nuk qe rritur
druri prej të cilit u bë kryqi yt.

PORTRETI JUAJ

Qiell mbi re.
Nën re
kumbojnë pengje dhe shi.
Shiu rrëshket
nga sytë e mbyllur
të vjeshtës.
Strehët u mbushën
plot të pathëna.
Ejani të trishtojmë
si ftonj
nën kubenë
e natës së vërtetë.

....Dhe nata shkëlqen
si kamë

PEMA

U ngurtësova.
Më mbinë gjethe
dhe krahët m'u bënë degë.
U bëra pemë.
Poshtë tyre vara si lodra
sytë e zinj të shikimit,
pak heshtje- imitim flokëbore
dhe vetëm një zile të kuqe të vogël.
Se vetëm një zemër kisha.
I bleva te shitësi ambulant
që vertitej gjithë jetës brenda meje.
S'kishte shitur kurrë asgjë,
nuk i kishte blerë askush.
-Bliji të gjitha- më tha,
-bliji se kam mbetur shumë ngusht.
Pema nuk doli e bukur.
Kaq pak lodra,
asnjë pako nga ato të lidhurat me kordele.
Ah kordelet e mrekulleshme
të dhuratave.
Nuk bëra dot asgjë për ty.
Do thuash "jo, mjafton".
E di që s'do bindesh.

Por të paktën ma prano si dhuratë
këtë pemë që lekundet "Trishtlindjesh".

IDIL 4

Le të bëjmë një pakt
e të heshtim të gjithë.
Të mos i themi
të harruarat,
të mos i themi ikjet
as vdekjen e fjalës...

se nuk përmendet puthja
në shtëpinë e plagës.

PËRRALLË QIELLORE

Ndiqeshin dy yje
nëpër qiell
shoq me shoq.
Më ra njëri përmbi mall
edhe u dogj.

MERRMA

Merrma at' fije g'zim
e ngjite te flokët si emnat.
Mos me m'mbetë puthja
pa epitaf
kur t'fryjnë marritë e ernave.

Ma shkul at' lumni t' vogël
sa dora jote
kur u lind prej nji himni-
ta kesh me veti kur t'marrë malli
për me i shkrue ndoj letër
pikllimit.

MËKATI JEM, MËKATI YT

Kur t'kem le prej fillit t'vetmisë
s'mbushun plot bekim dhe pyje
ti do t'jesh vallja e verdhë ndër gjethe
tek pikllon udh'timesh brenda meje.

Kur t'ia tham qillit fjalën e vetme qi di
at' me t'cilën pag'zova frymë e trup,
ti do t'jesh bima, ti ke me mbî si tingull
n'për kangët qi kurrë s'i kndova.

Kur t'ndalë zemra jeme prej qershie
dhe si oborr t'hesht plot shikim e terr,
ti do t'jesh rapsodia e verbueme e fatit,
e andrrës qi n'dritë t'shpirtit m`pat.

Kur t'rrëfej n'ditën e mbrame,
paj, tanë m'katet e mi t'pjekun kuq,
do t'jesh ti ajo qi do digjesh n' Parajsë
dhe me flakët e saj do t'bajsh nji trandofil.

VARKA DHE LUMI

Një vit, shtatë jetë, nëntë vdekje
plot e përplot e bukur jeta jonë.
Me çfarë ngarkuar ajo varkë
po mbytet n'Akeron?

Nëntë valë, shtatë brigje, një mort- lot
harrim i bukur e përplot ky fat.
Çfarë pengu mban i buk'ri Akeron
që shuhet nëpër Had?

I DËNUARI ME VARJE

Kishte.
Deri sa iku.
Pastaj ëndrrat mbanin erë litar.
Iknin të ndara katërsh.
Dritare e vogël
për sytë e natës së fundit.
Kollitej qielli në qeli
nga retë e duhanit të tij.
Akrepat i ngecin në grykë
si ai gulçi plot vaj
që ta shkakton një tregim i trishtë.
Ditët numëronin mbrapsht
orët që binin nga pema
e oborrit.
I kishte mbetur dhe një ditë.
Dhe nje orë.
Asnjë.
U zvogëlua sërish,
u bë fëmijë.

Sa mirë që ike vogëlush.
Këtu brenda nuk kishte
shilarse.

GËRMA MBI DIMËR

Âsht nji pyll
përtej dritares
ku klithin foletë
e gjethi përqesh vedin.
Pemët e mbîme
n'qill dëshp'rimi
han secila blerimin e vet
ngujue n'grevë kuptimi.
Âsht nji pyll
përmas kohës
thye tan copash
n'degë t'kujtimit.

Ani.
Na marrtë t'zezën
e bardha e dimnit.

PHILIP LARKIN

Dritare të Larta

Poezi | Përktheu Kujtim Morina

Dritare të larta

Kur shoh disa fëmijë
dhe hamendësoj, ai bën seks me atë,
ajo merr tabletë apo përdor kontraceptiv
E di, kjo është një parajsë.

Të gjithë të vjetrit kanë ëndërruar tërë jetën-
Lidhjet dhe gjestet të lihen mënjanë
si një autokombajnë e dalë mode,
të gjithë të rinjtë të zbresin rrëshqitses së gjatë.

drejt lumturisë së pafund, vras mendjen nëse
ndonjëri më shikonte kështu, dyzet vjet më parë
dhe mendonte: *Ashtu duhet të jetë jeta;*
s'ka zot më apo djersitje natën

për mëkatet apo për ta fshehur
çfarë mendon për priftin. Ai
dhe shokët e tij të zbresin rrëshqitses së gjatë
si zogj të lirë bastardë. Dhe fill

më tepër sesa fjalët vjen mendimi i dritareve të larta:
xhami që gjithë rrezet e diellit i përhumb
dhe përtej tij, ajri blu, i thellë që tregon
asgjë, që nuk është askund dhe është e pafund.

Shoqëria më e mirë

Kur isha fëmijë kujtoja
pa e vrarë mendjen se vetmia
Nuk ka nevojë kurrë të kërkohet
Sepse e ka në vetvete çdonjëri
Si lakuriqësia, e ke në dorë
S'është as e mirë as e keqe,
Një gjë e bollshme dhe e dukshme
aspak e vështirë për t'u kuptuar.

Pastaj, pas të njëzetave, u bë
menjëherë më e vështirë për ta pasur
më e dëshiruar- megjithëse prapëseprapë
më e padëshirueshme- për çfarë
të jesh vetëm, të arrish
të jesh faktikisht vetëm, për t'u shprehur
në termat e të tjerëve apo është thjesht
një shtirje kompensuese.

Shumë më mirë qëndro në shoqëri!
Të dashurosh duhet të kesh dikë tjetër,
Të japësh kërkon trashëgimi
Fqinjët e mirë kërkojnë që e gjithë famullia
e njerëzve të sillen kështu- shkurt,
virtytet janë të gjitha sociale,
Nëse e vuan mungesën e vetmisë
Është e qartë, nuk je aq tip i virtytshëm.

Në një rreth vicioz, pastaj, kyç derën,
ndihet era e gazit, jashtë era
sjell shiun e mbrëmjes, edhe njëherë
vetmia jokontradiktore
më mban në pëllëmbën e saj gjigante
dhe si një anemonë deti
apo kërmill i vogël, me kujdes
shpaloset, shfaqet çfarë vërtet jam.

Në origjinal: Best Society

Pasditet

Vera po zbehet:
gjethet po bien nga një dhe nga dy
nga pemët në kufi
me këndin e ri të lojërave.
Në zgavrat e pasditeve
mblidhen nënat e reja
tek luhatëset dhe pirgjet e rërës
duke i lënë të lirë fëmijët.

Pas tyre në intervale kohe
vijnë burrat me zanate të ndryshme,
një mal me rroba presin për t'u larë
dhe albumet e dasmës
shtrihen pranë televizorit.
Përpara tyre, era
po rrënon vendet e takimeve të dikurshme.

Që janë ende vende takimesh
(por të dashuruarit janë të gjithë në shkollë),
Fëmijët e tyre kaq të zhytur
në gjetjen e lenteve të papjekura të lisave,
presin për t'í çuar në shtëpi.
Bukuria e tyre është trashur
Diçka po i shtyn ata
mënjanë jetëve të tyre.

Ambulancat

Ambulanca la stacionin,
duke ngritur sirenat.
Njerëzit shikuan tutje të humbur në mendime
pa e ditur ta ndjekin apo jo.
Ndërsa parakaloi, ata panë
përmes një dritareje brishtësinë e jetës njerëzore.

Diku, dikush vdiq
Një pauzë e gjatë heshtjeje sirena e ambulancës.
Ishte ende diku, diçka ndaloi.

Dera e saj u mbyll. Çfarë u dëgjua?
Nata ishte krejt e zbrazët
Megjithatë në heshtjen e tyre, ata e dinë
ajo po vjen për ne.

Shkuarja në Kishë

Pasi jam i sigurtë se asgjë nuk ndodh aty
shkel brenda, mbyll derën me një zhurmë të mbytur.
Një tjetër shkuarje në kishë, qilima, ulëse dhe gur,
libra të vegjël, lule të shpërndara, të këputura
që të Dielën, të nxira tani, ca tunxh dhe gjëra
deri në fundin e shenjtë të katedrës, kisha e pastër, e vogël
dhe një heshtje e pashpërfillshme, e mykur dhe nervoze,
Zoti i mbrujtur e di për sa kohë. Pa kapele, heq
mbërthyeset e biçikletës me një përkulje sikletosëse.

Lëviz përpara, zgjas duart drejt ujit të pagëzimit
nga ku qëndroj, çatia duket pothuaj e re-
e pastruar apo restauruar? Dikush do ta dijë, unë jo,
afrohem te dollapi i librave, lexoj disa vargje
me shkronja të mëdha, impozante dhe shqiptoj
" këtu mbaron" shumë më me zë sesa e marr me mend.
Jehonat më përqeshin shkurt. Më pas tek dera
nënshkruaj librin, dhuroj një gjashtë pensëshe irlandeze
që më fut në mendime se nuk ia vlente të ndalesha.

Megjithë ndalesën që bëra, në fakt e bëj shpesh,
dhe gjithnjë përfundoj me një përhumbje si kjo,
duke vrarë mendjen çfarë kërkoj aty, duke pyetur veten
kur kishat nuk do të përdoren më.
Çfarë duhet t'i kthejmë ato atëhere, nëse do t'i mbajmë
disa katedrale që mbahen vetëm për t'i vizituar,
pergamenat, kupa dhe dhe arka e bukës, në kuti të kyçura
dhe lëre pjesën tjetër në natyrë si delet në shi.
A duhet t'i shmangim ato pastaj si vende të pafat?

Oh, pas errësirës, a do të vijnë gra të frikësuara
t'i bëjnë fëmijët të prekin një gur të vecantë;
të gjejnë bimë shëruese për kancer ose të kështilluara
të shohin natën duke ecur një të vdekur fantazmë?
Fuqia në njëfarë forme ose tjetër do të mbetet;
në lojëra, enigma që duken të rëndomta
por supersticioni si besimi duhet të vdesë,
dhe çfarë mbetet kur edhe mosbesimi të jetë shuar,
barëra, rrugica me bar, driza, mure mbështetëse, qiell.

Një objekt më pak i njohur çdo javë që kalon,
një pikësynim më i errësuar, vras mendjen kush
do të jetë i fundit, i fundit fare, që do ta kërkojë
këtë vend për çfarë ai ishte: një nga shërbyesit
që tundet sipas ritmit, mban shënim dhe e di
çfarë ishte galeria e kishës?
Një i dhënë pas rrënojave, i eksituar pas antikes
apo i droguar pas Krishtlindjeve, duke nuhatur temjanin
e rasës dhe jakës së priftit, organos së kishës dhe mirës?
Apo do të jetë ai, si shembëlltyra ime,

i mërzitur, i paditur, duke parë lymin si fantazmë
të shpërndarë gjithandej, ende me drejtim tek ky kryq
përmes shkurres së periferisë sepse ajo mbante të
    paprishur
kaq gjatë dhe qetësisht çfarë ishte krijuar dikur
veçse të shkapërdarë tani, për martesa dhe lindje,
vdekje dhe mendime si këto - për të cilën ishte ndërtuar
kjo kishë si guaskë speciale? Megjithëse s'kam ndonjë ide
për çfarë vlen kjo plevicë me ajër të rëndë,
më pëlqen të qëndroj ende këtu në heshtje.

Kjo është një shtëpi e meditimit në një tokë të meditimit
në ajrin e përzier të së cilës detyrimet tona takohen,
njihen dhe vishen si fatet tona të paracaktuara
dhe që kurrë nuk mund aq shumë të vjetërohet.
Meqë çdo njeri përherë do të bëjë çudi,
një dëshirë e fortë në veten e tij e fut në mendime
dhe e tërheq me forcë graviteti drejt kësaj toke
të cilën ai pasi e dëgjoi, iu përshtat për t'u bërë më i
    mençur,
sikur vetëm kaq shumë të vdekur shtrihen rreth e rrotull.

1955

Në anglisht, titulli: Church Going.

Dashuria Përsëri

Dashuria përsëri, duke masturbuar në tre e një çerek
(e sigurtë, ai e ka marrë atë në shtëpi tani?)
Dhoma e gjumit e nxehtë si një furrë
të bërë rrafsh nga pija, pa treguar sesi
do të takohen të nesërmen dhe më pas
dhimbja e zakonshme si dizenteri.

Dikush tjetër duke i ndjerë gjinjtë dhe fundbarkun e saj
Dikush tjetër i mbytur në atë vështrim të qerpikëve
Dhe unë që duhet të bëj të paditurin,
ta quaj qesharake, apo mos ta vras mendjen
Madje... përse ta thuash me fjalë?
Harroje më mirë atë gjë.

që përhapet te gjallesat e tjera si një pemë,
i lëkund edhe ato në një lloj kuptimi
dhe thotë, përse nuk funksionoi kurrë për mua.
Ka diçka që ka të bëjë me dhunën,
shumë kohë më përpara dhe mësimet e gabuara
dhe arrogancën që nuk m'u hoq kurrë.

Duke vazhduar të jetosh

Duke vazhduar të jetosh, është përsërit
një zakon të krijuar për të domosdoshmet-
Si të humbasësh gjithnjë apo të shkosh pa të.
Në varësi të kohës.

Kjo humbje interesi, flokësh dhe iniciative
Ah nëse loja do të ishte poker, po
Mund t'i hapësh letrat, të skicosh një shtëpi të tërë!
Por ky është shah.

Pasi ta kesh vrarë mendjen gjerë e gjatë,
ç'ke në dorë është e qartë si një listë bagazhesh.
Ndonjë gjë tjetër mendohet se nuk të duhet
për ekzistencën.

Po çfarë vlere ka? Vetëm ajo, në kohë,
identifikojmë përgjysmë shenjën e pakuptueshme
Të gjitha sjelljet tona e thonë, gjurmët aty të çojnë.
Por për ta rrëfyer,

atë mbrëmje të gjelbër kur vdekja jonë fillon,
siç ishte në atë moment, vështirë se kënaq kënd,
meqë u aplikua vetëm tek një njeri, njëherë,
madje edhe ai duke ndërruar jetë.



Karikaturë nga Arben Meksi

ANDRE MAUROIS
Portiku Korintian

Tregime | Përktheu: Feride Papleka

Pas një paradoktorature në filozofi, Maurois drejtoi një uzinë familjare në Normandi. Gjatë Luftës së Parë botërore shërbeu në ushtrinë britanike, për kujtimet e së cilës shkroi librin "*Heshtjet e kolonelit Brambël*". Tregimet e tij janë si romane të vogla, tradicionale, tepër të matura dhe herë-herë paraqiten si kronika të mbushura me një realizëm të mprehtë, larg iluzioneve. Ai shkroi edhe tregime filozofike si dhe biografi të romanizuara. U zgjodh anëtar i Akademisë Franceze më 1938.

Nikolay Milioti, *Portret i André Maurois*, Paris (1930)

IRENA

-Sa e lumtur do të isha të dilja sonte me ty, - tha ajo. - Ka qenë një javë tepër e mundimshme. Aq punë e aq zhgënjime. Por me ty pranë i harroj të gjitha. Dëgjo, shkojmë e shohim një film të bukur në mbrëmje?

-Mos kujto se do të më çosh në kinema sot, - tha ai i çmeritur.

-Sa keq, - tha ajo. - Do të isha shumë e lumtur ta shihnim së bashku atë film. Por s'prish punë. Është hapur një kabare e re në Monparnas, ku kërcejnë ca martinikezë të mahnitshëm.

-Ah, jo, - tha ai dhe ngriti zërin. - Jo muzikë negre, Irenë. Jam i ngopur me të.

-Po çfarë të pëlqen të bësh? - tha ajo.

-Ti e di, - tha ai - Të ha darkë në një restorant të qetë, të bisedoj, të kthehem te ti, të shtrihem në divan e të ëndërroj.

-Mirë, pra, nuk po shkojmë, - tha ajo. - Ti je tepër egoist, i dashur. Të duket e çuditshme? Askush s'ta thotë të vërtetën. Askush. Ti je mësuar t'i trajtosh gratë duke i quajtur dëshirat e tua si ligje. Je një lloj sulltani modern. Haremi yt është i madh... Shtrihet në dhjetë vende. Skllavet e tua janë gratë. Dhe jot shoqe është më skllave se të tjerat. Kur ke dëshirë të ëndërrosh, ato duhet të soditin tek ëndërron. Kur ke dëshirë të zbavitesh, ato duhet të shndërrohen në Sheherezade. Mjaft më, i dashur. Do të gjendet të paktën një grua në botë që s'do t'u nënshtrohet tekave të tua.

Ajo pushoi dhe zuri të fliste përsëri me një ton më të butë.

-Sa gjë e pikëlluar, Bernar. Unë u gëzova shumë që të pashë. Pandehja se do të më ndihmoje ta kapërceja mërzinë. Kurse ti mendon vetëm për vete. Ik pra. Dhe kthehu kur ta kesh kuptuar se përveç teje ekzistojnë edhe njerëz të tjerë.

* * *

Gjithë natën shtrirë, pa gjumë në sy, Bernari meditoi i pikëlluar. Irena kishte të drejtë. Ai ishte i urryer. Jo vetëm që e mashtronte dhe e braktiste Irenën, që ishte e ëmbël, besnike dhe e përulur, por e bënte këtë me ndërgjegje. Përse ishte i tillë? Ç'ishte kjo nevojë për sundim? Nga vinte ajo pamundësi për të menduar për të tjerët? Duke sjellë në mend të kaluarën e vet, ai kujtoi një rini të vështirë, femra të paarritshme. Në egoizmin e tij kishte shenja hakmarrjeje, në cinizmin e tij kishte teprim. Kjo nuk tregon zgjuarsi. " Zgjuarsi? „ tha ai me vete. Unë po bie në banalitete. Duhet të jesh i fortë. Në dashuri ai që nuk gllabëron është i gllabëruar. Sidoqoftë, duhej të ishte një lloj lehtësimi ndonjëherë që të çlodheshe, të ishe më i dobëti, ta kërkoje lumturinë tënde te lumturia e një tjetri.

Ca nga ca, të shoqëruara me një heshtje që sa vinte e shtohej, veturat e fundit u futën në garazhe. Të kërkosh lumturinë tënde në atë të tjetrit. A do të mundej ai? Kush e kish dënuar të ishte i egër? A nuk ka secili të drejtë ta fillojë jetën nga e para në çdo kohë? Do të gjente vallë partner më të mirë se Irena në këtë rol të ri? Irena ishte aq tërheqëse me fustanin e vetëm të mbrëmjes, me çorapet e arnuara, me mantonë e vjetrur. Irena, që ishte aq e bukur dhe aq e varfër. Aq bujare në varfërinë e saj. Dhjetëra herë ai e kishte parë duke ndihmuar studentët rusë që ishin më të varfër se ajo dhe që pa atë ata do të kishin vdekur urie. Ajo që para Revolucionit kishte jetuar si vajzë princi, tani punonte gjashtë ditë në javë në një magazinë. Si kishte guxuar ai të bënte pazar me kënaqësinë e thjeshtë të një mbrëmjeje të lirë?

Dritaret u drodhën me zhurmë nga autobusi i fundit. Tani qetësinë e natës nuk do ta prishte gjë. I lodhur me vetveten, Bernari u përpoq të flinte. Befas e pushtoi një ndjesi paqeje. Kishte marrë një vendim: Do t'i kushtohej lumturisë së Irenës. Ai do të ishte për të një mik i dhembshur, i kujdesshëm, i bindur. Po, i bindur. Ky vendim e paqtoi aq shumë sa menjëherë e zuri gjumi.

* * *

Të nesërmen në mëngjes, kur u zgjua, ai ndihej i ngazëllyer. U ngrit e u vesh duke kënduar. Kjo s'i kishte ndodhur që në adoleshencë."Në darkë, mendoi, do të shkoj tek Irena e do t'i kërkoj të falur".

Kur po lidhte kravatën, ra telefoni.

-Alo, - ishte zëri gazmor i Irenës. - Ti je Bernar? Dëgjo. Mbrëmë natën s'më zinte gjumi. Më vriste ndërgjegjja. Sa keq u solla me ty. Më fal! S'e di se ç'kisha...

-Përkundrazi, unë, - tha ai... - Irenë, tërë natën jam betuar se do të ndryshoj.

-Ç'marrëzi, - tha ajo. - Ti s'duhet të ndryshosh. Jo! Ajo që dua te ti janë pikërisht këto trille, këto kërkesa, ky karakter prej fëmije të llastuar. Është kaq e këndshme. Një burrë që të bën të sakrifikosh. Desha të thosha se në mbrëmje jam e lirë, s'kam ndonjë program. Vendos ti për mua...

Duke ulur telefonin, Bernari tundi dorën me trishtim.

PORTIKU KORINTIAN

Për dyzet vjet të jetës së tyre bashkëshortore lordi dhe ledi Barçestër kishin jetuar në një shtëpi në Park Lein. Por, pas luftës ata u ndodhën ngushtë ekonomikisht. I kishin prishur lekët pa kujdes: njëri prej djemve qe vrarë dhe e veja e djalit me gjithë fëmijë u kishin mbetur ngarkim. Veç kësaj, taksa mbi të ardhurat ishte bërë pesë shilinga për një livrë. Lordi Barçestër u bind se nuk i mbante dot edhe pronën familjare në Syseks edhe shtëpinë në Park Lein. Pas një ngurrimi të gjatë, ai vendosi t'i hapte zemrën gruas për shqetësimet e tij. Ca kohë pati mëtuar se do ta hidhëronte. Tridhjetë vjet më parë jeta e tyre bashkëshortore kishte qenë e stuhishme, por pleqëria kishte sjellë qetësi, zemërgjerësi e dhembshuri.

-E dashur, - tha ai, - jam tepër i dëshpëruar. Shoh vetëm një mënyrë që mund të na ndihmojë për të mbyllur jetën tonë me ndershmëri, por e di se kjo do të lëndojë në shpirt. Do të të lë të lirë ose të pranosh, ose të ikësh. Ja si është puna: territoret pranë Parkut kanë arritur një vlerë të madhe. Një sipërmarrës ka nevojë për ngastrën tonë, e cila formon një truall të mbyllur me pronën e tij. Dhe më ofron një çmim të tillë, që ne jo vetëm do blinim një shtëpi në të njëjtën lagje, por do të hiqnim mënjanë një shumë që na siguron jetesën edhe për disa vjet që na kanë mbetur. E kuptoj se ti e do shtëpinë Barçestër, ndaj e pata vështirë të bëja diçka që s'do të pëlqente.

Ledi Barçestër pranoi me këtë këmbim dhe pas ca muajve çifti i moshuar u vendos në një shtëpi të re, disa qindra metra larg asaj që iu desh ta braktisnin dhe që punëtorët kishin filluar menjëherë ta shkatërronin. Lordi dhe ledi Barçestër, që kalonin para shtëpisë së tyre të vjetër kur dilnin, provonin një përshtypje të çuditshme duke parë të zhbëhej ngadalë një trajtë që për ata kishte qenë trajta më e natyrshme dhe më e qëndrueshme e universit. Kur e panë atë ndërtesë pa çati, atyre iu duk sikur ishin ata vetë jashtë, në erë e në shi. Ledi Barçestër ndjeu dhimbje sidomos kur muri i fasadës u ça dhe ajo zbuloi një nga një, si në një skenë para spektatorëve, dhomën e Patrikut, djalit të vdekur, e pastaj dhomën e vet ku kishte kaluar pjesën më të madhe të kohës gjatë dyzet vjetëve.

Që nga rruga ajo vështronte mëndafshin me vijë të zezë, që shndriste në tapicerinë e dhomës. Ajo e kishte vështruar aq shumë kur ishte në zi, kur ishte sëmurë, e lumtur apo e pikëlluar, sa piktura e këtij stofi i ngjante si sfond

mbi të cilin qe vizatuar jeta e saj. Ditë më vonë ajo pa diçka që e habiti së tepërmi. Punëtorët e shqitën mëndafshin dhe prapa tij doli një letër bardh e zi që e kishte harruar, por që i solli në mend menjëherë, me një forcë misterioze, lidhjen e gjatë me Harri Vebin. Sa herë kishte ëndërruar ajo pa mbarim mëngjeseve për shtëpitë japoneze pasi lexonte letrat aq të bukura që i shkruante Harri nga Lindja e Largët. Ajo e kishte dashur shumë. Tani ai ishte Sër Harry Webb, ambasador i Shkëlqesisë së Tij në Spanjë.

Shiu e shqiti shpejt letrën bardh e zi dhe poshtë saj u shfaq një tjetër letër. Ishte një pikturë me lule jo dhe aq të bukura, por Ledi Barçestër u kujtua se i kishte zgjedhur enkas në çastin e martesës, më 1890. Aso kohe ajo vishte fustane prej mëndafshi të kaltër dhe gjerdanë qelibari të verdhë; përpiqej t'i ngjante zonjës Bërn Xhauns e të dielave shkonte për çaj tek Uilliam Morris, shkrimtar. Sa kohë që mundej të shihte fragmente nga kjo letër ngjyrë trëndafili e të blertë, ajo vinte disa herë në ditë, sepse ai vizatim i sillte para sysh rininë dhe kohën e dashurisë së saj të marrosur për Lordin Barçestër.

Më në fund muret u shembën vetë dhe lordi e ledi Barçestër, duke shkuar një ditë të shëtisnin më këmbë në park, panë se prej tërë shtëpisë kishte mbetur vetëm portiku i vogël korintian që kishte shërbyer si strehë për hyrjen. Ishte një spektakël i jashtëzakonshëm e i pikëlluar, sepse ky portik, në krye të shkallëve, ngrihej mbi një peizazh të trishtuar gurësh të stivosur nën një qiell dimri. Ledi Barçestër soditi gjatë retë që vraponin pas kolonave të bardha, pastaj i tha të shoqit:

-Ky portik më kujton ditën më të trishtuar të jetës sime. Nuk kam guxuar kurrë të flas për të, por ne jemi tashmë kaq të moshuar, sa nuk ka më rëndësi. Ishte koha kur unë doja Harrin dhe ju donit Sibilën. Një mbrëmje unë kisha shkuar në ballo për të takuar Harrin që ishte kthyer nga Tokioja. Isha e ngazëllyer nga ky takim që e prisja prej disa javësh, por Harri kishte marrë leje vetëm sa për t'u fejuar dhe tërë mbrëmjen ai vallëzoi me një vajzë të re, duke u hequr se nuk më shihte. Në veturë, duke u khyer, unë qava. Erdha në shtëpi. E mendova se isha shpërfytyruar prej lotëve dhe s'pata kurajo të dilja përpara në atë gjendje. Bëra sikur i rashë ziles, e lashë karrocierin të nisej, pastaj u mbështeta në njërën nga këto kolona dhe ndenja aty. Dënesja. Binte shi i madh. E dija se edhe ti mendoje për një grua tjetër e më dukej se për mua jeta kishte marrë fund. Ja ç'më kujton ky portik i vogël që do të zhduket së shpejti.

Lordi Barçestër, që e kishte dëgjuar këtë rrëfim me simpati e me interes, e kapi me dashuri gruan nga krahu.

-E di se ç'do të bëjmë? - tha. - Para se ta shkatërrojnë këtë portik, që është varrezë e kujtimeve të tua, ne do të blejmë të dy ca lule e do t'i vendosim në krye të shkallëve.

Çifti i moshuar shkoi te një luleshitës, bleu ca trëndafila dhe i vendosën te këmba e një kolone korintiane. Të nesërmen portiku ishte zhdukur.

SHQIPTAR OSEKU

Zjarri

Tregim

Si s'ikëm me kohë, tha me vete. Kishte shpresuar marrëzisht gjer në çast të fundit, më tepër për hir të plakut. Por kot. Horizonti ishte errësuar dhe shtëpia mbante një si erë shkrumb. Avllia e përcëlluar ish mbuluar nga një si tis gri. Hiri i kish hyrë edhe në trup. Në hundë. Në sytë që i digjnin. Në gojën e tharë. Si s'ikëm me kohë. Televizori kish lajmëruar që para dy ditësh se zjarri po i qasej edhe anës së tyre, por në fillim dukej larg, në bregun tjetër të lumit. Kur kish parë fqinjët dje duke ikur nën qiell të kuq, me kalamajtë e plaçkat ngarkuar në traktor e mbi veturë, e kish tundur kokën si gërnjar. Ik edhe ti mor burrë, i kishin thërritur. Fshati mbaroi. Mos prit çastin e fundit. Por ncuk. Ku bindej ai. Era po fryn tej, u kish thënë, e shtyn zjarrin tutje. Ku ikni o derëzi. Zjarri është kudo. Këtu na mbron lumi.

Por kjo qe dje, a. Sot era kish ndërruar beftë kahje. Lubia e flakëve kish përshkuar shkurret e thara mbi lumë, kish kapërcyer ujin e ish kapur në breg të këtejmë. Tash po qasej ngadalë, duke gëlltitur shtëpitë e lagjes një nga një. Tek ai arrinin krisma të tullave që plasnin, e rënkimi i trarëve të shkrumbuar që rrëzoheshin të këputur në mes. Fqinjët qenë me fat që s'dëgjuan. Shkoi te rafti i librave dhe mori me duar që i dridheshin lekët e fshehur nën fjalor gjigant të shqipes, e tre librat që i kish ndarë plaku mbrëmë. Biblën. Fishtën. Kadarenë. Nganjëherë dilte nga mjegulla e demencës, plaku; por të shumën rronte në mjegull, në fjalë të pakuptueshme. Si s'ikëm me kohë. I hodhi një sy të fundit dhomës, e doli nga aty si i përvëluar.

Kopshti ishte një skenë e paparë. Fjolla të holla hiri binin të përkundura ngadalë si borë e imtë gri prej një qielli sterrë. Tymi e kish mbuluar botën. Ishe si ditë e qametit. Matanë rrugës, shtëpia e fqinjëve ish pushtuar tashmë nga djaj të kuqërremtë që vallëzonin mbi kulm. S'ish hera e parë që shihte vallen e tyre. Një stuhi e ngjashme ia kish gllabëruar një herë moti edhe shtëpinë e fëmijërisë, duke lënë mbas vetëm shkrumb e hi. Shkoi me nxitim te fundi i oborrit, te vetura ku e kish lënë plakun. Por aty, e kapluan djersë të ftohta. Plaku s'ishte më. Ku dreqin...?!

Shikoi brenda në veturë, se mos ish shtrirë. Rripi i sigurisë si monument dështimi, gjysma dergjej jashtë derës së hapur. Si e bëri athua?! Plaku s'e kish dot zbërthyer vetë atë dreq rripi tash dy vjet. Shikoi përreth kopshtit në të gjitha anët, por ncuk. Asnjë gjurmë. Ish tretur, si të mos kish qenë kurrë. E thirri në emër me zë të lartë, një herë. Dy herë. Kot. Edhe britmat dilnin si të mbytura në këtë batërdi. Bah, kjo na mungonte!

Ku mund të ishte vallë? U kujtua që s'kish shikuar në qilar. Aty linin sende të vjetra, se mos na hyjnë në punë ndonjëherë. Nga shtëpia e fqinjëve përballë u dëgjua një oshëtimë e mbytur, si grahmë e vdekjes. Flakët mund të mbërrijnë këtu çdo çast. U sul me vrap drejt qilarit dhe po, deriçka e jashtme ishte e hapur. Këtu qenka, dreqin. Brenda ishte terr, priza elektrike s'punonte, sërish. Thirri një herë, dy. Tri herë. Plaku zakonisht përgjigjej kur e thirrje në emër. Asgjë. Bah. Befas vuri re një si plasaritje të hollë drite në fund të qilarit. Ishte dera e brendshme, ajo që e lidhte qilarin me shtëpinë. Të jetë kthyer gjë brenda? Po pse?!

Nisi të ecë me kujdes nëpër rrëmujën e errët të sendeve që ndodhej në qilar, pesëdhjetë vjet histori koti që duhet të ish flakur qyshkur. Mund t'i kish ngarkuar në kamionçinë, e t'i kish varrosur diku larg. Por jo, se mund të na hyjnë në punë. Bah. E tash duhej të maste hapin nëpër errësirë, se mos i ngulej diku një kunj i ndryshkur. Iu duk se mori një shekull për të arritur gjer te dera e brendshme, ndërsa jashtë ndiheshin zhurmat e skëterrës. Ngjiti shkallët, e hyri prapë në hajat të shtëpisë. Ia thirri emrin prapë, një herë, dy. Pa përgjigje. Por nga dhoma e pleqve u dëgjua një zhurmë.

Ndodhej aty, nderë me rroba por symbyllur në shtrat të vjetër. Bah. Iu qas dhe e preku, e plaku i shqeu sytë si i zgjuar beftë nga gjumi. Çohu se duhet të ikim, i tha, ka rënë zjarr. Po digjet te fqinjët. Plaku zgjohej gjithmonë gërnjar, sikur t'ia kish grabitur kush një ëndërr a hisen e parajsës. A e çove nënën tënde, e pyeti. Plaka kish vite e vdekur. Ajo ka ikur tashmë, i tha. Po si kështu, pa mua; e librat, a i gjete. Kur u sigurua se librat ishin në veturë, plaku ia kapi dorën, e u ngrit me mundim.

Pamja nga ballkoni ishte e skëterrshme. Plaku iu shtrëngoi dorën me forcë. Tek po zbriste shkallët me mundim, nisi të flasë si me vete. Na ranë prapë mor Pal. Qysh s'na u ndanë mana, he Zoti i vraftë. Pali ishte i vëllai i plakut, edhe ai i shuar qyshkur. A i sheh qysh bëjnë, fara e ligë. Na i djegin shpitë. Na i mbysin fëmijët në djep. Nuk diti se ç'të thotë. Pleqtë dementë nganjëherë acarohen kur i përmend, e tashti s'ish koha për dramë. Mjafton kjo drama e madhe që po ndodh.

Mezi arritën gjer te vetura. E rehatoi plakun me rrip, pastaj çeli hapekrah kanatat e portës së garazhit. U ul pranë timonit dhe ashtu dolën të dy në gurnajën e rruginës së vogël të fshatit. Vetëm aty vërejti se zjarri kish kapluar që të katër shtëpitë e anës përballë. Gjithë ana e djathtë e rrugës ishte tym e flakë. Në anën e majtë, shtëpi të lashta me avlli identike e pemë frutore e mure të lyera me gëlqere shikonin me llahtar çfarë po ndodhte përballë, si të dënuar që presin në rend të ekzekutimit. Në atë çast, rrugina e vogël që ndante të dy radhët e shtëpive iu duk si ato hapja biblike e Detit të Kuq. Duhet të ikim, tha. Të shpëtojmë kryet.

Prit, i tha plaku, a ka ikë Marku. Po or babë po, këtu jam, u përgjigj, e shtypi pedalin e gazit. Por plaku e ndali veturën në vend, me fren të parkimit. Prit mana ti, a ka ikë Marta. Ishte hera e parë që e dëgjonte t'ia thotë emrin e së shoqes, zakonisht e quante jot ëmë, a plaka. Po babë ka ikë, i tha me zë të lartë, të ikim edhe ne. Prit, a i more librat. Të shpëtojnë nga zjarri Shadrak, Meshak, Abidnego. Po babë, i tha, s'i di këta që po përmend por mora ata që zgjodhe vetë mbrëmë, biblën, Fishtën, Kadarenë. A të ikim tashti. U mundua t'ia hiqte dorën nga freri, por kot. Plaku e kish kapur si me rigor mortis, nuk i shqitej dot. Dil e ndryje portën Pal, i tha. Edhe drynin merre me vete. Nuk i lihet hasmit shtëpia me dyer hapë.

Bah. Kot të arsyetoje me plakun; se nga i kish ardhur kjo forcë prej djalli mu sot. Doli nga vetura në një botë që po digjej tym e flakë, e gjeti drynin që ndodhej në një vend te porta, e i mbylli kanatat e rënda. Ishte bërë zor edhe të merrje frymë. Tek po u vinte drynin, pa se si shkëndija të imta zjarri po uleshin ngadalë si xixëllonja mbi pemët e mollëve dhe ftonjve që kishin në kopsht, e më tej akoma, mbi aklat e dritareve dhe mbi tjegullat e kulmit. S'ish hera e parë që shihte fluturimin e tyre. Shkëndija si këto ia kishin djegur një herë moti edhe fëmijërinë, duke lënë mbas vetëm shkrumb e hi. Para sysh iu fanitën pamje që i kish harruar qyshkur. Ai duke mbajtur nënën përdore. Babai me të vëllain, Palin, duke qetësuar kuajt e trembur te fundi i kopshtit.

U kthye në veturë, e ia zgjati drynin të jatit. Vetëm atëhere plaku lëshoi frerin. Bëhet mirë Pal, i tha, mbahu i fortë. Dryrin po e mbaj unë. Marku i vogël e Marta janë këtu me ne. Edhe librat i nxorëm, na ruajnë nga zjarri, Shadrak, Meshak, Abidnego. Kthehemi një ditë, e ndërtojmë shtëpinë përsëdyti, edhe më të madhe.

Ndërsa po dilnin nëpër rruginën e ngushtë, vetura e fundit që po linte fshatin e përcëlluar, iu bë sikur pa lart në qiell ca si re të errëta në largësi. Por mund të ishte edhe tymi i flakëve, ku ta dish. Njeriu në zor s'bën t'i zë besë vetes. Si s'ikëm me kohë, psherëtiu. Hodhi sytë në pasqyrë dhe pak rruginën që po kridhej në tym, e avllitë e përcëlluar që merrnin flakë. Ku ikni o derëzi, u kish thënë gjindes dje. Zjarri është kudo. Këtu na mbron lumi. Por lumi i kish tradhtuar kësaj radhe, ashtu sikur i kish tradhtuar dikur. Fqinjët qenë me fat që s'dëgjuan.

Bëhet mirë Pal, i tha plaku prapë, mbahu i fortë. Drynin po e mbaj unë. Kthehemi një ditë. E ndërtojmë shtëpinë përsëdyti. Ashtu qoftë, u përgjigj. Në pasqyrë, katundi i lashtë bënte dritë në errësirë.

Shkrimtarja japoneze, Rie Qudan:

Pse përdora ChatGPT për të shkruar romanin tim fitues të çmimit John Self

"Sympathy Tower Tokyo" shkaktoi polemika për shkak se ishte shkruar pjesërisht duke përdorur AI. A mendon autorja e tij se teknologjia mund të shkruajë një roman më të mirë se njeriu?

"Nuk ndihem veçanërisht e pakënaqur që puna ime përdoret për të trajnuar AI-në," thotë romancierja japoneze Rie Qudan. "Edhe nëse kopjohet, jam e sigurt se ka një pjesë timen që do të mbetet, të cilën askush nuk mund ta kopjojë."

Autorja 34-vjeçare po flet me mua përmes Zoom nga shtëpia e saj pranë Tokios, përpara botimit të përkthimit në gjuhën angleze të romanit të saj të katërt, "Sympathy Tower Tokyo". Libri shkaktoi polemika në Japoni kur fitoi një çmim prestigjioz, pavarësisht se ishte shkruar pjesërisht nga ChatGPT.

Autorja flet një anglishte bisedore, por përkthyesi i saj, Jesse Kirkwood, është gjithashtu në linjë, duke interpretuar pyetjet dhe përgjigjet kur është e nevojshme. Në zemër të "Sympathy Tower Tokyo" është një arkitekte japoneze, Sara Machina, e cila është ngarkuar të ndërtojë një kullë të re për të strehuar kriminelët e dënuar. Do të përfaqësojë atë që një personazh – jo pa ironi – e quan "mendjehaptësia e jashtëzakonshme e popullit japonez", në atë kuptim që kulla do t'i strehojë shkelësit e ligjit me rehati dhe dhembshuri.

Në roman, Sara, vetë viktimë e një krimi të dhunshëm, pyet veten nëse kjo qasje e dhembshur ndaj kriminelëve është e përshtatshme. A e pasqyron kjo dhembshuri shoqërinë japoneze në realitet?

"Patjetër që është e përhapur," thotë Qudan. Një nga nxitjet për të shkruar romanin, shton ajo, ishte vrasja e ish-kryeministrit Shinzo Abe në korrik 2022. "Personi që e qëlloi u bë qendra e vëmendjes në Japoni – dhe historia e tij nxiti shumë dhembshuri nga njerëzit. Ai ishte rritur në një familje thellësisht fetare dhe i ishte hequr liria. Kjo ide kishte qenë në kokën time për një kohë të gjatë, dhe kur fillova të shkruaja romanin, ajo doli sërish si pjesë e procesit."

Çështja e qëndrimeve publike ndaj kriminelëve përshkon historinë, në mënyra serioze dhe satirike. Banorët e mundshëm të kullës duhet t'i nënshtrohen një "Testi Dhembshurie" për të përcaktuar nëse e meritojnë dhembshurinë ("A kanë qenë prindërit tuaj ndonjëherë të dhunshëm ndaj jush? – Po / Jo / Nuk e di") ... dhe vendimi përfundimtar do të merret nga AI.

"Sympathy Tower Tokyo" fitoi çmimin Akutagawa në 2024 për autorët e rinj ose në rritje kur u botua për herë të parë. Ajo ishte "e lumtur", thotë, por edhe "e çliruar, sepse sapo debuton si shkrimtar, ka një presion të vazhdueshëm për të fituar këtë çmim". Në vitin 2022, ajo ishte nominuar për librin e saj "Schoolgirl", por nuk fitoi. "Ndjeva se i kisha zhgënjyer njerëzit duke mos e fituar çmimin, dhe kjo ishte diçka që nuk doja ta përsërisja. E dini, ai çmim mbetet me ty gjithë jetën."

Por libri tërhoqi vëmendje edhe sepse Qudan tha se një pjesë e tij – 5% ishte shifra e dhënë, megjithëse tani thotë se ishte vetëm një përafërsi – ishte shkruar duke përdorur inteligjencën artificiale. Kjo, më tregon ajo, përfshinte pjesë të romanit që paraqiten si një bisedë e një personazhi me ChatGPT. Por Qudan gjithashtu "mori shumë frymëzim" për romanin përmes "bisedave me AI-n dhe nga kuptimi se ai mund të pasqyrojë proceset e mendimit njerëzor në mënyra interesante". Përdorimi i AI-së nga Qudan, me fjalë të tjera, nuk kërkon të mashtrojë lexuesin, por të na ndihmojë të shohim efektet e saj.

Një personazh ndjen keqardhje për chatbot-in, "të dënuar me një jetë boshe duke nxjerrë pafundësisht gjuhën që iu tha të nxirrte, pa kuptuar kurrë se çfarë donte të thoshte ky mozaik fjalësh të prera e të ngjitura të njerëzve të tjerë".

A ka frikë Qudan se AI do të zëvendësojë shkrimtarët njerëzorë? "Ndoshta do të vijë një e ardhme kur kjo do të ndodhë, por tani për tani nuk ka asnjë mënyrë që një AI të shkruajë një roman më të mirë se një shkrimtar njerëzor." Mes lexuesve japonezë, "Sympathy Tower Tokyo" "tërhoqi vëmendje për përdorimin e AI. Por më shumë se kaq, ishte fokusi te vetë gjuha ai që gjeneroi vërtet diskutime; se si ndryshimet e gjuhës gjatë dekadave të fundit po ndikojnë në mënyrën se si njerëzit veprojnë apo i shohin gjërat."

Dhe kjo na çon te çështja kyçe në zemër të librit të Qudan-it. "Sympathy Tower Tokyo" në të vërtetë ka të bëjë tërësisht me gjuhën, e cila në libër nuk është vetëm mënyra se si shprehemi, por mënyra se si zbulojmë veten. "Fjalët përcaktojnë realitetin tonë," thotë një personazh.

Në roman, një debat kyç është rreth rritjes së përdorimit të katakana-s në Japoni – domethënë, shkrimi i përdorur për fjalët me prejardhje të huaj. Fjalët e shkruara në katakana (në krahasim me shkrimin hiragana dhe karakteret kanji, të cilat përdoren për të shkruar fjalët tradicionale japoneze) i ngjajnë transliterimeve të anglishtes – "negurekuto" për neglizhencë (neglect), "fōrin wākāzu" për punëtorë të huaj (foreign workers) – dhe për veshët japonezë ato janë "më të buta, më eufemistike" se fjalët tradicionale kanji, dhe mund të shmangin "shprehjet diskriminuese". Personazhi Sara mendon se "japonezët po përpiqen të braktisin gjuhën e tyre". I dashuri i saj dëshiron të "ndalojë këtë përhapje të mjerë të katakana-s".

Por ndalimi i saj nuk është i lehtë, dhe ndoshta jo i mundur. Qudan shpjegon se ndërsa brezat e vjetër ndonjëherë zgjedhin katakana në vend të kanji, apo anasjelltas, për brezat e rinj si ajo



– Qudan lindi në 1990 – katakana "është bërë një standard që nuk vihet në dyshim".

Ky nuk është thjesht një detaj akademik apo kulturor, por një çështje urgjente për politikën e sotme të Japonisë. Në zgjedhjet japoneze muajin e kaluar, partia e ekstremit të djathtë Sanseito pësoi një rritje të madhe në mbështetje, duke fituar 14 vende në dhomën e lartë të parlamentit, ku më parë kishte vetëm një. Partia bën fushatë me një slogan që përkthehet si "Japonezët të parët", duke i bërë jehonë sloganit të Donald Trump dhe "Amerika e para" të Maga-s. Suksesi i saj ka ngritur frikën e një reagimi të ashpër kundër të huajve.

"Fatkeqësisht," thotë Qudan, "realiteti është se jo të gjithë japonezët e mirëpresin diversitetin. Dymbëdhjetë vjet më parë, kisha një të dashur të huaj, jo-japonez, dhe ia prezantova prindërve të mi. Nëna ime ishte jashtëzakonisht e pakënaqur. E mbërtheu paniku. Mund të ketë qenë tronditja më e madhe e gjithë jetës sime të shihja nënën time të reagonte në këtë mënyrë. Kurrë nuk e kisha menduar atë si dikë që diskriminonte të huajt."

"Ka njerëz kudo rreth teje që kurrë nuk do të mendoje se kanë ato pikëpamje, por që në fakt i kanë. Shumë japonezë, në sipërfaqe, dinë si të sillen në një mënyrë që i bën të duken [se e mirëpresin diversitetin]. Dhe kjo mospërputhje mes asaj që njerëzit mendojnë brenda vetes dhe asaj që thonë është një tipar shumë dallues."

Kjo na kthen te gjuha, dhe se si ajo mund të fshehë dhe të zbulojë njëkohësisht. Në sloganin e saj "Japonezët të parët", shpjegon Qudan, partia Sanseito përdor fjalën në katakana për "të parët", në vend të fjalës tradicionale japoneze kanji. "Duke përdorur ekuivalentin në katakana," thotë Qudan, "shumë nga konotacionet negative mund të zëvendësohen me ato neutrale. Nuk i provokon njerëzit në të njëjtën mënyrë."

Krijon, me fjalë të tjera, një lloj mohueshmërie të besueshme? "Po, po. Ata e dinë saktësisht se çfarë po bëjnë. Dhe kjo është arsyeja pse ky përdorim i katakana-s kërkon vëmendjen tonë," përfundon Qudan. "Kur dikush përdor katakana, duhet të pyesim: çfarë po përpiqen të fshehin?"

Marrë nga The Guardian

ISAAC BABEL

Patoku im i parë

Përktheu nga rusishtja: Artemisa Kuznetsov

Savitski, komandant i divizionit të gjashtë, u ngrit në këmbë teksa më vështronte, dhe unë u shtanga nga bukuria e trupit të tij prej kolosi. Ai u ngrit, dhe me pantallonat e tij ngjyrë vjollcë, me kapelen vishnjë të hedhur mënjanë, me dekoratat e ngulitura në gjoks, e çau shtëpizën më dysh, siç e çan flamuri qiellin. Prej tij ndihej aroma e parfumit dhe një freski e ëmbël sapuni. Këmbët e tij të gjata ishin të ngjashme me ato të vajzave, të farkëtuara deri në supe, brenda çizmesh të shndritshme. Ai më buzëqeshi, goditi tavolinën me kamxhik dhe tërhoqi drejt vetes urdhrin, sapo të diktuar nga shefi i shtabit. Ky ishte një urdhër për Ivan Çesnokovin: të përparonte me regjimentin që i ishte besuar drejt Çugunov-Dobrivodka dhe, sapo të binte në kontakt me armikun, ta shkatërronte atë.

"... Për shkatërrimin e së cilës, – filloi të shkruante komandanti i divizionit, duke njollosur të gjithë fletën, – mbaj përgjegjës Çesnokovin deri në masën më të lartë. Në rast mosbindjeje nuk do të hezitoj dhe do ta godas me shuplakë aty për aty, gjë për të cilën ju, shoku Çesnokov, nuk mund të dyshoni, pasi keni qenë me mua në front për më shumë se një muaj..."

Komandanti i Divizionit të Gjashtë e nënshkroi urdhrin me ngazëllim, ua flaku ordinarcëve dhe ktheu sytë e tij gri, në të cilët vallëzonte gëzimi. I dhashë një dokument në lidhje me dërgimin tim pranë shtabit të divizionit.

– Përgatisnii dokumentat! – tha komandanti i divizionit. Përgatisni dokumentat dhe regjistrojeni këtë njeri për të gjitha privilegjet, përveç kënaqësisë të vijës së parë të frontit. Di shkrim dhe këndim?

– Di, – iu përgjigja, duke xhelozuar forcën dhe bukurinë e rinisë së tij, – jam diplomuar në drejtësi nga Universiteti i Shën Petërsburgut.

– Domethënë, ti je një nga ata spitullaqët, – bërtiti ai, duke qeshur, me syze mbi hundë. – "Ah, qen i fëliqur! Të dërguan tek ne, por a na pyeti njeri nëse të duam këtu? Këtu mund të të zhdëpin në dru vetëm pse mban syze. Dhe mendon se mund të rrosh këtu, kështu?"

– Do të rroj, — iu përgjigja, dhe shkova me intendentin në fshat për të kërkuar një vend për të kaluar natën.

Intendenti mbante baulen time të vogël mbi supe. Rruga e fshatit shtrihej përpara nesh, ndërsa dielli që po perëndonte, i rrumbullakët dhe i verdhë si një kungull, derdhte frymën e tij rozë në qiell. U afruam te një shtëpi me korniza të gdhendura. Intendenti ndali dhe papritur, me një buzëqeshje me faj, tha:

– Mund të kemi një problem me syzet, dhe nuk kemi ç'të bëjmë. Disa burrave këtu u mungon fisnikëria. Por nëse fiton zemrën e një zonje, zonjës më të dëlirë, atëherë ke respektin e të gjithëve.

Ai hezitoi, ende me baulen time mbi supe, u afrua pranë meje, pastaj u tërhoq me ngurrim dhe vrapoi drejt oborrit. Kozakët ishin ulur atje mbi kashtë dhe po rruanin njëri-tjetrin.

– Ja, trima, – tha intendanti, duke ulur baulen time në tokë. – Sipas urdhrit të shokut Savitski, ju jeni të detyruar ta pranoni këtë njeri në kabinat tuaja dhe pa asnjë proçkë, sepse ky njeri ka hequr mjaftueshëm nga çështje studimore.

Intendenti u skuq dhe u largua pa e kthyer kokën. Unë ngrita dorën te kapelja dhe përshëndeta kozakët. Një djalosh me flokë të gjatë dhe të verdhë si liri, me një fytyrë të bukur Rjazane[1], iu afrua baules sime dhe e hodhi jashtë në rrugë. Pastaj ktheu shpinën ndaj meje dhe, me një aftësi të çuditshme, filloi të lëshonte tinguj të turpshëm.

– Armë e kalibrit të lartë! – bërtiti një kozak i moshuar dhe qeshi, – breshëri zjarri.

E kishta humbur durimin, ndaj u tërhoqa. Atëherë, duke u sjellë zvarrë, fillova të mbledh shkresat dhe leckat e mia të grisura, që kishin rënë jashtë nga baulja. I mblodha dhe i çova në anën tjetër të oborrit. Pranë kasolles, mbi tulla, qëndronte një kazan, brenda të cilit ziente mish derri. Tymi që nxirrte të kujtonte shtëpitë e largëta të fshatit dhe tek unë bashkoi urinë me vetminë e papërshkrueshme. Mblodha kashtë dhe mbulova baulen time të thyer, e bëra në formë jastëku për të mbështetur kokën dhe u shtriva mbi të për të lexuar fjalimin e Leninit në Kongresin e Dytë të Komitetit, në gazetën 'Pravda'[2]. Dielli binte mbi mua nga kodrat e thepisura, kozakët më kalonin mbi këmbë, djaloshi më tallte pa pushim, ndërsa vargjet e dashura përpiqeshin të më arrinin përmes rrugësh me gjemba, por nuk mundeshin. Atëherë lashë gazetën mënjanë dhe shkova tek zonja e shtëpisë, që endte fillin e leshit në verandë.

– Zonjë, – thashë unë, – kam uri..."

Plaka ngriti sytë e saj gjysmë të verbër drejt meje dhe i uli përsëri.

– Shok, – tha ajo pas një heshtje të shkurtër, — gjithë kjo më bën te dua të var veten.

– E marrtë dreqi, – murmërita me bezdi, duke e shtyrë me duar, – nuk kam nerva të merrem me ty tani.

Kur u ktheva, pashë shpatën e dikujt të shtrirë në tokë. Një patok madhështor

1 I referohet tipareve të fytyrës së banorëve të rajonit të Rjazanit në Rusi.

2 Pravda ('E Vërteta') ishte gazeta zyrtare e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, e shpërndarë gjerësisht si organ i shtetit gjatë epokës sovjetike.

(vijon në faqen 23)

Për romanin "Shpikja e Morelit" të Adolfo Bioy Casares

DEKONSTRUKSIONE FRAGMENTARE PËR KRYEPERSONAZHIN RRËFIMTAR

Nga Enver S. Morina

Fantazia dhe dytësimi ka një paradigmë origjinale në veprën e Casares, jo vetëm si realitet por edhe si konvencion magjik. Projeksioni i rrëfyesit a projekti i Morelit në pavdekësinë e shpikësit ka një afinitet q*ë *të ndërtohet tërë ingranazhi për kapjen e të arratisurit a perfeksioni teknologjik i pushtetit?! Një utopi brenda një instalacioni vicioz ku jeta në një ishull mund t'i përkasë tërë njerëzimit, planetit.

Në kapërcyell të shekullit XVII e XVIII pas një aksidenti të anijes, shpëtimtari i vetëm Robinson Kruzo u gjend në një ishull të pabanuar. Është shkrimtari Daniel Defo që në veprën e tij e përjetësoj këtë aventurë të heroit si një nga ngjarjet më të vlefshme të krijimit të prozës, prandaj të dhënat thonë që romani "*Robinson Kruzo*" konsiderohet një ndër veprat më të përkthyera në të gjithë botën. Rreth dyqind e njëzet vjet më pas është shkrimtari argjentinas Adolfo Bioy Casares që na sjell një hero tjetër në ishull, rrrëfimtarin e arratisur nga burgu i dënuar me vdekje. Autori përmes rrëfimtarit duke i bërë një biografi të vetes po i drejtohet zonave, jo vetëm të paprekura, domëthënë origjinale, por edhe të panjohura në diskursin letrar.

Një kronologji në gjuhën shqipe për shkrimtarin Casares, në gërshetim edhe me Borges-in

Në vitin 1940, në moshën 26 vjeçare, Casares boton romanin "***Shpikja e Morelit***", të cilit parathënien e shkroi Borges. E jashtëzakonshme apriori. Dy shkrimtarë argjentinas të cilët do bashkëpunojnë më tej në linja të rralla të krijimtarisë letrare! Bashkëautor edhe në tregime! Tre "takime" veçojmë të botuara në shqip për krijimtarinë e Casares si prolog, si përgatitje për të lexuar romanin "***Shpikja e Morelit***", përkthyer nga origjinali nga Erion Karabolli.

Për herë të parë në gjuhën shqipe me Casares njihem në vitin **2000** përmes botimit të librit me poezi dhe me disa shkrime shtojcë "*Poezi*" te Borhes, përgatitur e përkthyer nga Anton Papleka. Portreti i Bioy Casares, dy-tre fjali për përmbajtjen e romanit dhe ndikimin e shkrimtarit, një ishull dhe një shpikës, përmes dy përgjigjeve të Borges-it të pyetjeve "Kur keni filluar të punoni me Bioy Casares?" dhe "Por ju keni shkruar bashkë me Casares-in?", e thotë edhe këtë:"*Jam i lumtur dhe krenar që kam bërë një parathënie për librin e tij të parë me vlera: "Shpikja e Morelit*" **1)**

Më pas në vitin **2002**, në "*Antologji e tregimit hiaspanoamerikan te shekullit XX*" hasim prozatorin Adolfo Bioi Kasares që së bashku me Borhes, Kortasar, Benedetti ishte i dyti pas Borhes me shtatë tregime. Ndoshta, është hera e parë që në shqip kemi këtë shkrimtar argjentinas me tregime (?). Përshkrime reale me sensin e një të papriture të mbyllur për t'u zgjidhur nga lexuesi. Në *Parathënie* shkruhet më së gjati për Casares. Gjithashtu në fund të kësaj antologjie kemi edhe të dhëna bibliografike të shkurtëra. **2)**

Në vitin **2005** "Bota Shqiptare" në përkthim te Agim Doksanit boton antologjinë e tregimeve policore (15 tregime) të përgatitur nga autorët Jorge Luis Borges e Adolfo Bioy Casares. Gjithashtu në këtë antologji hyn edhe tregimi "*Dymbëdhjetë shenjat e botës*" bashkëpunim jo i vetëm i Borges-Casares me pseudonimin H. Bustos Domecq.

Në *Parathënie* Borhes flet për romanet, kënaqësinë e aventurave dhe ngurtësinë e tyre, për shekullin e epërsive të intrigave, për veprat e imagjinatës së arsyes, përmend Stivensonin, Hose Ortega i Gaset, Marsel Prustin, Çestertoni, De Kuinsi, Kafka, Balzaku, Shekspiri, Servantesi, Adolfo Bio Kasares, Shën Agustini, Origjeni, Louis Augste Blanqui, Dante Gabriel Roseti, Santiago Daboves, për rusët dhe dishepujt e rusëve, për lirinë totale si kaos total, për fiksionet e llojit policor e të tjera duke shprehur admirim në mesin e veprës së James-it, Kafka-s e Green-it se "Asnjë epokë tjetër nuk zotëron romane me subjekte aq të admirueshme sa *The turn of the crew*, *Der Prozess*, *Voyageur sur la terre*, apo kjo novelë që ka arritur të shkruajë, në Buenos Aires, Adolfo Bioi Kasares." **3)**

Nga realiteti imagjinar tek bindja e lexuesit

Që në faqen e parë të romanit "***Shpikja e Morelit***" rrëfimtari lë dëshmi me shkrim, shënime për "mrekullinë e pafavorshme" dhe bënë paralajmërimin e mbijetuesit për veprën e ardhshme! Përmes lidhëzes dëshirore *do t*ë shkruaj dhe vërtetoj, tërë mesazhin që mund të këtë një vepër, një njeri në çastin e përvojës fluturake. "*... do t*ë *sulmoj gjurmuesit e pyjeve dhe t*ë *shktretëtirave; do t*ë *vërtetoj se bota* është *kthyer n*ë *një ferr t*ë *gjithmbarshëm p*ër *t*ë *përndjekurit, falë përsosjes s*ë *sistemit policor, t*ë *arkivave, t*ë *gazetaris*ë*, t*ë *radiotelefonis*ë *dhe t*ë *doganave, q*ë ë *bëjn*ë *t*ë *pakorrigjueshëm çdo gabim t*ë *drejtësis*ë." (13)

Rrëfimtari është i kujdesshëm deri në "ekstremin" e fundit, shndrrimin në testament të shënimeve duke cituar "përsosmërinë këmbëngulëse" (Ostinato rigore) te Leonardo da Vinçit. Përherë në imagjinatën e krijuesit ndërtohen diskurse dilematike, siç ndodh në muze me bibliotekën e cila është "e pashtershme" dhe "e mangët". Fiksionet faktike gërshëtojnë pafundësinë e përjashtimit të një libri a të veprave të pafundme.

Një nga mendimet filozofike i panjohur për një lexues të mangët vjen këtu si një perlë e pafundme thellësie qenësore. Një gërshetim hyjnor i prekshëm i vetëdijes dhe njeriut që autori e fut tërë paragrafin në kllapa. "*(Unë besoj se ne e humbasim pavdekësinë, ngase rezistenca jonë ndaj vdekjes nuk ka evoluar; përçapjet dhe hulumtimet tona vazhdojnë të këmbëngulin tek ideja filelstare, rudimentare: ta mbajmë gjallë të tërë trupin. Duhet të kërkojmë të ruajmë vetëm atë çka i intereson vetëdijes.)*" (19)

Në faqe 23 e 24 kemi un-in e krijuesit, studim i shkrimtarit, krijimin e një vepre dhe elementet kyçe për të dëshmuar më vërtetësi e gjithë ekzistencën. Është triptiku i brendshëm shpirtëror tek besimi në ndjesinë e mbështetjes, siç i përcakton "tek miqtë, tek e dashura dhe tek gjaku i vet."

Metamorfozat në vete e bëjnë heroin edhe më inteligjentë në njohjen e domosdoshëm të drejtësisë, pasojave të dënimit, rëndësinë e mbrojtjes dhe arritjen e lirisë. "*Ata q*ë *vendosin d*ë*nimin ton*ë*, q*ë *na diktojn*ë *koh*ë*n e d*ë*nimit, gjithashtu na detyrojn*ë *t*ë *gjejm*ë *një mbrojtje p*ër *t'u mbërthyer marrëzisht pas liris*ë." (25)

Projekti i rrëfimtarit ishte një improvizim i kujdesshëm. Këtu fillon ndërthurja e elementeve të dëshirës me fantastikën. Gjatë bisedës mes ciganes gjigande me sy të mëdhenj dhe mjekroshit shtatlart fytyrzbehtë që rrëfyesi përgjon për afrinë me femrën mësojmë emrat e personazheve, siç i mëson edhe rrëfyesi: Faustina dhe Moreli.

Detaji në imtësinë e nënvetëdijes dhe realiteti me përshkrimin e fantazisë së ishullit janë dy elemente mbizotëruese deri tani të veprimit. Shkrimtari tjetër argjentinas Ernesto Sabato në esenë "*Pyetje paraprake*" thotë se "vepra e artit kurrë nuk është një soditje e thjeshtë: është një veprim që kryhet midis unit tonë dhe botës, një veprim që ndryshon botën dhe unin. E njëjta gjë ndodh me leximin." **4)** Lexuesi bashkëdyzohet me rrëfimtarin në detajet e ndihmësin e leximit, një lidhje kjo e rrallë në diskursin e krijimit të rrëfimit. "... t'i ndihmojë lexuesit e këtij ditari... (56) dhe ... lexuesit e mi... t'u vënë datë këtyre faqeve. (56) Shkrimtari (autori) a duhet të jetë në nivelin e rrëfimtarit, kur dihet se rrëfimtari mund të jetë vrasës a keqbërës a mbi të gjitha si tek "***Shpikja e Morelit***" i burgosur, i arratisur?!

"Transkriptuar nga kujtesa..." dhe dekonstruksioni letrar i fusnotës

Rrjedha e ngjarjes në vetmi përshkohet me një dramë në vete, e cila tashmë ka marrëdhënien e rrëfimtarit me Faustinën. Lind vëzhguesi hipotetik si mbështetje e rrëfyesit. "I arratisuri" dhe "fuqia e tmerrshme e drejtësisë" janë dy elementetet paralajmëruese dhe "kurthe" në vete që edhe ne si lexues duhet patur kujdes për vendosjen e admirimit dhe refuzimit të veprimit. Ideja dhe materia, fantazia dhe ekzistenca, utopia dhe destopia sikur janë në përballje për të kuptuar të vërtetën deri në fund.

Derisa realiteti ka marr udhë, rrëfyesi i ka shprehur dashurinë Faustinës, autori përshkruan jo vetëm fantazmën e një libri por edhe identitetin e jashtëm të librit pas krahasimit. "*...nuk ishin dy kopje të të njëjtit libër, por e njëjta kopje dy herë...*"! (67)

Natyrshmëria, bësnikëria e një transkriptimi varet nga faji i talentit ose i kujtesës. "*Zakonet tona nënkuptojnë një mënyrë të caktuar të rrjedhjes së gjërave, një koherencë të paqartë të botës.*" (69)

Fusnotat vijnë e bëhen tekst, një ndërlidhje mes librit ditarit dhe shtëpisë botuese, botuesit. Nuk ka asgjë fantastike. Botuesi apriori hy në vepër. Vërtetësia dhe dëshmia është fusnota në faqe 70: "*Për të qenë më e qartë, na u duk të fusnim brenda thonjëzave atë çka qe shkruar me makinë shtypi në ato faqe; pjesët jashtë thonjëzave janë shënime plotësuese në anë të faqeve, të shkruara me laps dhe me të njëjtin shkrim dore që është shkruar pjesa e ditarit. (Shënim i botuesit)*" Përmes fusnotës shpjeguese të shënimeve të botuesit, që tashmë 85 vite pas botimit, vjen e bëhet teoria dhe filozofia parësore e tërë dëshifrimit të këtij romani. **5)**

Abuzimi përmes fotografimit pa leje, shpikja e fundit e Morelit, aktet e regjistruara, jeta njëjavore në skenë dhe përballë audiencës janë një tjetër përputhshmëri e qenies së rrëfyesit në raport me fjalimin e




Borges dhe Casares

Morelit, është një diskurs i përafrimit dhe gërshëtimit unik.

"*Të mendoj për shpikjet*" dhe planet "*ta bësh një grua të bjerë në dashuri sesa të fabrikosh qiej...*" (72) vijnë e bëhen dy çështjet thelbësore të Morelit. Përputhshmëria e qenies së rrëfyesit në raport me fjalimin e Morelit është një konstruksion i përafrimit dhe gërshëtimit unik. Planet e bindjes dhe rrëmbimit përkojnë me rrëfuesin "e fshehur", spektatorin hije a më vet heroin, kryepersonazhin hije si i përhershëm "rrëfimtar origjinal"? Nëse rrefimtari që nga fillimi përballet me stilin letrar të njeriut të shkencës edhe Ne lexuesit përhumbim në ingranazhin e një force krijuese fiktive për të na thënë autori "le ta gjykojë vet lexuesi", në katër, pesë faqet pasuese në thonjëza për përgjigje. Fusnota në rënditjen 5 konsideroj që është kyçe në ndërlidhjen në mes te lexuesit, shpikjes së Morelit dhe romanit.

E gjithë shpikja e Morelit është përvojë shkencore dhe parathënje paralajmëruese e cila në epoken moderne tashmë është e besuar si projeksion dhe sinkronizim. Riprodhimet, eksperimentimet për imazhet e jetës së gjallë kanë "firmen" e shpikjes së Morelit i cili tashmë ka hyrë në libër më ligjëratën e tij për të na bërë ne lexuesve të besojmë. Moreli ka shpjeguar tërë historinë e tij dhe të ishullit. Kishte blerë ishullin. Në të kishte ndërtuar muzeum, kishën dhe pishinën.

Një nga "fragmentet", pjesët më të thekta dhe "përfundimtare" është kur flet për imazhet dhe shkrimin e "këtij" ditari. Nëse imazhet nuk jetojn atëherë "përgjimi" në mes vetave do të jetë i plotë me aparatin tjetër të ri "si një alfabet më të cilin imazhi do të vazhdojë të kuptojë gjithçka..." (87) "Jeta do të jetë një depo e vdekjes", a s'është ky kalimi i tërë ingranazheve të veprimit njerëzor dhe rrëfimit te Casares!

Elozh për Maltusin dhe mizoria e agonisë së rrëfyesit

Që në fillim të romanit autori përmes rrëfimtarit, të arratisurit premton se "nëse gjatë këtyre ditëve nuk mbytem, apo nuk vritem në përpjekje për t'ia mbathur, shpresoj të shkruaj *Mbrojtja përballë të mbijetuarve* dhe *Elozh për Maltusin*. Sipas *Enciklopedisë së Përgjithshme të Oksfordit* (botim shqip i vitit 2006) Thomas Robert Malthus (1766-1834) është ekonomist dhe klerik i njohur për teorinë, si kundër është parashtruar në *Essay on Population* (1798), sipas së cilës ritmet e rritjes së popullsisë pritën të jenë në shpërpjestim me rritjen e mjeteve të jetesës, masat për të mbajtur nën fre rritjen e popullisës janë, për këtë arsye, të domosdoshme për të parandaluar katastrofën. **6)** Rrëfimtari do të flas për predikimet dhe praktikimin e doktrinës së Maltusit për të mbrojtur banorët vendin e tyre, për rrëziqet që në profecitë e harruara të Maltusit kanosin ishullin, tokën dhe njerëzit dhe në fund edhe për vënien kujdes këshillave të Maltusit.

Vizioni a përfytyrimi i imazhit bëhet lënda e plotë e gjithë rrëfimit për jetën në ishull dhe shpikjen e Morelit. Rrëfimtari e ka vendosur veten në këtë përfytyrim, pavarësisht ndëshkimit për të cilin askush nuk flet. Dashuria për Faustinën përveç që është jetike është edhe imazh ekzistencial për të cilin ajo duhet të bind tjetrin. Rrëfimtari dhe Faustina, dashuria dhe imazhi, ekzistenca dhe e ardhmja tashmë bëhen çaste kyçe në përfundimin e një rrëfimi si imazh në faqet e fundit. Dilemat e rrëfimtarit kanë paralajmërimin që në fillim por që tashmë janë lodhur. Drama e mbijetësës autoriale në përshkrimin e veprimit dhe shkrimit të ditarit është "në fund". Krahasimi analogjik i fatit të kapitenit japonez me letrën dhe ditarin e rrëfyesit është i trishtë! Paralajmërues? Të lexojmë romanin! Gabimet dhe paqartësia e rrëfimtarit zvogëlon hendekun mes saktësisë ideale dhe rrëfimit. Raporti është në përfundim si vet jeta e rrëfimtarit. Fundi është i ngjeshur, si një testament për imazhin e vetes në raport me personazhet, në marrëdhënie me Faustinën dhe në përballje me lexuesin. "*...për mua, ti, o Atdhe, je zotërinjtë që qeverisin, milicët me uniforma të marra me qira dhe shënjestër vrasëse...*" (109) është një nga mesazhet e rrëfimtarit.

Casares krijon. Origjinaliteti i tij vjen para se të "krijohet biblioteka borgesiane". Gjatë "*Bisedës së gjashtë*" te Denis Fernandez Recatata me Ismail Kadarenë, ky i fundit flet për krijimtarin. "Krijimtari është i rrallë", thotë Kadare. **7)** Me romanin "***Shpikja e Morelit***" Casares jo vetëm që është shkrimtar i rrallë por edhe krijimtar origjinal në aoreolen tematike të përmbajtjes dhe në detajet semantike të formes. Çdo rilexim ngrit dilemat e kohës kur përherë e nesërmja bëhet sot dhe vjen si hyrje për ta njohur të kaluarën. Kur e shkuara bëhet nesër atëherë historia arratiset në vetvete dhe rishkruhet me fakte, siç bënë autori, rrëfimtari në romanin e Casares.

Pas mbylljes së leximit të romanit "***Shpikja e Morelit***" me tjetër përvojë do i kthehem rileximit të romanit të Daniel Defo, të botuar në vitin 1719 "*Robinson Kruzo*", rishikimit të fundit të filmit shqiptar të regjizorit Spartak Pecanit të vitit 1983 "*Kohë e largët*" (takimi në një ishull i piktorit të dënuar Andrea Shelca me asketin Lithan) dhe pas çerekshekulli shkrimi e botimi të *letrës drejtuar nxënëses Laura Zani* vizitë Ishullit të Sazanit...

Gusht 2025, Prishtinë-Ishulli i Zvërnecit

1) Horhe Luis Borhes"***Poezi***", Shtëpia Botuese "Mësonjëtorja e Parë", 2000, faqe 209

2) "***Antologji e tregimit hiaspanoamerikan te shekullit XX***", Botimet Dudaj, Tiranë, 2002

3) Adolfo Bioy Casares "***Shpikja e Morelit***", Pika pa sipërfaqe, 2025, Tiranë, faqe 9 (më tej vetëm në tekst numri i faqës)

4) Ernesto Sabato "***Shkrimtari dhe fantazmat e tij***", Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, faqe 33

5) Intriga e gërshëtimi mes rrëfimtarit, botuesit dhe autorit është vijëzimi dhe rrjedha e krijimit dhe botimit të romanit "*Dimri i madh*" nga koha e ngjarjes të romanit dhe koha e shkrimit tek koha e botimit (ribotimit) dhe koha e përkthimit (në frëngjisht dhe rusisht).

6) "***Enciklopedia e Përgjithshme e Oksfordit***", Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit, Tiranë, 2006, faqe 786

7) Ismail Kadare-Denis Fernandez Récatala "***Kohë barbare***", Tiranë, 1999, faqe 179

(vijon nga faqja 21)

ecte qetësisht nëpër oborr dhe pastronte pendët e tij. E kapa dhe e shtyva përdhe; koka e patokut u këput nën çizmen time, u ça dhe nisi të rridhte. Qafa e bardhë ishte shtrirë mbi pleh, ndërsa krahët dridheshin mbi trupin e pajetë të zogut.

– E marrtë dreqi, e marrtë, – thashë, duke e shpuar patokun me shpatë. – Merre këtë dhe ma piq!

Plaka, me verbërinë dhe syzet që i shkëlqenin, e ngriti zogun, e mbështolli me përparësen e saj dhe e tërhoqi drejt kuzhinës.

– Shok, – tha ajo pas një heshtje të shkurtër, — dua të var veten, — dhe e mbylli derën. Ndërkohë, në oborr, kozakët rrinin të ulur rreth kazanit të tyre. Rrinin drejt, pa lëvizur, si priftërinj, dhe nuk i hidhnin sytë nga patoku.

– Djali përshtatet mirë këtu me ne, — tha njëri prej tyre për mua, më shkeli syrin dhe mori një lugë supë lakrash.

Kozakët filluan të darkonin me një hijeshi të rëndë, si burra që e respektojnë njëri-tjetrin, ndërsa unë fshiva shpatën me rërë, dola jashtë portës dhe u ktheva sërish, i lodhur. Hëna varej mbi oborr, si një vath i lirë.

– Vëllaçko, – më tha papritur Surovkovi, më i madhi i kozakëve, – ulu dhe ha me ne, derisa patoku yt të jetë gati…

Ai nxori një lugë rezervë nga çizmja e tij dhe ma dha mua. Hëngrëm supë lakrash dhe mish derri.

– Ç'shkruhet në gazetë? – pyeti djaloshi leshverdhë ndërsa më bënte vend..

– Lenini shkruan, – thashë unë, duke nxjerrë Pravdën, – Lenini shkruan se na mungon gjithçka…

Dhe me zë të lartë, si një i shurdhër triumfues, lexova fjalimin e Leninit drejtuar Kozakëve. Mbrëmja më mbështolli me lagështinë jetëdhënëse të çarçafëve të saj të muzgut, dhe më vendosi pëllëmbët e saj si të një nëne mbi ballin që më digjej. Unë lexoja gjithë ngazëllim, duke pritur efektin e fjalëve të mia dhe duke u gëzuar për strategjinë misterioze të Leninit.

– E vërteta[3] është si një gudulisje në hundë, tha Surovkovi kur mbarova. – Nuk është e lehtë ta nxjerrësh nga grumbulli, por Lenini e kap menjëherë, si pula që pickon kokrrat e grurit.

Kështu foli Surovkovi, komandanti i togës së skuadronit, për Leninin; më pas u nisëm të flinim në ahur. Flinim aty gjashtë vetë, duke ngrohur njëri-tjetrin, me këmbët e ngatërruara, nën vrimat e çatisë nga ku depërtonte drita e yjeve.

Ëndërroja dhe shihja gra në ëndrrat e mia, por vetëm zemra ime, e njollosur nga vrasja, ulëriste dhe rridhte gjak.

3 Këtu i referohet Pravdës (gazetës) si 'E Vërteta'.



JENTE POSTHUMA
Libër finalist i Booker Prize International 2024
Çfarë do të doja
të mos e mendoja
Onufri